


ALBANIAN
Basic Course

Supplementary Reader
Volume III

February 1974

DEFENSE LANGUAGE INSTITUTE
FOREIGN LANGUAGE CENTER



PREFACE

This is the third volume designed to help students in reading comprehension. It contains 31 articles with a difficulty level and style of that used in current popular Albanian periodicals. The volume will be introduced to students beginning with the 24th week of the Albanian Basic Course.

The purpose of these series of articles is twofold:

1. Used for Basic Course students, it will drill already known structural features and enrich the students with a great variety of idiomatic expressions and vocabulary. The students are expected to study at home part of the assigned article and be ready to answer questions in class the following day and give an oral resumé of it. The situational topic of each article will be used also for free conversation.

2. Used as Basic Course Enrichment Program (BCEP) material, these articles, having been judiciously selected to include formal, informal and functional language in order to develop the skill of reading comprehension, will develop such a skill. The following procedure will be followed:

- a. A passage of approximately 250 words in length from each article will be assigned to the students to be read in the classroom.

- b. The students will furnish answers in English to 20 questions printed in English on a separate answer sheet.

c. The passage may be read and consulted as often as required.

d. Vocabulary aids may be used. It is recognized that the existing commercial dictionary is not adequate, therefore a special glossary, prepared by the Albanian faculty, will be available to the students.

e. The task of answering the 20 questions is to be completed within 30 minutes.

f. 16 correct answers out of 20 questions should be furnished in order to obtain a passing grade.

This Supplementary Reader, has been designed in accordance with the NCTS Basic Language Course Terminal Skill Objectives for the Albanian Language, as implemented January 1974.

TABLE OF CONTENTS

<u>Selection No.</u>	<u>Title</u>	<u>Pages</u>
1	SHPRESA	1-8
2	AJRI I FRESKËT I ZBARDHËLLIMIT	9-17
3	ATJE KU THËRMOHEN DALLGËT	18-25
4	BASHKËBISEDIM ME SHEKUJT E KALUEM	26-29
5	BISEDË NË MAL	30-35
6	BISHTUKU	36-45
7	BREDHI I BARDHË	46-54
8	DORASHKAT	55-62
9	ERA E QERSHORIT...	63-69
10	MACJA ME VESHË TË PRERË	70-73
11	M J E S H T R I	74-77
12	LEGJENDA E NJË FISI	78-81
13	TREGIM PËR LEZEN DHE PËR HILËN	82-90
14	NE KISHIM NJË RRUGË...	91-96
15	NËN ÇATIN' E RE, NË DIBËR	97-104
16	NJË NJERI MË SHUMË	105-115
17	PLAKU DHE PUSHTUESIT	116-119
18	PLAKU KTHEHET NË SHTËPI	120-125
19	TËRË FSHATI E PËRCOLLI	126-132
20	VJESHTA E GJELBËRT E MALEVE	133-139
21	ZËRI I PUNËTORES	140-146

22	ZYKO GUXIMTARI	147-151
23	NDIZET LLAMPA E DIKURSHME	152-156
24	QYTETI I JUGUT (Gjirokastra)	157-162
25	DUKE DALË NGA FËMIJNIA	163-173
26	PANTOMIMË	174-183
27	KUNDËRAJRORI I VJETËR	184-188
28	KUR KORREJ GRURI...	189-197
29	TË VËSHTROSH THELLËSINË	198-204
30	PLAKU I NJË QYTETI TË HIRTË	205-212
31	VËLLAI	213-222

SHPRESA

Ajo ishte pak më e rritur se të tjerat. Për shkak sëmundjesh kish humbur dy vjet shkollë dhe nuk ishte e vështirë të vihej re gjendja e saj e veçantë: nga njëra anë ishte shumë e gëzuar që ndodhej sërish në shkollë, sepse gjatë atyre dy vjetëve ajo vetëm për këtë kish ëndëruar; nga ana tjetër, e ndjente se nuk ishte tamam midis shoqeve të saja. Dy vjet ndryshim, që në një periudhë tjetër moshe s'do të ndiheshin fare, në atë cak moshe kanë rëndësi të posaçme dhe nga të gjitha anët sepse kemi të bëjmë me ndryshime të mëdha e të qarta që përcaktojnë kalimin nga adoleshenca në rini. Ky ndryshim binte menjëherë në sy, qoftë nga vetëdija e disiplinës, qoftë edhe nga marrëdhëniet që mbante me shokët e shoqet e klasës në minutat e pushimit. Nuk luante si të tjerat me fshirësen e dërrasës së zezë, me pluhurin e shkumbësit, me fara e bërthama. Me një fjalë dukej si një nxënëse e shkollës së mesme që kish ardhur si bujtëse për disa kohë në bankat e tetëvjeçares.

Gjithë qëndrimi i saj të detyronte një farë respekti sadoqë ajo s'kërkonte asnjë favor dhe, me sa kisha vënë re, nuk donte të binte në sy e aq më pak të komandonte të tjerët si më e rritur që ishte. Prekej shumë shpejt, jo vetëm nga kritikant, por edhe nga qortimet e tërthorta që mësuesi është i detyruar të përdorë në klasë, kur nxënësit bëjnë shkelje të lehta të disiplinës. Atëhere ulte vështirimin, faqet i bëheshin të purpurta dhe gjatë gjithë orës së mësimit rrinte e pezmatuar sikur mbi atë binte tërë faji i klasës.

Kur ngritëm grupin e recituesve, i dhashë edhe Shpresës një fragment nga poema "Shqiponjat fluturojnë lart". M'u duk se e mori me qejf dhe kisha besim se ajo mund ta recitonte mirë; zërin e kish të kumbueshëm dhe melodioz. As ndjenja nuk i mungonte.

Pasdite ne mblidheshim për të bërë prova. Në këto prova, me përjashtim të Shpresa Jankos, gjithë të tjerët vinin rregullisht. Ditët e para ajo u justifikua se kish shumë punë në shtëpi, për shkak se i kishin ardhur disa miq të largët dhe unë s'ia vura re duke menduar se në kohën e lirë sigurisht përgatitej vetë. Mirëpo javën e fundit, atëhere kur nuk e prisnim, Shpresa pa dhënë asnjë arsye tha se poezinë nuk kish arritur ta mësonte dhe prandaj nuk do të vinte më në prova.

Sjellja e saj m'u duk e pahieshme dhe e qortova me fjalë të ashpra përpara kolektivit. Mbase e teprova duke i thënë se qe fodulle e mendjemadhe, por atëhere isha i bindur se ajo s'donte të recitonte e të dilte në skenë para popullit me shoqet e klasës, vetëm e vetëm sepse ishte pak më e rritur e si përfundim nuk i kishte hie.

"Mos mendon se kjo është një punë e parëndësishme, i thashë, dhe se s'të përket ty të merresh me të tilla gjëra? Këtu je nxënëse si gjithë të tjerat dhe nuk mund të kesh më pak detyra. Në qoftë se je pak më e rritur aq më mirë, se ty të takon në radhë të parë të bëhesh shembull për të tjerët, të jesh e para në çdo aktivitet jashtëshkollor, kurse ti bën të kundërtën. Ne nuk do ta prishim çfaqjen për shkakun tënd, kemi nxënës të tjerë që do t'ia dalin mbanë kësaj pune me vullnet e pasion, por desha të të them se sjellja jote s'është aspak e hieshme".

Ndërsa unë flisja, klasa dëgjonte e nemitur sepse rallë herë më kishin dëgjuar të kritikoja me ton të ashpër e me zë të lartë. Kjo u bënte përshtypje. U bënte përshtypje edhe diçka tjetër: që këto fjalë po ia thoja Shpresës.

Ajo ish gati të shpërthente në lotë, se nuk e kish pritur këtë rrebesh; vetëm se i vinte turp të qante përpara klasës. Kur unë e kritikoja, ajo me vështrim të ulur mbi dërrasat e bankës, me buzë të mbledhura, tundte kokën me një gjest që donte të thonte: "ashtu është, ke të drejtë"! Por meqë gjestet s'e kanë gjithëmonë kuptimin të qartë, në të njëjtën kohë dukej sikur thonte: "flitni sa të dëshironi, unë s'kam për të ardhur".

Pastaj e pashë që vuri dorën mbi gojë, si ta ndalonte të thonte diçka dhe për disa minuta ndenji me sy të ngulur diku e askund.

Ato ditë nuk e pashë asnjëherë të qeshte. Hynte në klasë me vetulla të mbërthyera, me vështrim disi të vagëlluar e po ashtu dilte. Më dukej se edhe në mësim nuk ishte e përqëndruar si përpara.

Vallë kaq shumë të ishte prekur nga kritika, kaq përshtypje i kishin lënë fjalët e mia? Në qoftë kështu, aq më mirë, mendoja, se do të nxjerrë mësim të dobishme.

Vetëm nuk dëshiroja që ajo të mendonte se unë isha zemëruar me të. Në të vërtetë zemërimi i mësuesve i ngjan shiut të verës: ai është i shkurtër dhe i rrëmbyeshëm. Dhe gjithmonë i shtirur. Vallë nuk e dinte ajo se mësuesit nuk zemërohen kurrë me nxënësit; ata bëjnë vetëm sikur janë zemëruar.

Herë-herë më vinte t'ia thoja hapur këtë gjë, këtë sekret të zanatit dhe do t'ia kisha thënë sikur të mos kisha një fiije dyshimi se pas këtij zbulimi, efekti i kritikave dhe i qortimeve do të zvogëlohej shumë.

Nga fundi i asaj jave, u dhashë nxënësve si detyrë klase një hartim me temë të lirë.

Pas zhurmës së zakonshme që bëhet në këso rastesh nga nxënësit që kërkojnë orientime e sqarime e nga përpjekjet për të gjetur një temë të përshtatshme, ca nga ca klasa ra në qetësi dhe ia filloi punës. Vetëm Shpresa nuk po shkruante. Ajo rrinte e menduar, më e menduar se përpara. Nuk e cyta. Besova se ajo po mendohej për temën e hartimit.

Kaloi ora e parë dhe ajo vazhdonte të qëndronte me kokën të mbështetur mbi duar. Mos vallë s'kish ndër mend ta bënte hartimin?

Iu afrova ngadalë dhe e pyeta:

"Nuk po shkruan"?

"Jo, m'u përgjigj. Dhe pas pak shtoi: më dhëmb koka.

Si ta shpjegoja sjelljen e saj? Pse tregohet kokëfortë? Apo vallë që të më tregonte se ishte fyer nga fjalët e mia? Në atë minutë pranë bankës së saj, dy mendime u ndeshën në kokën time. Mendim i parë ishte që të tregohesha i rreptë, ta qortoja sërish e t'i vija notë negative në regjistër,

ashtu siç e përcakton rregullorja. Mendimi tjetër ishte të tregohesha zemërgjërë dhe ta besoja se vërtet i dhimbte koka. Ç'rrugë të ndiqja, të disiplinës së rreptë apo të mirëkuptimit dhe të lëshimeve të njëanëshme? Mendimi i dytë fitoi.

Ajo nuk gënjen dhe nuk besoj se ka qejf të tregohet kokëfortë. A kam të drejtë të mos besoj se i dhëmb koka?

U mundova të jem sa më i qetë kur i thashë:

"Mirë, si të duash, hartimin mund ta shkruash edhe në shtëpi".

Dhe nuk u pendova.

Të nesërmen, sapo mbarova shënimet në regjistër, Shpresa u ngrit nga vendi, erdhi afër tryezës e më zgjati një fletore të mbështjellë me gazetë.

"Ç'e ke këtë"? e pyeta.

"Hartimin, shoku mësues. E shkrova në shtëpi".

E lexova.

Ai hartim më gëzoi, më mallëngjeu e më tronditi. Gjatë dymbëdhjetë vjetëve të jetës sime si arësimtar, kam lexuar me mijëra hartime e midis tyre hartime të bukura, të pasura në ndjenja, me fantazi e me frazeologji të zgjedhur, po hartim më të singertë e më të vërtetë s'më kanë zënë sytë. Ja se ç'shkruante:

"Kam disa ditë që po vij në shkollë e papregatitur si duhet dhe e mërzitur. Nuk e mendoja se do të ngjiste kështu. Kur u ula në fillim të vitit në bankat e shkollës, ndjeva një gëzim kaq të madh sa s'dija si ta shprehja. Endra ime që të kthehesha në shkollë u përmbush. Por ky gëzim nuk vazhdoi shumë sepse menjëherë pas kësaj, m'u vu një fre aq i shkurtër sa nuk më linte të bëja një hap përpara.

Pjesëtarët e familjes sime dhe të daiut filluan të më këshillojnë e të më udhëzojnë. Këshillat e tyre nuk ishin ato këshilla që prisja unë, në mënyrë që të rritesha si një e re revolucionare e t'i shërbeja atdheut kudo që të kish nevojë, këshillat e tyre qenë prapanike e më dukej sikur binin erë myku.

Ja si më këshillonin ata:

"Mos qesh me mësuesit. Mos bëj shaka me shokët e klasës. Të mos marrësh pjesë në asnjë aktivitet jashtëshkollor sepse është turp. Kur të shkosh rrugës ul kokën dhe që nga shtëpia në shkollë e nga shkolla në shtëpi. Mos rri as me shokë, as me shoqe". Domethënë unë duhej të hyja e të dilja nga shkolla si një mumje Egjypti.

Shoqet e mia po ndërtojnë hekurudhën, ato po shkojnë vullnetare në malësi, po hapin toka të reja. Nuk do ta harroj kurrë atë ditë kur vizituam lapidarin e Shkurte Vatës dhe një vullnetar na foli për jetën e saj. Shkurta ishte më e vogël se unë në moshë, po sa heroizëm që tregoi!

Kam shumë dëshirë të marr pjesë në çdo aktivitet, bashkë me shoqet e mia të klasës, por nuk mundem sepse e vjetra nuk është zhdukur akoma nga zemra dhe shpirti i njerëzve të mi.

Disa herë për të ardhur pasditeve në shkollë, kam qenë e detyruar t'i gënjej duke u thënë prindërve se kemi mësim dhe më duhet të vete që të mos mbetem prapa.

Nuk di si ta shpreh se sa e gëzuar dhe sa e lumtur do të isha sikur të ndodhesha në mes atyre që marrin pjesë në çdo aktivitet jashtëshkollor: po jo. Në ato çaste kur ata qeshin, luajnë e këndojnë unë jam e mërzhitur dhe vij vërdallë nëpër shtëpi duke bërë punët e duke qarë.

Mësuesi më pati qortuar se unë nuk po shkoja në provat e grupit artistik. Një ditë më foli përpara klasës. Unë s'bëra zë dhe ula kokën. Nga njëra anë doja të recitoja, nga ana tjetër ndruhesha të dilja në skenë sepse e dija që në shtëpi do të shpërthente grindja.

...E vjetra nuk u zhduk e nuk u shemb kur u prishën kishat dhe xhamitë, ajo rron akoma në zemrat dhe në shpirtin e atyre njerëzve që e kanë mendjen te Krishti, te Allahu dhe tek porositë e Kuranit".

Hartimi ndriçoi të gjitha ato pika të errta ku unë endesha me hamendje dhe menjëherë çdo gjë u qartësua. Atëhere e kuptova pse në fillim e mori me qejf dhe pse më vonë nuk erdhi asnjëherë në provat.

Ajo që më gëzonte më tepër ishte tregimi i saj aq i singertë dhe i vërtetë. Në atë tregim thonte gjëra të

pakëndshme për njerzit e saj më të afërm, për prindërit, e sigurisht me dhimbje në zemër, po kjo rrëfente se ajo kish nevojë t'ia hapte zemrën dikujt që i besonte plotësisht se mund ta ndihmonte dhe për këtë arsye kish zgjedhur mësuesin.

Në mënyrë të natyrshme, jetësore e disi naive, Shpresa në hartimin e saj zbulonte luftën që bëhet midis edukatës së përparuar të shkollës dhe edukatës së prapambetur të familjes.

Pra bota e madhe e thërriste Shpresën përpara, e ftonte në gjirin e saj dhe ajo marshonte në kollonat e vullnetarëve me flamurin e kuq në krye, hipte në skenë dhe recitonte, shkonte në malësi për të hapur toka të reja. Zemra i gufante nga gëzimi kur e përfytyronte veten midis aksionistëve, me shaminë e vullnetares në qafë, në mes të jetës së vrullshme të rinisë dhe ajo shpirtërisht ishte bashkuar me këtë botë. Nga ana tjetër, bota e vogël konservatore i kish vënë një gardh te porta dhe s'e linte ta kapërxente.

Deri tani Shpresa kish arritur në atë shkallë pjekurie sa të kuptonte gjendjen e saj e të vuante, me gjithë atë edhe ajo i kish bërë botës së vogël një lëshim: në grupet artistike s'kish marrë pjesë. Duket sikur kjo ishte një marrëveshje e heshtur midis prindërve dhe vetë asaj, si shpërblim që e kishin lejuar të vinte në shkollë.

Por më tutje si do vente puna? Cilat ishin ato forca që do të ndikonin më shumë në jetën e saj dhe a mund të parashikoheshin të gjitha? Cila botë do të fitonte?

* * *

Pa mbaruar akoma shkolla, në kooperativën tonë, erdhën disa vajza nga malësia e Tropojës për të marrë eksperiencë e për t'u stërvitur si mjelëse. Kishin disa emra që myzeqarët s'i kishin dëgjuar kurrë dhe i shqiptonin me një farë habije: Bora, Dave, Gjela, Pashka, Katrina, Mri. Ato suallën me fytyrat e tyre bardh e kuq, freskun e pishnajave e të bjeshkëve e si një anije që në çdo liman të largët të botës të shkojë është një copë e atdheut, ashtu edhe ato ishin një copë e krahinës së tyre.

Dalloheshin nga mënyra e të folurit, nga veshja, nga ngjyra e fytyrës e sidomos nga ecja. Ecja e tyre ruante gjithmonë ato tipare që ishin bërë shprehje nga rruga e thyer malore: trupin e mbanin pak të kërrusur përpara dhe rëndonin mbi gjithë shputën e këmbës.

I ndanë nëpër familje dhe një nga ato e caktuan në shtëpinë e Shpresës. Siç ishte e natyrshme Bora dhe Shpresa u miqësuan shumë shpejt dhe pas disa ditësh kudo i gjeje bashkë si motra binjake.

Tregimet e Borës për fshatin e saj të largët, ku tani punonin për të vendosur dritat elektrike e për të ngritur shtëpinë e kulturës, i trazuan sërish ëndrrat e saja për botën e madhe. Ajo kish dëshirë të shikonte Valbonën e kaltërt që rridhte në mes brigjeve shkëmbore, pyjet me gështenja e rrugët e gjata të atdheut. Flitej se së shpejti do të nise-shin për në malësi një grup vajzash e grash nga Myzeqeja. Me to ëndëronte të shkonte edhe Shpresa. Ajo ua tha prindërve dëshirën e saj, por siç mund të kuptohet prindërit nuk e lejuan, duke vënë si shkak se atë muaj do të martonin djalin e dajos dhe ishte turp të mos merrnin pjesë në dasmën e tij. "Më tutje, shohim e bëjmë", i kish thënë i ati.

Erdhi dita që malësoret do të ktheheshin ndër shtëpitë e tyre. Njerëzit kishin dalë t'i përcillnin e të dy palët ishte të mallëngjyer nga që po ndaheshin. Dukej sikur "tropoljankat" qenë bërë papritur me dy familje e me dy shtëpi. Ato qanë kur u larguan nga Tropoja, kur u ndanë nga prindërit e tyre, po s'ua merrte mendja se do të qanin edhe kur të iknin nga Myzeqeja. Gratë dhe vajzat fshinin lotët me shami, ndërsa burrat e djemtë përpiqeshin të qëndronin seriozë.

"Edhe çupa të më kish ikur, s'do më vinte kaq keq", thonte një plak me takije të bardhë. "Rob' i mirë, u dashka shumë" dhe i përkëdhelte flokët Katrinës.

Shpresa mbante për dore Borën dhe diçka i pëshpëriste në vesh. Nuk dukej shumë e mallëngjyer dhe kjo më habiti.

"Po e përcjell shoqen"? e pyeta.

"Unë do t'i përcjell deri në qytet", më tha me zë të lartë dhe disi krenare.

"Ah, prandaj s'të shikoj të mallëngjyer". Dhe unë përpiquesha të gjeja arësytën.

Pastaj m'u afrua së bashku me Borën e më tha ngadalë:

"Unë do të iki në Tropojë me Borën. Do të shkoj vullnetare".

Mënyra se si m'i tha ato fjalë, tregonte qartë se atë veprim po e bënte fshehurazi.

"U ke thënë gjë prindërve"?

"Jo, shoku mësues". (Ajo vazhdonte të më thërriste mësues edhe pas mbarimit të shkollës). Këtë gjë deri tani e di vetëm sekretari i rinisë dhe ju.

"Pse nuk u thua dhe prindërve hapur"?

"Do t'u shkruaj letër sapo të vete në malësi. Kështu e kemi vendosur me Borën".

Bora pohoi me kokë.

"Ne atje do të hapim toka të reja, do të ngrejme grupin artistik, do të japim çfaqje".

Në sytë e saj ndriste gëzimi i fitores.

"E merr me mend se ç'do të ngjasë"? e pyeta. "Pas një jave babai dhe dajua do të vijnë në malësi dhe do të përpiqen që të të kthejnë në shtëpi".

"Kot do të vijnë, tha duke buzëqeshur. Unë jam vullnetare dhe do të kthehem së bashku me vullnetarët.

Shoferi i ra borisë dhe Shpresa me Borën nxituan të hipnin në autobus. Të dyja ndjeheshin të lumtura. Pas pak makina u nis duke çarë grumbullin e njerëzve, e la sheshin e fshatit dhe mori kthesën drejt xhadesë.

Prej andej na përshëndesnin e na linin lamtumirën një mori duarsh. Edhe ne tundnim duart në erë dhe u uronim rrugë të mbarë. Unë kisha përshtypjen se, ndërsa autobusi ecte drejt qytetit, Shpresa qëndronte më këmbë duke shikuar rrugët e atdheut që hapeshin para saj.

AJRI I FRESKËT I ZBARDHËLLIMIT

Gjykuan të gjithë, po nuk qenë të gjithë në një mendje: një palë e shanin, të tjerët e mbronin dhe e lëvdonin.

Irfan Sula kish zënë vend në një karrigë pranë dritares dhe dëgjonte. Drejtori i spitalit, një burrë i shkurtër, fytyrë rrumbullaktë e zijosh, që mbante edhe në sallë syze optike të errëta, tha me pahir disa fjalë të përgjithshme, që Irfani nuk i dëgjoi dhe, fill pas tyre, shqiptoi një frazë po aq të përgjithshme për lavdinë personale.

"Avaz i njohur", mendoi mjeku, duke vështuar jashtë "Po këto gjëra diskutojmë në çdo mbledhje..." po nuk e shtjelloi më tej mendimin, se drejtori përmendi emrin e tij.

Irfani lëvizi padashur dhe u skuq në fytyrë. Iu skuq edhe pjesa e sipërme e kokës, që rrethohej nga flokë të rrallë e krejt të zbardhur.

Si nga mosha edhe nga stazhi në profesion, ai hynte në radhën e mjekëve të vjetër. Ishte pesëdhjetë vjeç dhe po mbushte, javash - javash, një çerek shekulli që shërbente në repartin e kirurgjisë dhe i pëlqente të kujtojë se kish qenë i pari që kish përdorur bisturin e kirurgut në spitalin e qytetit.

Njerëzit e donin dhe kishin besim në fjalën dhe në dorën e tij. Kish raste që prisnin të sëmuret edhe një javë, vetëm që t'i vizitonte ai dhe t'u jepte një këshillë e një recetë. Dhe nuk ia përtonte as punës së patollogut. Ditën e natën, në shi e në diell, me të trokitur dera ai ishte më këmbë. Mjekët që urrente më tepër ishin indiferentët. "Paaftësia", mendote ai, "është fatkeqësi për mjekun, kurse indiferentizmi është krim".

"Do të flas edhe unë", vendosi ai në inat e sipër dhe vështroi drejtorin me zemërim. Ky fliste me zjarr e me fjalë të pazgjedhura. "Le të kërkohet mendimi i popullit. Populli le të më gjykojë e të më ndëshkojë..."

Po ky ishte një rrëmbim i çastit. Ai nuk kish menduar kurrë se do të vinte një ditë dhe do të gjykohej në mbledhjen e gjithë punonjësve të spitalit, kështu që i dukej se çdo fjalë e madhe fshihte smirën e kolegut, që kish hequr dorë nga profesioni dhe qe kthyer në administrator.

Disa minuta më vonë, ndërsa drejtori fliste, Irfan Sula u qetësua dhe fytyra e tij mori përsëri pamjen e mëparshme të butë dhe të qetë.

"Përpara i kemi vjetët e punën, do të shohim", dhe ai mori frymë thellë, sikur do të thithte gjithë freskinë dhe aromat e pranverës, që bleronte e lulëzonte edhe në oborrin e madh të spitalit.

Drejtori e pa dhe u nevrikos. "Si është e mundur të jetë aq i qetë njeriu kur thuhet kundër tij aq fjalë të rënda? Ndofta duhet folur edhe më ashpër", mendoi ai. "Duhet t'ia thyejmë hundën këtij fodulli!" dhe gjeti fjalët e përshtatshme që desh të shqiptonte, po qetësia e mjekut e kish tronditur aq tepër, sa i dukej e vështirë të thonte qoftë edhe një fjalë më tepër nga ato që kish thënë. Që të merrte zemër, Irfani ngriti kokën dhe vështroi sallën. Fytyra të çuditura, të zemëruara, dhe tek tuk ndonjë fytyrë miratonjëse. Fytyra të njohura e prap të reja, sikur i shihte për herë të parë. "Mos vallë nuk kishte të drejtë ai, drejtori? Mos vallë nuk kish goditur në shenjë? Pse kjo masë e gjërë lëvizte, ç'do të thonte kjo lëvizje e habi?"

"Sidoqoftë", përfundoi drejtori, dhe fshiu ballin e djersitur me shami, "këto janë mendimet e mia për Irfan Sulën", duke parë kundërveprimin e sallës.

Drejtori u ul dhe nxori nga xhepi i xhakëtës fletoren e shënimeve. Në sallë nuk ndihej kush. Dëgjohej edhe rrëshqitja e rrotave të vogla prej gome të karrocës së dorës, që u shpinte ushqimin të sëmurëve. Ata që ishin pranë derës dëgjonin edhe pëshpëritjet e shërbyesve, që kalonin në koridor. Mjekët ngurronin.

"Hë, shokë, të mos vonohemi, flisni", kërkoi drejtori dhe u buzëqeshi të pranishmëve. "S'keni ç'të mendoni, diagnoza më duket e saktë", u mburr ai dhe shkarraviti një figurë abstrakte në fletore. "Urdhëro!" i tha një infermieri të shkurtër e thatim, me dhëmbë të shtrembër e të zvedhur nga duhani. "E ka fjalën shoku Sadush Gera."

Infermieri u ngrit dhe, duke parë paqetën e cigareve, ku kish shënuar përshtypjet nga fjala e drejtorit, tha kokë ulur e i menduar:

"Tashti çështja është serioze. Unë s'kam ç't'u shtoj atyre që tha drejtori, e vetëm çuditem si e kemi mbajtur gjer"

tani në spital Irfan Sulën. Për këtë ka faj drejtorja, po kemi faj edhe ne... edhe unë si anëtar i Këshillit të Bashkimeve Profesionale..."

Salla gumëzhiu. Drejtori i ra tryezës me stilolaps dhe, meqë gumëzhitja nuk pushonte, u ngrit më këmbë dhe bërtiti:

"Lereni tjetrin të flasë!

"Të mos thotë marrëzira!

"Nuk janë marrëzira këto jo", thirri edhe Sadushi. "O, po është mbushur qyteti me lëvdata për Irfan Sulën, më keq se qëmoti për Krishtin e për Muhametin... E ç'ka bërë ai në fund të fundit? Ka shëruar të sëmurët dhe për këtë arsye ka marrë rrogën... Apo nuk e ka edhe pamjen si borgjez. Na vjen në spital me këpucë të lustruara, me pantallona të hekurosura akull dhe më ecën sikur shkel mbi vezë".

Mjekët qeshën me të madhe. Sadushi, duke folur, bënte edhe lëvizje për të qeshur.

"E, po çë...?" qeshi edhe ai vetë, i bindur se të gjithë tallëshin me mjekun. "E dini ç'më ndodhi një herë?"

Në këtë çast dera e sallës u hap me rrëmbim. Mjeku i rojës thirri:

"Urgjencë... Perforacion akut në stomak".

Irfani u ngrit dhe shpejtoi të dilte nga salla.

"Ku ndodhet i sëmuri?"

"Në sallën e operacionit, profesor", tha mjeku i rojës.

Drejtorit nuk i pëlqeu as nxitimi i Irfanit, as fjala "profesor", që përdori mjeku i rojës. "Mendjemadhësia nuk ka kufij", bluajti ai me mend, kurse Irfanit i tha ftohët:

"Nuk është nevoja të veni ju. Jepni llogari një herë..."

"Ai po vdes", klithi Irfani. "Nuk pret koha".

"Qëndroni këtu, ju thashë", u nxeh drejtori. "Ka të tjerë".

Përsëri mjeku u skuq dhe u drodh. Pa drejtorin me inat dhe desh të vraponte, po ndali... "Ka edhe të tjerë", tha me vete dhe vështroi sallën. Asistenti i tij e pa drejt në sy mjekun dhe uli kokën i turpëruar. Edhe Irfani atij ia nguli vështrimin.

"Ai do t'ia dalë mbanë me sukses", mendoi me entuziazëm dhe priti me duar të lidhura para vendimin e drejtorit.

"Stavri", i thirri drejtori asistentit të kirurgut, "shko në sallën e operacionit!"

Stavri, një djali trupgjatë e bardhosh, i erdhi zor të dilte para profesorit dhe nuk u ngrit menjëherë. Ai edhe i trembej këtij operacioni të vështirë. Gjer atë ditë, gjithnjë nën mbikqy nje e Irfan Sulës, ai kish operuar vetëm zorrën e verbër dhe tumorët e jashtëm. Gjatë dy vjetëve të punës në spital nuk i qe dhënë rasti për operacion të ndërlikuar. Ato i merrte përsipër kurdoherë profesori.

"Nuk jam i sigurtë, shoku drejtor. Është rast shumë i rëndë..."

"Hajde, se kështu do të mësohesh", i dha zemër drejtori. "Njerëz të zbritur nga qielli nuk ka", thumboi kirurgun ai.

"Mund të ketë pasoja të rrezikshme", përshpëriti asistenti dhe u nis. Tek dera qëndroi disa sekonda para Irfanit. Desh t'i thonte shumë gjëra, t'i kërkonte shumë këshilla, po të gjitha i tha vetëm me sy.

Irfani e kuptoi mjekun e ri. Ai e njihte mirë. E kish zgjedhur vetë dhe kish besim, se pas disa vjetësh, do të bëhej një kirurg, të cilit qindra njerëz do t'i puthnin ato duart e shkathëta me gishtërinj të gjatë prej pianisti. E pa me vemendje. Beteja ishte shumë e zorshme dhe ai qortoi veten, që nuk i kish besuar gjer tani asnjë rast të vështirë asistentit të vet.

"Mendo dy gjëra", i tha ai asistentit, "jetën e njeriut, që është shtrirë atje dhe detyrën që ke: të fitosh pa tjetër mbi vdekjen... Nuk vlen vetëm eksperiencia. Edhe guximi ka rëndësinë e vet".

"Vazhdojmë mbledhjen", tha drejtori. "Kush e do fjalën"? Në sallë u ndezën diskutimet. Irfani nuk dëgjonte. Mbështeti shpatullat në murin e lyster me bojë zmaltoje dhe ndiqte me

vemendje e nervozizëm operacionin. Vetvetiu rrudhej balli, shtrëngoheshin dhëmbët, lëviznin gishtat, picërroheshin sytë. Stavri çante barkun e të sëmurit, që kish rënë në gjumë prej morfinës. Bisturi ecte përpara ngadalë me pasiguri.

"Tani shpejto", e këshillonte kirurgu. "Kaq gjë ti di ta bësh dhe asnjë rrezik mos parashiko... E keqja vjen pas... Ja, tani, kujdes... E shoh ku ka plasur?... Hiqe pjesën e kalbëzuar... Qepe... Mos ki frikë... Edhe këtë ti do ta kryesh më së miri..."

"Lavdia personale është kotësi. Shoku Irfan duhet t'i vejë gishtin kokës..."

"Bukur... Ashtu duhet: të qepësh me dorë të lehtë e të sigurtë... Hë, se po kalojnë minutat... Punën më delikate nuk e ke kryer akoma: stomaku ka plasur e ka qelbur barkun... Barku do pastruar mirë... Di ta pastrosh ti? Nuk di? Ja..."

Ai u përmend. Këshillat e tia nuk i transmetonte dot në sallën e operacionit. Atje Stavri ndodhej vetëm. Atij mund t'i jepnin veglat që kërkonte, po jo këshilla.

"Unë një gjë nuk kuptoj; pse qenka gjë e keqe të të duan njerëzit dhe të kenë besim tek ti? Bile, besimin e të sëmurit tek njeriu, unë jo vetëm nuk e mohoj, po e quaj ilaç dhe ilaç të fortë..." vazhdonte diskutimi në sallën e mbledhjeve. "Mos kanë cmir dhe atje për lavdi ata shokë që i tremben emrit të mirë të kolegut të tyre?"

"E, Stavri, si e ndjen veten?" humbi përsëri kirurgu. "Mbarove? Je i sigurtë? Prit"! iu lut ai asistentit. "Lere gjilpërën... Kontrollloje edhe një herë..."

"Ju, shoku Irfan, ç'thoni"? i tha një nga shokët e presidiumit.

"Nuk jam i sigurtë", tha ai pa lëvizur.

"Për çfarë nuk jeni i sigurtë", pyeti përsëri ai.

"Më vjen keq që nuk kemi patur gjatë këtyre dy vjetëve ndonjë rast të tillë".

"More, jeni në vete, apo jo"? mori zjarr drejtori. "Kini pak respekt për kolegët. Kur flisni, ngrehuni më këmbë! shtoi ai me qesëndi. Irfani u përmend. E pyesnin për tjetër

gjë. E ç'të thonte? Sa pranë qenë e sa larg i dukeshin aty këto çaste salla e mbledhjeve dhe salla e operacionit.

"Nuk kam ç'të them", foli ai me zë të ulët. "Para jetës ose vdekjes së një të sëmuri gjithçka imja nuk ka asnjë rëndësi... Vetëm një gjë mund ta them me zë të lartë: poshtë lavdia personale, të cilën e lakmojnë njerëzit mediokër. Për të tjerat do të mendoj".

"Se ç'do të bëni më pas është puna juaj", e ndërpreu drejtori.

Irfani e pa drejtorin ftohët dhe u dëshpërua. Ai po sillej ndaj tij më ashpër nga ç'do të sillej një mësues i keq ndaj nxënësit të vet. Ku e gjente këtë të drejtë?

"Kulti i nëpunësit", mendoi mjeku në mënyrë të njëanëshme.

Kështu mendoi, ndërsa kolektivit i tha:

"Për mua ka më tepër rëndësi se ç'do të bëj këtej e tutje dhe jo fjalët që do të them në mbledhje".

Drejtori diçka pëshpëriti me vete.

Kur mbaroi mbledhja, Irfani doli i fundit nga salla. Ishte i menduar, i trishtuar.

Atë ditë i kish premtuar së shoces dhe të bijave se do të venin në teatër dhe u kujtua, po dëshirë që ta mbante fjalën e dhënë nuk kish. Donte të rrinte vetëm atë mbrëmje, të shetiste ose të ulej në një fron të lulishtes.

"Pa të mendoj një herë hollë për veten time", vendosi. "Ato që tha drejtori nuk ma mbushin mendjen, po mos kam diçka që s'e ve re? Pse disa nga kolegët flasin keq, disa mirë, ndërsa gjithë populli më do? Vetëm smirë të ketë në këtë mes? Apo vuaj nga ndonjë prej atyre sëmundjeve që nuk japin dhimbje të hershme dhe nuk diagnostikohen lehtë"?

Në fund të shkallëve priste Stavri. Ai nuk e vuri re dhe i kaloi pranë i heshtur.

"Profesor"!

"E", u kujtua Irfani, "si doli operacioni"?

"I sëmuri më duket se shpëtoi, po unë desh vdiqa nga frika. Kam punuar pa marrë frymë fare".

Asistenti i nxituar i tregoi mjekut duart. Ai ia shtrëngoi fort dhe i shkëlqyen sytë prej gëzimit.

"Të lumtë! Ke duar të arta se ke zemër të pastër... Eja të pimë një kafe se je lodhur"!

"Me gjithë qejf, po desha t'i qëndroj pranë të sëmurit".

"...Sonte nuk duhet të vesh në shtëpi. Gabimet e operacioneve çfaqen më vonë".

Dolën bashkë, u mbështetën në banakun e një kafeneje të vockël dhe rufitën kafënë e nxehtë, pa e patur mendjen tek njëri - tjetri: profesori mendohej të gjejë të metat e veta, kurse asistenti rronte ende me emocionet e forta të operacionit.

"Nuk do të vini ta shihni të sëmurin, profesor"? e pyeti Stavri me përulësi e sinqeritet, kur do të ndaheshin.

Irfani u trondit dhe iu duk vetja i vogël. Nuk i kish ndodhur ndonjë herë të mos interesohet për të sëmuret e pavionit. U vente edhe atyre që s'kishin gjë për t'u shqetësuar. Kurse sot... Po, a duhet të vente? Zemra i thosh po, mendja i thosh jo. Kur të më shohin në spital do të thonë: ja, erdhi, se nuk ka besim tek të tjerët, - mendoj dhe nuk e pranoi ftesën e asistentit.

"Sonte jam i lodhur", u përlligj dhe i shtrëngoi dorën.

Pas mesnate Irfan Sulën e zgjuan. Autoambulanca qëndronte pranë portës së shtëpisë, në rrugicën e shtruar me kalldrëm. Shoferi i tha se e prisnin në spital për një konsultë tepër urgjente.

"Kush të dërgoi"?

"Drejtori".

"Në punën tonë gjithnjë hyjnë në mes të tretët, pacientët", tha Irfani duke u veshur.

Shoferi nuk foli, po mendoj:

"Ne, shoferët, jemi shumë solidarë me shokët... Dhe kemi të bëjmë me hekurishte, jo me njerëz..."

"Si thua"? e pyeti Irfani, duke hypur në automobil.

"Ç'të them, ju e dini vetë si duhet vepruar".

"Desha mendimin tënd", nguli këmbë me sinqeritet mjeku.

"Meqë ngul këmbë, po ta them: sedra e sëmurë dhe ambiciet ndërmjet mjekëve janë armiqtë më të rrezikshëm për jetën e të sëmurëve. Kështu ma pret mendja mua dhe, me ç'kam parë e ç'kam dëgjuar, shumë njerëz janë marrë në qafë për musteqet e Çelos..."

"Jepi më shpejt", e ndërpreu Irfani i tronditur.
"Diagnoza, pak nga pak po përcaktohet... Edhe mjeku më i zoti ka nevojë të vizitohet tek të tjerët për sëmundjet e veta..."

"Nuk të kuptoj", tha shoferi i habitur.

"Edhe sëmundjet morale kanë nevojë të diagnostikohen me kohë dhe drejtë..."

"Të falemnderit", i tha shoferit dhe zbriti, pa u shuar motori.

Shoferi e pa i çuditur.

"Është i përgjumur", tha me vete dhe u mbështet në ndenjësë për të marrë një sy gjumë.

Irfani hyri me nxitim në pavion. I operuari kërciste dhëmbët nga dhimbjet dhe mudohej të lëvizte e të mblidhej krruspull.

"Ç'ka ndodhur"? pyeti, pa u dhënë rëndësi drejtorit dhe dy mjekëve, që rrinin pranë të sëmurit.

"Ka dhimbje të forta... Ne s'kuptojmë gjë", u ankua asistenti.

Irfani u ul në fron dhe vizitoi të sëmurin, të cilit i kishin lidhur këmbë e duar, që të mos lëvizte.

"Bëjeni gati për operacion"!

"Si?"

"Duhet hapur përsëri", tha mjeku, pa treguar që asistenti, duke i pastruar zgavrën e barkut, kish shkaktuar

një ngatërrim zorrësh. Ato po kalbeshin.

"Prisni një herë"! tha drejtori. "Jemi edhe ne këtu dhe nuk jemi hunj gardhi, po mjekë..."

Irfan Sula kafshoi buzën e poshtme, që të mos thonte ndonjë fjalë të rëndë, po arësyen prap nuk desh ta tregonte; që të mos prekej asistenti.

"Kuptomëni, pra: vetëm përsëritja e shpejtë e operacionit do ta shpëtojë nga vdekja... Ju mjafton kaq"?

"Bëj ç'të duash", tha drejtori i inatosur dhe i dëshpëruar, dhe doli nga pavioni.

"Budallallëk", mendoi kirurgu, duke ecur pas të sëmurit, që e shtynin drejt sallës së operacionit. "Kot nuk ua tregova shkakun. Pas gjysmë ore do ta marrë vesh kushdo".

Atë natë ai, bashkë me asistentin, nuk iu ndanë të sëmurit. Në mëngjes, pasi që shmangur çdo rrezik, lanë porositë e nevojshme dhe dolën në rrugë. Ishin të dy të lodhur. Kirurgu s'i vinte faj asistentit të tij, i vinte vehtes, qortonte vehten, që e kish mbajtur atë nën tutelën e mosbesimit.

Akuzat e padrejta të drejtorit i kish bërë hi e pluhur kolektivi, por ky kontroll i vehtes ishte njëqind herë më i rëndë se çdo akuzë. Vetëm ajri i freskët i zbardhëllimit sikur po ua largonte dalëngadalë lodhjen dhe gjumin. Pranvera buzëqeshte. Bari dhe lulet e oborrit qenë stërpikur nga vesa. Gjithçka ndilte gëzim dhe prehje.

"Je lodhur shumë", i tha kirurgu asistentit të vet, duke vështruar fytyrën e tij të zbetë e të hequr.

"S'i thonë shaka: desh më iku nga duart një njeri".

"Rëndësi ka që e shpëtuam dhe që mësuaam shumë. Tani edhe unë, edhe ti do të jemi më të zotët, më të fortë para vdekjes..."

ATJE KU THËRMOHEN DALLGËT

1

Po e prisja tek një barakë e vjetër pranë detit. Muzgu ia kishte lënë vendin natës. Nuk dukej asnjë kontur mali. Një çarçaf i zi me disa njolla të arta drite elektrike shtrihej para meje. Tutje skuqte fari i portit. Drita e tij shtrihej mbi det si një pikëçuditëse e përmbysur. Ajo vijë e përflakur dridhej nga dridhma e valëve. Mendoja për Lenin. Ajo do të vinte; do të rrinim bashkë e pastaj do të ndaheshim për të punuar në turnin e natës.

Vëlla, e di si të duken minutat kur pret?

* * *

Me Lenin ishim rritur bashkë, shtëpitë i kishim pranë. Më kujtohet kur uleshim në zallishte dhe luanim me oda. Ndërtonim ndonjë tendë me degë plepi dhe e bënim si kasolle, krijonim një familje.

Fëminia jonë... kohë e largët e papërsëritshme!

Edhe në shkollë shkonim bashkë. Ishim në një klasë. Ajo rrinte në bankë para meje. Atëhere mbante dy bishtaleca të lidhura me dy fjongo të kuqe. Unë i zgjidhja fjongot në orë të mësimit. Ajo kthehej nga unë, më shikonte me inat dhe më kërcënonte se do t'i thonte mësueses. Unë i tregoja grushtin dhe ajo heshtëte.

Keq e kisha kur ngrihesha në mësim dhe merrja dysh. Leni do të vinte tek oborri e do të thërriste:

- Mamaja e Sandrit! Sandri sot mori dysh!

Atëhere, ku të fshihesha për t'i shpëtuar të rrahurit të mamasë. Dilja në oborr. E ndiqja deri në shtëpi të saj. Qëllonte që s'e arrija, po, kur e zija, e rrihja pak dhe ajo hynte duke qarë në shtëpi. Me gjithë atë, në përsëri ishim të afërm me njeri tjetrin.

Kështu kaloi fëminia jonë.

Pastaj filluam të largoheshim ca. Ajo mbaroi të shtatën dhe unë hyra në gjimnaz. M'u desh ta lë përgjysmë e të zë punë. Kur u ktheva me lejë pas një viti, Lenin e pashë në verandë të shtëpisë së saj. Sa ishte rritur, ç'shtat kishte

hedhur, sa e bukur ishte bërë Leni, vogëlushja!

Në rrugë e shihnim njeri tjetrin me ndrojtje. Ngurronim të përshëndeteshim. Një herë i folam. Ajo u afrua drejt meje dhe fytyra iu bë lukuq.

- Ku punon?

- Në port, spontatore...

Kishte shumë kohë, ndonjë vit. Punonte me turne... Pastaj heshtëm, s'dinim ç'të thonim. Ajo ngriti kokën. Sytë e saj shkëlqenin. Sa kisha ndryshuar unë!... Isha bërë pak hijerëndë. Le, po kaloja dhe pa folur. Kaq shpejt e kisha harruar fëmininë tonë, shoqërinë tonë? Ajo më shikonte drejt në fytyrë. Sa gjëra më thonin sytë e saj të shkruar dhe ajo ngjyra e trëndafiltë e fytyrës!

- Pra mirë u pafshim!... Mos na harro!

Të nesërmen më mbaronte leja dhe u largova duke marrë me vete si kujtim sytë e saj të ndezur dhe ngjyrën e trëndafiltë të fytyrës...

Pastaj, mbarova ushtrinë dhe hyra në punë në një fabrikë vaji. Punoja me turne. Lenin e takova dhe disa herë të tjera dhe... ç'të prisnim më?

* * *

- Leni, i shikon yjet?

- ...

- Ndonjëherë do të t'i stolis flokët me yje. Të të njoh lehtë në errësirë.

- Qenke bërë poet sonte.

- Kam dëgjuar se dikush, i madh, paska thënë se në rini të gjithë njerëzit janë poetë.

- Sa bukur paska thënë!

Hëna shkëlqente se një shpatë e artë, e harkosur.

* * *

Yje të mjegulluar. Një kukuvajkë ia thonte këngës diku pranë. Përpara vezullime dritash, që dukeshin si një qytet i ngritur në errësi. Llampa peshkatarësh.

Leni pranë meje. Heshtëte. Unë i ndjeja frymëmarrjen. Ajo kish mbështetur kokën e bukur në supin tim. Dy hije lëvizin bregut të detit.

- Ç'janë?

- Si unë dhe ti...

- Tek ato drita punon im at. Ndofta ka dalë me sandall të mbledhë peshkun. Ku ta dish?... Ai tha se do të dilte të gjuante sonte.

Ç'do të thotë yt at kur të të kërkoj unë?

- !...

Një hije po afrohej duke u lëkundur. Zmadhohej gjithnjë e më tepër. Po vinte drejt nesh. U ndal. Po shikonte me vërejtje.

- Ç'do ky budalla?

* * *

Makina ecte gërmuqe mbi rrugën e lagur. Ishte një maqinë e vjetër që kish bërë dy herë revizionim kapital. Llamarinat kërcisnin nga shiu.

Rruga mbetej nga pas e qullur, e ndriçuar si një pasqyrë e prishur. Qielli nganjëherë ndriçohej, pastaj pllakoste një errësi e dendur ku spikateshin llampa elektrike si xixëllonja të zbehta.

Makina çonte punëtorët për në turnin e tretë.

Kush e mendonte që babai i Lenit të mos kish shkuar në punë, por duke kaluar andej për në shtëpi, të na gjente bashkë!

... E di ç'isha unë, sipas tij? Një arrogant që i kisha marrë mendjen së bijës. Po t'i vardisesha akoma asaj ai do të më shtrydhte si...si... Unë u mundova t'ia ul zemërimin duke i përsëritur se e kisha seriozisht, se unë dhe Leni kishim vendosur të paraqiteshim tek ai së shpejti për të...

Pastaj, unë i thashë, (ç'budallallëk bëra që u nguta):

- Baba, ju përse nxeheni kot?

Si?! E quaja edhe baba?! Ku e kisha gjetur baba unë atë? Sa të ishte gjallë ai, Leni s'do të bëhej gruaja ime kurrë, kurrë!

Kapi Lenin për dore dhe, duke e tërhequr pothuaj zvarrë, e shpuri në gjymëserrësirë. Hera-herës ajo kthente kokën nga unë. Nuk e shquaja mirë, po sytë e saj më dukeshin të përlotur. Mbete i ngrirë. Deti ishte egërsuar dhe si shenjë e zemërimit tim, që donte të shpërthente, shkrepiti një vetëtimë e largët...

- Sandri, më jep një cigare se i kam harruar në shtëpi-, më tha shoku im në maqinë. Ai i harronte shpesh cigaret në shtëpi. Ia dhashë. Makina ecte shtruar, e shoqëruar nga kënga e ngjirur e pikave të shiut mbi llamarina.

- Vëlla, jepmë një këshillë... si t'ia bëj hallit?

2

Sapo mbaruam rrethimin, ia dhamë peshkun njerës prej anijeve dhe vetë u nisëm për valanith në të zbardhur. Unë kisha fjetur gjithë natën se s'pata roje, kështu që nuk zbrita poshtë në palmetë për të fjetur. Mora kovën e fillova të nxjerr ujë nga deti për të pastruar kuvertën. Anija vazhdonte lundrimin me gjithë shpejtësinë e saj. Unë përkulesha me kovën dhe ndjeja forcën e shpejtësisë kur ma tërhiqte kovën e mbushur që mezi e mbaja. Midis Sazanit dhe Karaburunit, në të hyrë të grykës ka shumë thellësi. Është një thellësi e llahtarëshme, një blu e mbyllur, shumë e mbyllur.

Hidhja ujët e nxjerrë mbi kuvertë dhe ndonjëherë më duhej ndonjë pjesë ta fshija me fshesë.

Pranë më kaloi i ati i Lenit. Më hodhi një vështrim të nxituar, të mvrejtur e të menduar dhe hyri në palmetë pa thënë asnjë fjalë. Më mbetën në mend sytë e tij të lodhur e të skuqur nga pagjumësia. Ai kishte ndenjurr tërë natën zgjuar. Kështu e kanë feneristët.

Eh, vëlla, të tillë vështrim më hedh gjithnjë. Një soditje me prapamendim kalimthi, dy-tri shkëndiza mendimi e, pastaj, më zhduket nga sytë. Tani është zbutur ca. Në fillim më shikonte sikur do të më përllante të gjallë. Më vështronte

gjatë me inat, pa e hequr llullën nga goja dhe duke lëpirë mustaqet e zverdhura nga nikotina. Dhe s'më vinte mirë. Ai ishte babai i Lenit.

Ditën e parë kur erdha në anije...

Unë gjithnjë kam patur qejf të punoj në det me peshkatarët. Këtë dëshirë ma plotësuan. Ditën e parë iu paraqita kapedanit me një fletushkë në dorë. Ai e lexoi dhe më tregoi vendin ku do të flija në palmetë. Kur zbrita poshtë,... ai, për nder ai! Sa ngushtë u ndodha, vëlla! Më hodhi një nga ato vështrimet që donin të më përulanin. Ai u ngjit lart bashkë me kapedanin. Po ta dija që do binim bashkë në një anije, sdo ë kisha pranuar. Krevatet i kemi përballë njeri tjetrit. Si e sjellin rrethanat. Ulesh për të fjetur dhe atë e ke përballë. Ndeshesh me vështrimin e tij dhe të duket sikur do të të thotë:

- ... Do të ta shtyp kokën po iu vardise akoma sime bijë.

Tani, çuditërisht duket i menduar.

Unë po hedh kovat e fundit në kuvertë. Ajo shkëlqen nga rrezet e para të diellit. Leni po fle. Ajo këtë javë ka turnin e dytë. Ka rënë vonë për të fjetur dhe tani...

Lashë kovën mbi tratë dhe kalova nga bashi. Kur lundrojmë, më pëlqen të ulem në majë të bashit. Më pëlqen të shoh se si anija çan ujërat e kaltërta duke lënë pas spërkatje dhe shkumë.

Mendoj për Lenin. Dy-tri herë e kam takuar, jo më shumë. Dhe ato, fshehurazi. Ai e ka ndaluar të takohet me mua.

- Po të pashë dhe një herë me të, ta këputa kokën si të zogut. Kupton? Kur të të vijë koha do të të jap një bandill djalë. Ai është rrugaç dhe dembel (në fillim ai e dinte se isha pa punë, po Leni i kishte thënë që punoj me turne). Ashtu?... Prapë s'bën për ty. Hiq dorë nga ai. Kupton? Kështu i kishte thënë, pikërisht kështu; që unë s'bëja për të. Po ai do ta kuptojë, duhet ta kuptojë, se në mos dashtë ai, unë dhe Leni... Kështu që koha do ta detyrojë ta kuptojë.

Ai tani po fle. Nganjëherë më vjen keq për të. Duket shumë i menduar.

Sa bukur është të lundrosh në këtë det kaq të qetë.
Ç'ajër i freskët, s'di të ngopur!...

* * *

Na u desh një orë që anija të zinte vend buzë një shkëmbi. Ai dhe Verua kishin dalë me sandallat për të lidhur çimat shkëmbinjve. Në këto raste duhen marrë të gjitha masat që anija të jetë e sigurtë. Nga ora tetë filluam nga puna. Terreni ishte i vështirë dhe ne vumë dërrasa për të kaluar nga njeri shkëmb në tjetrin. Ç'shkëmbinj të thepisur; një çikë të humbisje ekuilibrin dhe të bëhej koka shoshë. Dukej sikur ishin ngulur mijra gjilpëra mbi ta. Pesëdhjetë metra larg ishte një barakë e vjetër e mbushur me valanith. Ne na duhej ta ngarkonim në thasë dhe ta hidhnim në anije. Në molo do të vinin ata të Ekstrat-taninit ta merrnin me makina.

Ç'lodhje! A e beson, vëlla: orë të tëra rresht nga baraka në anije, me nga dy thasë valanith në krahë! Dhe mbi të gjitha, një vapë e keqe korriku. Po lodhja s'të duket, kur do ta mbarosh punën, kur di përse punon. I ati i Lenit, si më i vjetër, lidhte thasët dhe na i ngarkonte. Kur më qëllonte të shkoja tek ai, më hidhte një vështrim që tregonte edhe keqardhje edhe dashamirësi. Pastaj më ngarkonte. Po një fjalë s'nxirte nga goja. Një herë më hodhi një thes të madh.

- Edhe një tjetër, - i thashë.

- Ikë, ikë se mjaft e ke. Do të punojmë gjithë ditën, - këto ishin të vetmet fjalë që më tha që kur erdha në anije.

- Edhe një tjetër, - ngula këmbë unë.

Ishim mbytur të gjithë në djersë. Të frynte pak erë të paktën, po hiç; s'luante asnjë gjeth. Këndonin gjinkallat me nge rrepeve, si të na e bënë për inat. Vetëm në drekë pushuam gjysmë ore.

* * *

Vështroja si binin yjet e shuheshin n'errësirë. M'u kujtua gjyshi kur më thonte se në gusht bien shumë yje. Isha shtrirë mbi thasët e valanithit dhe sytë ia kisha mbërthyer qiellit blu, stolisur me mijra xixa të zjarra. Vështroja se si dyreku ndante në dysh dhe bashkonte Arushën e madhe. Motorët e anijes gjëmonin duke shtyrë përpara me tërë shpejtësinë. Më dukej sikur fluturonim midis yjesh me

këta thasë valanithi ngarkuar.

A e di Leni, unë tani po mendoj për ty. Ti, me pantallonat e zeza, hipur mbi një pupe hekuri, kontrollon mallrat. Sikur ta dije, Leni, sa të vështirë e kam të ndeshem me vështrimin e tij.

- Ç'është ajo gjë e zezë atje mbi thasë? - pyeti i ati i Lenit.

- Sandri duhet të jetë.

Unë bëja sikur flija.

- Sandri është djalë i mirë, - shtoi përsëri zëri i dytë.

- Hë?

- Sandri është djalë i mirë, punëtor dhe i shtruar.

- Ashtu, thua ti?

Leni, zëri i tij është zbutur: Ne kemi disa ditë që s'jemi takuar. A të ka folur për mua?

- Njeriu duket më mirë në punë, në marrëdhënie me shokët, - foli prapë zëri i dytë.

- E kam njohur që fëmijë. Jemi komshinj. Më është dukur gjithmonë dembel dhe i ngathët.

- E ke gabim...

- Ashtu?...

Zërat e tyre humbën në thellësinë e palmetës. Fluturoja midis yjesh.

E mban mend Leni kur pamë atë baletin shqiptar që erdhi atëhere në qytetin tonë? Ty të pëlqeu shumë. Të pëlqyen ngjyrat, gëzimi, forca e valleve. Si u drodhe ti kur ajo heroina desh të mbyste fëmijën. Shtrëngohesh fort mbas meje.

- Rri e qetë se s'do ta vrasë.


- Vërtet, Sandri?

Kur dualëm nga çfaqja, kushedi sepse, ti më thojë se do të kemi shumë fëmijë. Shumë, shumë.

E mban mend, Leni, si ëndëronim ne? Prapë do ëndërojmë. Ai është zbutur, Leni. Ai...

Po dremisja. Kur u përmenda, ndjeva një xhaketë hedhur krahëve. Ishte xhaketa e tij.

Dyreu përsëri ndante më dysh dhe bashkonte Arushën e madhe.



BASHKËBISEDIM ME SHEKUJT E KALUEM

Një sesion shkencor arkeologjik

Arkeologjia, një shkencë relativisht e re, asht pjesë e historisë. Shkenca mbi lashtësinë u ba në shekullin XX jo vetëm një shkencë e ditëve tona, por edhe politikisht aktuale. Në burimet arkeologjike, në bazë të të cilave rindërtohen edhe faktet historike, mungojnë personazhet. Arkeologët mund të gjykojnë jo vetëm mbi veglat e punës, jetesën ose ekonominë e kohës së lashtë, por edhe mbi trajtat e jetës shoqnore. Mjetet e prodhimit janë me shumë randësi për studimin e formacioneve shoqnore që janë zhdukë. Mjetet e punës janë tregues i atyne marrëdhanieve shoqnore në të cilat zhvillohet puna. Këtu, qëndron edhe vlera e madhe e zbulimeve arkeologjike.

Ilirët kanë qenë banorët e lashtë të vendit tonë. Për arkeologjinë shqiptare problemi i etnogjenezës ilire, i lashtësisë së ilirëve në vendin tonë asht një problem i dorës së parë dhe i rrahun nga dijetarët. Zbulimet e Pazhokut e të Maliqit, i tronditën themelet e tezës së vjetrueme të dijetarëve borgjezë, e cila i ban ilirët të ardhun në gadi-shullin ballkanik në një kohë relativisht të vonë. Në kumtesën mbi rezultatet e gërmimeve në vendbanimin prehistorik të Tranit (Bilisht-Korçë) doli se të dhanat arkeologjike tregojnë se fillimet e formimit të elementeve të etnosit ilir i përkasin eneolitit, çka do të thotë se Ilirët janë autoktonë, në Ballkan.

Cili që zhvillimi ekonomik, shoqnor e kultural i ilirëve që banuen në vendin tonë gjatë gjithë kohës së ekzistencës së tyne, për të cilët arkeologjia para çlirimit nuk tha asgja dhe harta arkeologjike mbeti e bardhë? Kërkojnë përgjigje edhe mendimet e vjetra e të reja të cilat janë përpjekë dhe përpiqen t'i copëtojnë ilirët dhe të shohin në krahina të veçanta, tipare të veçanta kulture dhe si pasojë edhe origjinë etnike. Përgjigjet u dhanë edhe në kumtesat e këtij sesioni arkeologjik.

Kodërvarret e Krumës (Kukës) që u gërmuen në këte vit i përkasin fundit të kohës së bronxit dhe fillimit të hekurit; ata nuk ndryshonin nga kodërvarret e tjera të kësaj kohe të zbulueme në Pazhok, Mat, Vajzë e Dropull. Gjurmuesit e këtyne kodërvarreve ngritën me të drejtë problemin e rishikimit të diferencimit shoqnor të ilirët.

Për një qytet ilir, për praninë e një ekonomie e kulture qytetare të një shoqërie skllavopronare kumtuen edhe arësimitarët e Kolonjës, të cilët, me forcat e veta, gërmuen në kodrën e Hallmit, n'afërsi të qytetit t'Ersekës. Për një zhvillim të tillë kumtuen edhe gjurmues të tjerë të lashtësive ilire. Në krahinën e Matit gjetjet arkeologjike që i përkasin kulturës ilire shtohen dita ditës. Jo harta e Shqipnisë, por edhe harta e Matit asht mbushë plot qendra ilire. E tillë asht edhe qyteza malore e Xibrit jo shumë larg Klosit. Sendet arkeologjike të zbulueme në gërmime, ashtu sikurse u kumtue në sesion, u përkasin ilirëve dhe janë të ngjashme me ata të viseve të tjera ilire. Për vendbanime të fortifikueme ilire, për qytete ilire folën në sesion mësues e arkeologë. Në rrethet e Pogradecit, t'Elbasanit e të Korçës ekspeditat, gjurmimet arkeologjike kanë zbulue një tok qendra të reja të panjohuna deri dje që shkojnë nga parahistoria deri në mesjetë. Në kalanë e Pogradecit, nën muret mesjetare, dolën muret e qytezës ilire.

Tue shikue objektet e ekspozueme me rastin e sesionit ose materialet ilustruese të gërmimeve e gjurmimeve arkeologjike, të tërhiqte vemendjen diçka e vogël, por shumë interesante. Nga Elbasani ishte sjellë e ekspozue një përkrenare ilire, e gjetun në varrin e një luftari po në qytezën e shkambit Shlliut (Elbasan), e cila mbante emnin ilir të pronarit Kailla. Fragmentet e një përkrenareje bashkë me armë ilire gjindeshin edhe midis materialeve të zbulueme në kodërvarret e Krumës: një kodërvarri nga Mati i takon edhe një përkrenare tjetër ilire. Në fotografitë që tregonin zbulimet e reja në rrethin e Pogradecit ishte edhe ajo e përkrenares ilire të Starovës. Këtyne katër përkrenareve mund t'u shtohen edhe të tjera të zbulueme në këto vitet e fundit në vende të tjera. Kur e di se përkrenaret ilire janë përdorë si mjet për përcaktimin e një krahine ilire me tipare të veçanta, e cila përfshin vetëm veriun e Shqipërisë, nuk asht e vështirë të kuptohet se sa të pathemelta janë këto përpjekje për copëtimin e Ilirisë. Vetë materialet arkeologjike po hedhin poshtë ndamjet etnokulturale të sajueme gjoja mbi të dhanat e arkeologjisë.

Në rrenojat e Jermës pranë Gjirokastrës po dalin në dritë tepricat e një qyteti ilir, me një ekonomi e kulturë qytetare të lulëzueme si shumë qytete të tjera ilire bashkëkohëse. Qyteti ilir i Jermës u ngrit në shek. IV para erës sonë, që asht koha e formimit të shoqnisë skllavopronare ilire. Ai ka qenë një qytet kaon, i njenit nga tre fiset e mëdha ilire të jugut. Në gërmimet u kumtue se materialet që pasqyrojnë kulturën ilire në këto vise po bahen gjithënjë ma

të shumtë. Arkeologjia shqiptare e ka provue se emnat e njohun në historiografi si epirotë e Epir, për banorët e per trevën ma jugore të Ilirisë kanë kuptim thjesht gjeografik. Për kaonët, thespirotët, molosët e banorët e tjerë të Epirit nuk ka vend dhe as që mund të mendohet për përkatësi etnike tjetër veçse ilire. Elementet e kulturës helene nuk janë tjetër veçse ndikime t'ardhuna si rrjedhim i zgjanimit të marrëdhanieve ekonomike dhe të hyme në kushtet e një niveli të caktuem të zhvillimit të forcave prodhuese të ilirëve, fenomen ky i vrejtun edhe në vise të tjera të botës antike.

Tue folë për gjurmimet e tyne, kumtuesit zunë në gojë edhe emnat e disa qyteteve ilire, të njohuna nga burimet e shkrueme të lashta. Qytetet ilire si Lynku, Cmfali, Syberi, Enkelana kanë ekzistue në një kohë kur në Iliri kishte edhe qytete të tjera si Shkodra, Lisi, Dimali, Amantia, Bylisi, Foinika, rrenojat e të cilave tashma dihen se ku gjinden. Mundet që të dhanat janë ende të pamjaftueshme për lokalizimin e tyne, por optimizmi dhe kambëngulja e gjurmuesve do të fitojnë, ashtu sikurse u kunorëzuen me sukses në kërkimet e tyne.

Pranë ilirëve në kumtesat ishin edhe arbënt. Arbënt, si pasardhës të ilirëve, jetuen aty ku para tyne kishin pasë trojet ilirët dhe trashëguen kulturën e tyne. Nuk ka si të jetë ndryshe, (sadoqë edhe këte të vërtetë ka dijetarë që duen t'ua mohojnë shqiptarëve), sepse këtë e tregojnë fort bukur të dhanat e arkeologjisë. Arësimtari i Mirditës po i gjen gjurmët e arbënve gjithandej, deri në viset e thella malore. Arbënve të mesjetës u takon edhe qyteti Sarda; sot rrenojat e tij gjinden në Shurdhah, në lindje të Shkodrës. Sikurse njoftuen kumtuesit gjurmimet e porsafillueme janë shumë premtuese dhe para dëgjuesve në sesion ato përmendin muret e epërme e të poshtme të qytetit, materialet e gjetuna në gjurmime, sidomos ato të varrezës, të cilat i përkasin kulturës së arbënve mesjetarë.

Njeni mbas tjetrit, arkeologë e arësimtarë, thjesht e rrjedhshëm folën për gjurmimet dhe rezultatet që kishin arritë. Mendimet i mbështetën në materialet që ata zbuluen. Dhe këto materiale lidheshin mirë njeni me tjetrin. Ata dhanë një kontribut të çmueshëm në studimin e së kaluemes së lashtë të vendit tonë. Në përgjithësi në sesion u vrejtën përpjekje për ta ba arkeologjinë një shkencë luftarake. Të vetëdijshtëm për detyrat e mëdha të s'ardhmes për ta çue edhe ma përpara arkeologjinë shqiptare, ata e dinë se, tue forcue bashkëpunimin, me një punë kambëngulëse, do t'i vazhdojnë

gjurmimet e studimet e ardhëshme për të nxjerrë në shesh të vërtetën e historisë së popullit, tue luftue e hedhë poshtë çdo shtrembënim që do t'i bahet së kaluemes sonë.

The Pirusts



Strabo the ancient geographer and, later, Ptolemy the ancient historian were the first to refer to the Pirusts. The latter says that the Pirusts lived in the present districts of Mati, Mirdita and the eastern highlands of Lezha in north Albania.

The Austrian historian, Karl Patsch, says that the Pirusts were skilful metal workers. This has also been proved by the recent archaeological findings in the burial mounds and fortified centers of the districts of Mati and Mirdita. The findings there include metal objects like weapons, work tools, ornaments and handicraft objects.

The Pirusts were a warlike tribe. They took part in the great Illyrian uprising of the period from the 6th to the 9th year of our era and did not lay down their arms until they were almost entirely destroyed by the Roman troops.

Musical Instruments

Used by the Illyrians



In ancient times, the Illyrians stood out not only as warriors but also as musicians and dancers. A written document of the ancient times has it that the Dardans (an Illyrian tribe) were considered great music lovers playing the flute and string instruments. The Illyrians sang war songs and danced sword dances (dances which are still popular in the Northern Highlands to this day). On the monuments and sculptured reliefs discovered through archaeological excavations one can see flutes, lyres and other musical instruments carved on stone. In the ancient Illyrian cities our archaeologists have unearthed various public buildings like odeums and theaters used for musical performances.

Pamje të jetës shoqërore në fshat

BISEDE NË MAL

- Ti je i ri në këto anë, sadoqë thua se i ke njohur mirë këta vendalinjtë e mi, - më thosh bashkëfolësi me një zë të çjerrë e të mbytur, që dukej sikur nuk i dilte nga fyti, por diku nga thellësi e mushkërive.

- Fjala vjen, - vijoi ai, ndërsa unë e shikoja me sy të ngulitur në një xhungë rrumbullake në majë të hundës, - ty o djalosh të kanë bërë përshtypje qysh në fillim këto shtëpitë tona të mëdha me dy kate. Kur hyn brenda në to njeriu me të vërtetë habitet me budallallëkun e atyre që i kanë ndërtuar.

Ai nuk më vështronte tek fliste. Me vetulla të ngrysurat prej natyre sodiste tutje një lëndinë me bar në faqe të malit, ku ishte shpërndarë tufa e deleve. Ajo ishte një korie e vogël në mes të një pylli të madh lisash, që dukej si gëzof i gjelbërt i hedhur në shpinën e malit. Pylli i dendur shtrihej si brez i vazhdueshëm kadifeje gjer pranë majës së shtypur, ku gjendej një pllajë e butë plot me bar të njomë dhe lule të bardha.

Bashkëfolësi ishte një plak babaxhan nja gjashtëdhjetë e ca vjeç. Megjithëse zërin e kish të ngjirur e të ashpër, ndërsa fytyrën të zeshkët me një lëkurë të trashë, të regjur nga vitet, megjithëse e tërë pamja e tij ish disi e egër, ai plak tek fliste dukej aq i ëmbël sa që mua, nuk e diç sepse, më vinte ta përqafoja. Më pëlqejnë malësorët e atyre anëve. Gjithmonë më ka bërë përshtypje ajo mënyrë e veçantë të përshëndeturi që kanë ata; kudo që të jenë, edhe pa të njohur fare, do të ndalen me ty, do të përshëndeten me dorë në zemër, sikur duan t'ia falin atë mikut që takojnë.

- Përse, o xha Qamil, - e pyeta, duke rrotulluar nëpër gojë një fije bari, - mua shtëpitë tuaja më pëlqejnë, ndonëse kanë një të metë, janë ndërtuar pa sistem?

Ai m'i nguliti sytë me një pamje të habitur.

- Unë s'marr vesh nga ato "sustemet" që më thua ti, or birçe. Ajo është puna juaj që keni shkollë të madhe. Unë diç të them këtë: ata që kanë ndërtuar këto shtëpi, s'kishin mend në kokë. A e di ti se ato kthina të mëdha sa tri dhoma të zakonshme janë ndërtuar vetëm e vetëm për nja dy-tri dasma,

që do të bënte i zoti i shtëpisë gjatë tërë jetës së tij?
Kanë qenë dollibashë këta tanët, jo shaka! Njëherë njëri,
kur martoi vëllanë, shtroi dyzet sofrë me treqind okë mish.

Unë vura buzën në gaz.

Xha Qamili tërë jetën e tij kish qenë bari, bile thonë se shokët i ka të rrallë në këtë punë. Thonë, gjithashtu, se që kur filloi lufta nacional-çlirimtare, ai kish dalë partizan. Kisha dëgjuar nga të tjerët se xha Qamilin e kishin lutur të qëndronte në ushtri, por ai s'kish pranuar. I qante zemra për arat, për tufat e deleve, për kullotat malore dhe ajrin e pastërt të pyjeve, prandaj që kthyer në fshat me të mbaruar lufta.

Xha Qamili u hutua nga buzëqeshja ime.

- A di çfarë? - më tha. - Ju të rinjtë me shkollë që na keni ardhur tani, jeni me tërë mend djem të mirë. Me të parë një grua të ngarkuar në ara, ia mblidhni brigadierit. Pa le që shkruani edhe në gazetë! Por më parë ka qenë ndryshe këndeje. Njerëzia bënin si t'u tekej. Kishte tjetri vajzë, fjala vjen, e shiste pa iu dridhur dora. Po tani? Pa hajde, or qerrata t'i thuash, ta mban ta shesësh më vajzën si mushqerrë?

Më erdhi të qeshja, por u mbajta, se mos xha Qamili më zemërohej. Thoja me vehte se këta malësorët tonë, me ato qeleshe të bardha rrumbullake mbi kokë, sikur duan t'u ngjajnë maleve të krahinës së tyre me majat gjithmonë me borë. Por xha Qamili më linte një përshtypje tjetër. Më dukej sikur derdhte nga shpirti i tij në zemrën time tërë atë bujari të singërtë që rrallë herë e takon.

- Nuk është puna aty, o xha Qamil, - i thashë, nuk është fjala te frika. Ne mundohemi që fshatari ta kuptojë se është gabim t'i shesësh ose t'i blesh vajzat. Pastaj, ti e di vetë, po e bëre një gjë me frikë, kurrë s'do ta bësh ashtu siç duhet.

Ai më vështroi me një pamje t'atillë sikur desh të thonte se i kuptonte thellë ato që i folën, por pas pak, pasi kroi zverkun e nxirë me një copë shkopi të tharë, ma priti:

- Mirë, mirë e ke ti xhanëm, por për një gjë s'më mbushet mendja. Ja ta pleqësojmë bashkë. E zëmë se kam një vajzë. Ti më vjen e më thua: Qamil, hiqja brekushet vajzës,

preja edhe flokët e ma vish ashtu qytetarçe. Për nder është e rëndë kjo... Por tani s'ke ç'i bën, xhanëm. Ato po i veshin vetë ato fustankat me lule.

- Ta merr mendja, xha Qamil, - i thashë; - tani kanë ardhur kohë të tjera.

- Ashtu është vërtet, - foli ai më tepër me vetveten, se sa me mua.

Kujtova se xha Qamili tani do ta mbyllte bisedën. Por përnjëherë fytyra e tij ndryshoi, picërroi sytë e vegjël sikur mendjen t'ia kish ngacmuar një mendim i brendshëm dhe, duke buzëqeshur, m'u drejtua:

- Që ta marrësh vesh ti, e vërteta është ashtu siç e thoni ju të rinjtë. Të marrësh xha Zylfinë, për shembull; ai s'ka lëvizur fare dhe është si ai qorri që ka qëndruar tërë jetën në errësirë. Po ti e di edhe vetë se po ta shërosh qorrin e të shikojë dritën e diellit, ai do të zëjë sytë me duar sepse nuk e duron dot. Po pse, or malukat, a ka më mirë se drita e diellit, t'i thuash?

Ndërsa unë po mendoja për fjalët e tia, xha Qamili, vazhdoi:

- Shiko se ç'ka ndodhur njëherë këtu në fshatin tonë. Atëhere kam qenë kryetar i këshillit të fshatit, jo shaka. Më duket nga vitet 49-50. Kështu pra, që ta marrësh vesh ti, besoj se ke dëgjuar për një zakon që kemi patur ne, për hazërllëkun.

E dija ç'ishte hazërllëku. Ky zakon dikur kish qenë mjaft i përhapur në fshatrat e kësaj krahine. Dhëndri duhej t'i paguante të jatit të nuses shuma të mëdha, të cilat shpeshherë i kalonin edhe njëqindmijëshin. Kjo bëhej nën pretekstin se nusja duhej bërë "hazër" për tek burri, por në të vërtetë qe kthyer në një zakon barbar. Si duket këtej vjen edhe fjala hazërllëk. Sa e sa vajza mirreshin më qafë e shkonin tek burra që s'i kishin parë ndonjëherë, në të shumtën e rasteve edhe pleq, pa thënë dot asnjë fjalë.

Unë pohova me kokë.

- Mirë pra - vijoi ai; - njerëzia këtu ishin, siç i thonë një fjale, kokë më vehte. Gratë shiteshin e bliheshin dhe askujt s'ia bënte veshi tërr. Ashtu qe vërtet, ashtu qe zakoni. Ama, ke parë ti që kish rënë dynjaja në bela? Ti

do të thuash përse? Po ja të ta them çkoqur. Deri atëhere, sado të kërkonte i jati i nuses, dhëndri, do ia jepte se s'bën. Ku do t'i gjente? Shumë kollaj. Në fillim shiste ndonjë arë, pastaj, po të mos i dilnin, o burra dhe ca bagëti, pastaj ndonjë kopsht a livadh dhe u lamë.

- E me se jetonte më vonë ky njeri? - e ndërpreva.

- Me se jetonte? Ja, ore, ashtu, hiq e mos e këput. Rroftë shëllira dhe gjiza e kripur. Bënte edhe dasmë që ta mbante mend i tërë fshati e pastaj gjithë jetën mbetej në hava, keq e më keq, si peshku pa ujë. S'po i zëmë më gojë ato që u merrte tahsildari. Por kur ndodhi kjo ngjarje që dua të të tregoj, ahëre kur u ngatërrova edhe unë, Shqipëria u çlirua, njerëzia kish filluar, si të thuash, të marrë veshen. Dikush donte një dyshek, tjetri jastekë e velenxa, sepse po e shihnin tani që ishte më mirë në dyshek se sa në postiqe. Po si iu hapën sytë këtyre njerëzve do të thuash?! Shumë kollaj! Para çlirimit këndeje nga ne përveç tahsildarit nuk shkelte këmbë qytetari, ndërsa fshatarët mirrnin e jepnin me njeri tjetrin. Por pastaj ekipet filluan të vijnë këtu, thujse përditë, u hap edhe shkolla, filloi të bëhej propagandë për të jetuar më mirë. Shkurt, edhe ftujakët tanë filluan të marrin vesh nga bota. U hyri krimbi për të jetuar mirë.

- Mos do të më thuash se e hoqët zakonin e hazërllëkut qysh ahëre? - e ngacmova.

Xha Qamili më vështroi një herë shtrëmbër nga që po e ndërprisja shpesh e më tha.

- Dale, ore prit, qenke si ai që s'e mbajnë këllqet e don të ulet menjëherë në shesh. Unë po ta them kështu që ta kuptosh më mirë. Dëgjo, pra: njerëzit s'qenë më aq budallenj sa të shisnin një arë për një nuse. Po hazërllëku u hoq? Jo e jo, dhe prej kësaj na polli belaja. Kërkonin aq tepër për një vajzë sa që shumica s'ish më në gjëndje të paguante. Por ç'ndodhi? Ndodhi se dynjaja po ngelte pa u martuar. Ngrihen atëhere nja dhjetë burra e më vijnë drejt e në këshillë. Më kujtohet si tani; ka qenë një ditë e nxehtë korriku sa të zihej fryma nga vapa, kur erdhën ata: "O Qamil", më thonë; - ti je pushteti këtu, prandaj ne me ty do ta zgjidhim këtë punë.

I shikova ashtu me ato fytyra të skuqura nga dielli e të mbuluara nga djersët. As që e mirrja dot me mend përse kishin ardhur në mes të atij zhegu, kur gjinkalla ia jepte

në zabej sa të pëlçiste kokën. Hajt pra, ta dëgjojmë, - u thashë! - ç'punë paskeni?

Ka qenë një plak atëhere që e quanin Asllan, i thatë si shkop që mezi rrinte në këmbë, por ka vite që ka vdekur. Ai ma pleqësoi punën. - Kemi një çështje me shumë rëndësi, - më tha. - Që ta marrësh vesh, pardje kërkova për nipçen tim vajzën e Selim Ruçit, por ai deshi njëqindmijë lekë. E ku t'i gjej unë kaq para, më thuaj ti? Të ishte për pesëdhjetëmijë hajde de, por njëqind s'është punë që bëhet kjo.

- E pastaj, - i thashë i inatosur, - ç'hyj unë në këtë mes? - Por ai vazhdoi e s'më la të flas.

- Edhe Rakip Skuqi kërkoi vajzën e Islam Buzës, por ai deshi shtatëdhjetëmijë. Është prishur nga mendtëdynjaja! E ku t'i gjejë Rrapi i varfër aq sa kërkon Islami?

- Ashtu është, - u hodh një tjetër. - Po na mbetën djemtë pa martuar se s'kemi para t'u blejmë nuse.

Pastaj filluan të flasin e të thërrasin të gjithë menjëherë dhe, ca nga vapa e ca nga që s'po kuptoja ç'donin prej meje, iu çorra i xhindosur; - E po mirë, or lugetër: ç'më qaheni mua? Para s'bëhem dot!


- Po ne për këtë kemi ardhur gjithë këta burra, - foli Asllani si më të parë që e mbanin; - ta pleqësojmë një herë.

S'desha, por kur të zë belaja s'ke si ia bën. U ula kokë më kokë me ta dhe e biseduam gjatë e gjërë këtë punë; unë si këshill, ata si pleq të fshatit. Kur më kujtohet tani ajo që bëme, më vjen të ha veten me dhëmbë. E rrahëm një copë herë çështjen dhe erdhëm në përfundimin se duhej caktuar, në fund të fundit, një çmim i prerë për nuset. Dhe e di se sa e caktuam çmimin? Pesëdhjetëmijë... Ti ke të drejtë të qeshësh tani se të duket e habitshme, por kështu ka ndodhur me tërë mend. Bile, duke kujtuar se po bënim një punë të zgjuar, e shkruam vendimin në dy fermane. Një e mbajtëm për vehte dhe një ia dërguam prokurorisë së rrethit. Zotoheshim, gjithashtu, se do ta dënonim atë që shkelte këtë besë të lidhur. Ma ha mendja se edhe sot e kësaj dite diku do të ndodhet në ndonjë zyrë fermani ynë.

- Po pastaj, ç'ndodhi? - e pyeta duke mbajtur ijet me duar.

- Pastaj? Nodhi ajo që s'na e kishte prerë kungulli. Me ta marrë vesh dy komunistët e fshatit ngrihen e më venë përpara. Me ta u bashkuan ca fshatarë e ca të rinj. Si të mos mjaftonin këta, pas katër ditësh vinë në fshat nja pesë vetë nga qyteti e, të gjithë së bashku, na kritikuan rëndë; bile megjithëse e shihja që kisha bërë një budallallëk me brirë, me njërin desh u ndava keq se më kritikoi rëndë... Dua të them se edhe gjëra të tilla kanë ndodhur këtej; ndaj nuk duhet të habitesh. Aq na e preu e aq bëmë... Kështu është, kemi qenë të verbër.

Ndërsa ai sodiste tufën se mos e humbiste nga sytë, unë e vështroja me vemendje. Mendoja se, ndoshta, ai kish të drejtë kur më tha në fillim se unë nuk i njihja sa duhet fshatarët me të cilët jetoja çdo ditë dhe punën e madhe që ka bërë qeveria për t'u dhënë dritën. Dhe kuptova se duhet hyrë më thellë në shpirtin e tyre për të futur dalëngadalë në të gjithë shkëlqimin e botës së re.



BISHTUKU

Shumë njerëz i thonë kandil. Shumë të tjerë kanë filluar ta harrojnë këtë emër, kurse ka akoma që i thonë bishtuk. Unë do ta quaj bishtuk, sepse më pëlqen që ka si nënë fjalën bisht dhe sepse vetë Hasani plak, i biri i Demir Qurkut, e quante bishtuk. Të dy, si Hasani dhe bishtuku, kanë kohë që rrinë karshi njëri tjetrit, por si këtë natë ata s'kanë ndenjurrë. Dhe nata është shumë e madhe. Ajo u ngrys që sapo perëndoi dielli pas shkëmbinjve të bardhë, dhe s'ka të aguar. S'ka asnjë shenjë mëngjesi. Bishtuku rri në këmbë si qiri i zi, e djeg një flakëz të vockël sa një gjuhë rabecke dhe ndriçon. Ndriçon vetëm të zotin që ka përballë duke ia zmadhuar hijen trefish në murin e bardhë të lyer taze. Era që lëshon bishtuku dhe era që lëshojnë akoma muret e lyera me gëlqere e turbullojnë më shumë Hasanin dhe ia zbojnë nga trutë e lodhur edhe atë pikë gjumë që mund t'i vijë. Hasani s'duron dot më. Ngrihet ngadalë, me zor hap dritaren e vogël dhe mundohet të vështrojë përjashta natën pa fund. Ajo shtrihet e plotë dhe si e përjetshme. Sytë e Hasanit nuk dallojnë asgjë përveç errësirës. Ai mbush bulçitë dhe si nxjerr një gëlbazë nga goja, si gëlbazë bishtuku, pështyn gjithë inat përjashta, si të pështynte në surrat natën e zezë. Pastaj e fut kokën brenda dhe sheh bishtukun, tymin e tij të zi e të hollë si bisht miu që ngjitet përperjetë duke u luhatur. Ai luhatet sa herë që i zoti kollitet ose flet me zë, me veten e tij, ose me bishtukun...

... - Kjo është nata jote e fundit, o bishtuk, - foli plaku dhe ngriti kokën përperjetë, në tavan, dhe pa varur llambën elektrike që reflektonte sa një xixëllonjë dritën e bishtukut.

- Nesër do të ndriçosh, moj llambë elektrike, - i foli Hasani llambës duke e vështruar, dhe përsëri u ngrit në këmbë, erdhi rrotull nëpër dhomë, dhe shfryu dufin që e mundonte:

- Më turpërove, moj çupë. Unë të desha si dritën e syrit, kurse ti më turpërove. O ç'natë e keqe! Sonte do të ishte dasma jote, sonde do të çmendej i tërë fisi ynë. Sonte do të bëhej dasma e fundit e kësaj shtëpie. Ti e dije që plaku yt ty të kish të vetme, apo nuk e dije? - pyeti plaku duke iu drejtuar bishtukut dhe heshti.

Dikush ecte në gur, përposh konakut, kur ai po fliste me vete. Plaku mbajti vesh dhe njohu hapat e së shoqes që

po ngjiste shkallët. Pas pak ajo hyri brenda duke mbajtur në dorë një bishtuk, që i ndriçonte vetëm fytyrën.

- Mjaft më, bjerë e fli - tha plaka.

- S'më flihet.

- Atëhere rri, po të paktën shuaje bishtukun. I tërë fshati të sheh që rri e vuan. Drita e bishtukut duket gjer matanë lumit.

- Le të duket, nesër ky s'do të ndriçojë më. Ata ç'po bëjnë? Po flenë? - pyeti plaku për të ndërruar muhabet.

- Flenë. U lodhën gjithë ditën e tashti flenë.

- Në mëngjes dua të flas me ta.

- E ç'punë ke ti me ta. Ata s'kanë faj. Erdhën për të vënë dritat. S'i ke as krushq, as dasmorë. Ata janë punëtorë. I ka dërguar N.I.SH. Elektri i Elbasanit që të vënë dritë fshatrave. Gjithë ditën majë shtyllave lidhin tela. Thonë se po t'i zësh me dorë ata tela, vdes në vend.

- O, ç'vdekje e bukur! - psherëtiu plaku.

- Ptu, lanet, - mallëkoi gruaja - Kjo natë të paska çmendur fare!

- E si të mos më çmendë, kush e mban gjithë këtë turp!

- Turp, turp vërtetë, - tha nëpër dhëmbë plaka dhe zgjati dorën që mbante bishtukun, e zgjati përpara sa ndriçoi errësirën dhe hodhi një hap me kujdes, pastaj një tjetër, sepse bishtuku nuk ndriçonte më tej. Në çdo hap që bënte lëkundej dhe plaku shihte përtej derës se si në koridorin e gjatë të shtëpisë largohej dalëngadalë e shoqja. Sa herë që ajo bënte një hap lëkundej dhe drita e bishtukut.

- Do të mundohem të fle, - tha plaku dhe u shtri, po bishtukun nuk e shoi: - Le të ndriçojë dhe sonte, e ka për të fundit herë.

Ndonëse i mbylli sytë dhe ndonëse mundohet të ndillte gjumin, plaku nuk fjeti. Atij i dilte gjithmonë parasysh e bija dhe ai pa dashje rikujtoi me radhë shtatëmbëdhjetë vjetët e Zafirës...

* * *

Ajo erdhi në këtë botë më 1950 dhe u përshëndet gabimisht me një të shtënë dyfeku, që nga dritarja e vogël. Që kur lindi, ajo e turpëroi t'anë. Gratë ia sollën gabim lajmin dhe Hasani, që po i digjej shpirti për një djalë të pleqërisë, s'pritti po dha kushtrimin nga dritarja e vogël e konakut. Kur hyri në dhomë mamia e fshatit dhe e uroi për vajzën, Hasani u zbe.

- Ç'u turpërova, - tha dhe flaku tej pushkën.

Mamia u mundua ta qetësonte, po ishte e kotë. Ai kishte shtënë me pushkë dhe të gjithë ata që e kishin dëgjuar atë krismë nga kulla e tij e kishin marrë me mend se ç'kish lindur në shtëpinë e Hasanit, kurse...

- Po ja, - ndërhyri përsëri mamia për ta qetësuar, - ku i ke dy djemtë, që mburresh? Njëri në Çërrik, tjetri në ushtri. As njërin e as tjetrin s'i ke në shtëpi. T'i morën edhe nuset dhe të vijnë rrallë e për mall.

- Ashtu është, moj bijë, ashtu është; edhe kjo do të ketë kismetin e saj. Po desha një djalë për pleqëri. Pastaj vajta dhe qita pushkë si i çmendur.

- Hajt mos u turpëro kot, kur të rritet edhe ajo do të qesë me pushkë, mbase edhe më mirë se ti...

... Zafira filloi të rritet. Të jatit i dukej sikur ajo rritej e dobët dhe shëndet keq. Dalngadalë në shpirt të t'et filloi të rëndoje vështrimi i trembur i së bijës. Ajo ishte bërë katërmëdhjetë vjeçe vajzë. Kishte mbaruar shtatëvjeçaren, kishte mësuar të bënte dhe punët e shtëpisë, po kokën kurrë s'e kishte ngritur. Tamam në moshën kur duhet të shpërthente ishte vyshkur. Sytë e saj të kaltër dukeshin të fjetur si një gjol i mbuluar me barishte e shkurre. I jati e shikonte dhe bënte çudi. Ai pandehte se e bija do të çelej dhe do të gëzohej kur t'i thonin të bëhej gati për dasmë. Dhe i thanë një ditë. Ajo nuk u çudit. Sytë e saj s'lëvizën fare. As u çelën as u ngrysen. Ajo e dinte, bile e dinte me hollësi se si ish lidhur fati i saj me një fëmijë që qau një natë të egër dimri se u tremb nga fjalët që thuheshin me zë të lartë prej miqve të largët në konakun e ndarë me gardh e baltë. Ajo, që kur e mësoi, ndjeu t'i hyjë në gjoksin e njomë gjithë ai dimër i egër që e mbajti të mbyllur t'anë dy ditë e dy net. Gjithë ai dimër me borë, i futur me zor në zemrën e saj nga zakoni i lashtë, e thau atë dhe gjithë uji i turbullt i lumit ia errësoi ndriçimin e syve të kaltër. Në çdo hap

që bënte, Zafira ndjente se kishte përpara një lumë dhe rreth e qark një dimër. Këto ndjenja ia zvogëluan asaj botën e madhe dhe qiellin e gjerë me yje. Ajo u rrit e fejuar, e veçuar nga shokët e shoqet, e saja.

- Ti je grua, ti ke një burrë, s'të ka lezet të lozësh rrugës, - këto fjalë ajo i dëgjonte shpesh. Këto fjalë përbënin botën e saj feminare, e cila i kaloi pa lënë gjurmë dhe ja, tashti ajo është vajzë e rritur, punon në arë me shat, mbush ujë në krua dhe vështron rreth e rrotull. Vështron se si përtëritet natyra buzë prillit, se si ndriçojnë pyjet në netët e qershorit kur kositet bari dhe se si këndojnë shokët e shoqet e shkollës së saj. Shikon se si disa prej tyre ndahen dy e nga dy e humbin buzë lumit ku fëshfërijnë shelgjet e ndriçojnë xixëllonjat. I shikon po gjë nuk ndjen. Zemra e saj sikur është tharë. Një herë ajo guxoi dhe mendoi një minutë të vetme për Xhelon. Ai i kërkoi ujë dhe ajo i dha. Ai e ngriti shtambën drejt diellit, piu dhe u lag, pastaj e vuri vetë në krua dhe kur ena u mbush, u ngrit dhe ia vuri asaj në kokë. Ia vuri me duart e tij dhe duke buzëqeshur, sikur t'i vinte një kurorë me lule thane dhe jo një shtambë dhjetë kilëshe. Zafira donte të ngrinte kokën, së paku të shihte edhe një herë buzëqeshjen e tij, po shtamba s'e la të lëvizte. Qafa e saj e hollë sikur i qe gozhduar në supin e saj të brishtë. Natën ajo e pa në ëndër. Të nesërmen sytë saj u hapën dhe kishin në bebe një rreze drite.

- Mirë mëngjes, - i tha ajo t'et.

- Mirë mëngjes, - murmuriti ai dhe vuri re vajzën. Aty për aty u mat t'i thonte së bijës diçka, po u praps. Dësh të bënte me të një shaka, desh t'i kujtonte të fejuarin, po s'i tha gjë. Zafira u largua dhe gjithë atë ditë priste me padurim kohën e drekës që të vinte në krua për ujë. Vajti, mbushi shtambën dhe priti. Në krua s'kish njeri. Mos vallë kishte ardhur shumë shpejt?

- Nuk e ngre dot, - dëgjoi ajo t'i flasin dhe si e trembur ktheu kokën dhe s'u përgjegj. U skuq dhe uli sytë. Ishte ai, Xhelua, shoku i saj.

- Pse s'flet, - vazhdoi ai; - ti sikur s'je nga kjo kooperativë!

Zafira ngriti kokën dhe e pa në sy. Një sekondë të vetme. Xhelua u hutua nga vështrimi i saj i etur dhe mbeti. Ajo iku.

- Mirë mbrëma, - i tha ajo t'et kur ai u kthye në shtëpi.

- Bushtër - i çfryu i jati. - Të pashë edhe një herë me të, ta këputa kokën!

Dhe ajo s'guxoi më as të mendonte për Xhelon. Ajo ishte e fejuar...

"Bushtër" çfryu plaku që kishte më se një gjysmë ore që ishte ngritur e që iu kujtuan thash e themet mbi të bijën dhe Xhelon. "Bushtra" - çfryu përsëri dhe vuri re se si u luhat flaka e tymi i bishtukut. U dëgjua një fishkëllimë.

Plaku hapi sytë, mbajti vesh dhe u bind. Ishte fishkëllima e largët e trenit të punës që dilte nga tuneli.

Fyyyy! Fy, fy! Fyyyy!...

"Baba! - iu bë Hasanit sikur dëgjoi zërin e Zafirës. - Unë do të shkoj në hekurudhë. Dje e shkrova emrin...

Dhe ajo që nisur me shoqet e saja. Në radhë, midis tyre, asaj i që dukur sikur po shkonte përsëri në shkollë, sikur tashti po hynte në botën e saj të perënduar të fëmijnisë...

Treni fishkëlloi edhe një herë dhe Hasani dëgjoi fare qartë, si një gjëmim, zhurmën e thellë të rrotave të hekurit mbi shinat e hekurta. Pas saj, ajo u shua, veshi i plakut ndjeu zhurmën e qetë e shekullore të rrjedhjes së lumit dhe iu kujtua postjeri i kooperativës që bënte 400 ditë punë në vit duke shpërndarë gazetatat e duke i rënë cyles. Postjeri ecte që nga mëngjesi deri në darkë. Kalonte në të gjitha fshatrat e kooperativës dhe, që të mos mërzitej, i binte cyles.

... Atë ditë, sapo kishte hyrë shkurti, ai solli gazetën dhe iku pa qëndruar as edhe një minutë. Ishin në oborr. Sapo kishin mbyllur gjënë e gjallë në katua, kur erdhi gazeta. Zafira e mori dhe nisi ta lexojë, në fillim me zë të lartë që ta dëgjonte dhe i jati, bashkë me tëmën, pastaj dalngadalë e uli zërin. I jati vuri re se si sytë e së bijës u zmadhuan dhe filluan të feksin tamam si feksin yjet. Ajo e uli edhe më zërin dhe u zbe. I jati u-tremb.

- Ç'është - pyeti ai kureshtar.

- Asgjë, - pëshpëriti Zafira dhe u largua.

Ra nata, po këtë radhë jo si çdo natë. Zafira përsëri u largua dhe mori me vete bishtukun.

- Po kjo, ç'ka? - pyeti Hasani të shoqen.

Plaka mblodhi supet, kurse Zafira, e ulur në shkallën e fundit, pranë derës së gurit dhe, nën dritën e bishtukut, lexoi deri në fund gazetën.

Pas pak ajo ngriti kokën e trembur. E ëma, me një bishtuk në dorë, po zbriste shkallët. Bishtuku i ndriçonte vetëm fytyrën dhe shaminë e kokës. Të dyja, nënë e bijë, u ulën dhe qëndruan kokë më kokë. Zafira nisi përsëri të lexonte!

Dy bishtukët pranë këmbëve digjeshin ngadalë. Përballë tyre, në katua, lëvizte gjëja e gjallë.

Pas pak, dy gratë kthyen kryet të trembura dhe panë sipër tyre, mbi shkallë, bishtukun e tretë që kish ajo shtëpi. Atë e mbante me dorën të shtrirë përpara Hasan Qurku.

Plaku i shtëpisë qëndronte në shkallën e parë të çardhakut. Pak i përkulur përpara dhe gjysmë i ndriçuar nga bishtuku, ai dukej si një copë shkëmb që do të rrokullisej.

- Ngrihuni dhe bini të flini! - u foli ai grave.

Për çudi, në vend të plakës, u përgjegj Zafira.

- Mirë tate, tashti do të biem.

Plaka shikoi çupën në sy dhe s'e njohu. Syt'e saj ndriçonin çuditërisht si të kishin pasë marrë dritë nga gjithë ato fjalë që kishte lexuar nën dritën e dobët të bishtukut, pranë derës së katojt.

Të dyja dëgjuan në heshtje se si u zvarrisën këmbët e plakut gjer sa ai hyri në konak.

- Lexoje bijë, dhe dhëntë zoti e u bëftë ashtu si thonë këto fjalë, që të hyjnë në zemër.

- Do të bëhet kështu siç thotë ky fjalim, po jo me frymën e shenjtë, po me luftën që do të bëjmë ne vetë, me përkrahjen që do të na japë organizata.

- Ashtu qoftë!

- Ah, moj nënë, si ke duruar ti? - psherëtiu Zafira dhe ndjeu t'i përloten sytë.

E ëma nuk foli. Dhe Zafira heshti dhe ndjeu se s'ishte vetëm bijë e saj, po dhe shoqe e saj. Kjo ndjenjë e re i erdhi kaq e papritur dhe e emocionoi kaq shumë sa e shtërngoi fort t'ëmën pas vetes dhe qau.

- Jeta jonë s'do të jetë më siç ka qenë; unë këtë gjë tashti e ndjej në shpirt.

- Ashtu qoftë, veç ruaju, të pastë nëna. Ti je bija ime, po ti s'na përket më neve. Ti e di që je e...

Zafira ia zuri gojën s'ëmës me dorën e saj dhe u ngrit e ngjiti shkallët si flutur.

Të nesërmen, të pasnesërmen dhe gjer në ditën që ajo u nis për në hekurudhë, Hasan Qurku bënte çudi me të bijën dhe të shoqen. Në shtëpi nuk kishte qetësi. Gratë, që gjer dje kishin patur secila mendjen dhe huqet e veta, tashti ishin bërë një. Plaku nuk e duronte dot këtë unitet dhe shpesh xhindosej. Ai ndenji rehat dhe e ndjeu veten zot karshi gruas së tij vetëm sa kohë që e bija ndodhej në hekurudhë. Herë-herë ai ndjente një farë ankthi. Dhe këtë gjë e ndjente sa herë që kujtonte të bijën. - Kush e di se si do të kthehet ajo nga hekurudha, - thonte me vete i shqetësuar.

Dhe më në fund ajo ditë erdhi:

I tërë fshati qe lajmëruar të dalë përpara për të pritur dhjetë vullnetaret, dhjetë çupat e reja që kishin ikur para dy muajsh. Në qendrën e kooperativës kish nisur ahengu. Gratë kërcenin. Të gjitha ishin veshur me fundin e sëndukut. Nga rrobat e tyre vinte erë trendeline. Ato qeshnin dhe këndonin.

- Ç'është ky turp! - tha Hasan Qurku.

- S'është turp, po festë, - iu përgjigj e shoqja.

- Prit se do t'ia dëgjosh avazin kësaj feste, - tha ai dhe ngriti kokën.

- Po vijnë, po vijnë! - thirri dikush dhe të gjithë u sulën përpara si një lumë shumëgjyrash.

Të dhjetë vajzat, si të ishin dhjetë pranvera bashkë, erdhën të veshura me pantallona dhe mbushën me gëzim fshatin si dikur, kur vinin partizanët.

Plaku u mundua ta përmbante veten po s'mundi; më në fund ai e përqafoi të bijën. Atë natë ai desh të fliste me të, po në shtëpi kishin ardhur miq, punëtorët e NISH Elektrikut dhe plaku u muar me ta, kurse të nesërmen ai nuk guxoi të fjalosej me të. Dhe të pasnesërmen gjithashtu. Plaku u bind se në shtëpinë e tij kishte ardhur një tjetër Zafirë. Ai e shikonte dhe bënte çudi. Sytë e saj, shtatëmbëdhjetë vjet të fjetur e të mykur, ishin çelur si lulja buzë prillit. Edhe të ecurit ajo tashti e kish ndryshe, edhe të folurit ndryshe. Gjithçka kishte ndërruar tek ajo, sikur të kishte pasë ndenjtur në hekurudhë jo dy muaj, po dymbëdhjetë.

Shpirti i saj i ndrydhur dhe i mbyllur, kish shpërthyer sapo i kishin thënë shpërthe, tamam si ajo kumbulla buzë pranverës që shpërthen sapo shef një ditë me diell. Tashti edhe dashurinë e saj ajo e shikonte ndryshe.

Ai, çdo ditë i dilte përpara dhe pinte ujë nga shtamba e saj, dhe duke e mbajtur shtambën të dy, në dy vegjët, ecnin ngadalë dhe heshtnin. Dhe fshati i shikonte që nga dritaret e vogla të kullave dhe heshtëte. Dhe e ëma e Zafirës, që dinte gjithshka dhe që shikonte gjithshka, s'fliste. Ajo ndjente në shpirt frikë për këtë dashuri të heshtur.

Pas disa ditësh nga Sulova e largët erdhën në konakun e Hasanit dy miq: shkesi dhe daja i dhëndrit. Dhe në heshtje, në konak, ku ndriçonte bishtuku, u vendos që pas një jave të bëhej dasma, megjithëse pas një jave binte e premtë dhe jo e djel, dhe s'ish as vjeshtë e as dimër, po maj.

Kaluan tri ditët e para, tri ditë të gjata maji me punë dhe diell. E katërta ditë Hasanit iu duk e gjatë. Të pestën Hasani e thirri të bijën në konak dhe i tha:

- Nesër do të bëhesh nuse. Do të vijmë të të marrin.
- E di, - u përgjegj Zafira.
- Si?
- E di gjithë fshati.
- Si?

- Po, baba.

"Krau" kërciti një shuplakë në konak si një shkrepëtimë. Sytë e Zafirës u mbushën me lot dhe xixa.

Ajo nuk foli. Ktheu shpinën dhe, e qetë, zbriti shkallët, doli përjashta dhe humbi në fushë, midis grurit të gjelbërt.

Në darkë nuk u kthye. As të nesërmen, që ishte dita e dasmës së saj, dita kur do të vinin krushqit për ta marrë, nuk u kthye...

... "O zot, po çmendem", pat thirrur Hasani dhe, nga që s'rrinte dot më në konak vetëm për vetëm me bishtukun, kishte dalë në çardhak.

Dielli po perëndonte i kuq e i madh.

- Tashti duhet të vij në krushqit, tashti hapu dhe të futem, - kish menduar plaku dhe s'guxoi t'i hidhte sytë nga rruga. Rrinte si i ngrirë dhe vështronte vetëm diellin.

- Po vij në, - dëgjoi zërin e trembur të gruas dhe zuri kokën me duar.

Në oborr hynë kuajt duke hingëllirë sikur të kish ndodhur një vdekje e kobshme.

- O i zoti i konakut! - dëgjoi fare qartë Hasani, dhe zuri veshët me duar e u fut në dhomë.

- O i zoti i konakut, - iu bë sikur gjëmoi oxhaku. Pastaj dëgjoi fjalë në oborr. Zë burrash. Pas pak dëgjoi hapat e kuajve që ikën revan dhe më nuk dëgjoi asgjë.

Kur hyri e shoqja në konak, ai brofi në këmbë. Kurrë nuk e kish pritur ai me kaq ankth fjalën e saj.

- Ikën të zemëruar. Thanë se do të hakmerren.

- Kush foli me ta? - pyeti Hasani.

- Punëtorët e NISH Elektrikut. Ata thanë se s'do të kish ndodhur asgjë në qoftë se ne do të kishim telefonuar mbrëmë në qendrën e lokalitetit të Sulovës, mund të telefonomin që nga zyra e kryetarit të kooperativës dhe t'u thonim që të mos niseshin.

Gruaja fliste dhe i shpjegonte se ç'i kishin thënë punëtorët, se vajza do të kthehej prapë, po Hasani nuk i dëgjonte. Ai kishte zën kokën me duar dhe heshtëte pranë oxhakut.

* * *

- Fy, fy fyrrrr!

- Treni, - pëshpëriti Hasani, - gjithë natën këtë havaz ka.

- Fy fy fyrrrr! - futi përsëri oxhaku fishkëllimën e trenit, pastaj futi zhurmën e rrotave të hekurta mbi shinat e hekurta.

Hasani mbajti vesh dhe iu duk sikur pikërisht kjo ulurimë e largët që përtej lumit, ia kishte rrëmbyer vajzën dhe ia kishte turbulluar mendjen dhe shpirtin. Ngadalë ngriti kokën, të cilën e kish mbajtur qëkur të mbështetur mbi gjunjë dhe hodhi sytë përjashta. Dritarja e vogël e konakut, fuste dritën e bardhë të mëngjesit që kishte feksur. Pastaj pa bishtukun që u përpëlit. Flakëza e vogël u shkëput dhe u ngjit në çast. U përpëlit dhe një herë dhe u shua. Hasani zgjati dorën e tundi bishtukun dhe kuptoi se qe mbaruar vajguri.



BREDHI I BARDHË

Shoku im K. më tregon:

Ekziston ndonjëherë mendimi sikur puna jonë kryhet në një rreth të mbyllur, nga njerëz të veçantë, brenda disa caqeve të rrepta. Natyrisht, ky është një përfytyrim i gabuar, për më tepër i huaj se karakteri i detyrës sonë ndryshon krejt nga ajo e armiqve. Tanimë është bërë një praktikë e zakonshme që punët tona nuk mund t'i kryejmë pa ndihmën e njerëzve. Dhe këtu, s'është fjala për disa njerëz, po për qindra e mijra të tillë që ndërgegja qytetare i lidh e i bashkon or' e çast me ne. Është fjala për tërë popullin. Dhe populli është si ai kollosi i gjallë që nuk e duron të keqen në trup të tij, po shqetësohet dhe kundërvepron menjëherë. Zakonisht, e nisin vetë njerëzit dhe çështja kalon si stafetë dorë më dorë, derisa i arrihet qëllimit. Ne vetëm organizojmë dhe drejtojmë.

1

Ndodhi njëherë kështu:

Një mëngjes heret, punëtori Skënder L. po shkante si çdo ditë në punë. Ecte më këmbë, nëpër rrugën që vjen paralel me bregun e liqenit, me merakun që të arrinte në kohë. Po tek vështrohte nga liqeni, padashur i tërhoqi vemendjen një varkë që lëkundej lehtëzi mbi valët e mëngjesit. Varka ishte fare bosh, dhe sadoqë ai qëndroi në vend dhe shikoi me kujdes, nuk i zuri syri ndonjë njeri në të. Ndërkaq, era e veriut e shtynte varkën gjithnjë e më tutje në thellësi të liqenit. Thua, ta kishin harruar pa lidhur peshkatarët? Ai e dinte sa kujdesen peshkatarët për varkat e tyre. Të ishte shkëputur vetë? Edhe kjo s'ishte për t'u besuar: nata e kaluar kishte qenë e qetë, pa erë e dallgë. Atëhere, Skënderi pa humbur më kohë në arësyetime, vajti në breg, u çvesh me të shpejtë dhe u hodh në ujë. Ishte ditë dhjetori dhe ai burrë shëndet pakët mezi e çante ujët e ftohët. Duke notuar me një dorë, ai e shtyti varkën deri sa e afroi në breg. Pastaj, me shumë mundime e nxori nga ujët dhe e përmbysi sipër disa shkurreve, duke fshehur poshtë varkës edhe një lopatë që gjeti në të.

Erdhi drejt e në zyrën time. Ne nuk njiheshim dhe s'kishte si të njiheshim. Në zyrat tona hyjnë e dalin me dhjetra njerëz të panjohur në ditë. Ai foli shkurt, tregoi ç'i kish ndodhur, ç'kish bërë dhe paraqiti dyshimet e tij. Unë si zakonisht në këto raste, e dëgjova me vemendje, mbajta

shënime të hollësishme. Para se të largohej, ai tha se ishte gati të ndihmonte prapë në rast nevoje.

Kur qytetari Skënder L. mbylli derën, unë mblodha dokumentat dhe, pa humbur kohë, i raportova shefit tim.

- Po, - më tha shefi - tani sapo na njoftoi njësitë kufitar i postës R. Gjatë kontrollit të mëngjesit është gjetur në bregun e djathtë, një varkë hedhur mbi shkurre...

Pastaj ne heshtëm, duke qëndruar ballë njëri tjetrit. Shefi vështronte nga dritarja që binte nga ana e liqenit e herë pas here thithte cigaren. Për ne që punonim me të, kjo pamje e tij kish kuptim të qartë: çështja ishte shumë e rëndësishme dhe meritonte vemendje të madhe. Në këto raste, ai nuk dinte të mendonte gjatë. Shefi ynë vendoste në çast e në veprim e sipër, lindnin dhe mendimet...

- Mirë, - foli ai, si me vete. - Merr grupin operativ dhe shko në vend.

2

Varkën e gjetëm mbështetur mbi disa shkurre të dendura. E kundruam me kujdes e pastaj e kthyem mbarë. Para nesh ishte një varkë e rëndomtë, e ndërtuar rishtazi, e lyer me bojë të bardhë, me përjashtim të fundit të saj që ish në ngjyrë gri. E kontrolloam më pas me imtësi se mos gjenim ndonjë send apo ndonjë gjurmë, po s'doli gjë. E vetmja provë materiale, veç varkës, ishte lopata. S'ish lopatë e zakonshme për vozitje, po lopatë lëmi, nga ato që përdorin fshatarët kur shijnë grurë. Qe punuar trashë dhe në dy vende, ndonjë metër larg njëra tjetrës ishte e ngrenë e e gërvishur.

- "Si duket, me këtë lopatë - mendova atë çast dhe e mora atë në dorë - e kanë mbartur varkën deri këtu!

Shokët e grupit gjithë vemendjen e tyre e përqëndruan në disa gjurma që kishin mbetur në sheshin për gjatë bregut. Nëpër rërën e lagur, dukeshin qartë gjurma këmbësh e vende-vende shenja të varkës, të cilën, siç dukej, e kishin zvaritur. Kish shumë të ngjarë, nga sa tregonin gjurmat, që të panjohurit të qenë nxituar tepër në veprimet e tyre. Ne fotografuam gjurmat gjer në një shenjë vendi se më tej ato humbisnin nëpër gëmushat e shkurret në largësi të gjolit. Kështu që na u desh të thërrisnim në ndihmë Jankën, qenin e grupit. Janka i nuhati shpejt gjurmat dhe pasi kapërceu zonën e shkurreve, doli

në rrugën automobilistike. Këtu, ai u vërtit andej këndeje, sepse tereni ishte i fortë dhe gjurmat e të panjohurve ishin prishur nga lëvizjet e ditës. Me gjithë atë, qeni shkoi më tutje dhe, ne, duke vajtur pas tij u gjendëm në një qendër të banuar. Aty ishte ofiçina e ndërmarrjes gjeologjike, fjetorja e punëtorëve, magazinat dhe disa shtëpi banimi.

Janka u suall disa herë vërdallë, e pastaj, pa bërë asnjë dredhë hyri drejt e në një shtëpi që vinte pak si veç shoqeve. Unë e njihja mirë atë shtëpi dhe hetimet e qenit më ngjallën në çast një dyshim të vjetër...

U ktheva në zyrë me bindjen se kisha rënë në gjurmë, dhe me këtë mendim trokita në derën e shefit. I raportova gjatë e gjërë. Ai, si gjithnjë më dëgjoi pa më ndërprerë e pastaj tha i menduar:

- E vështirë ta pranosh atë që thua ti.. S'mjaftojnë vetëm arësytimet...

- Ju e dini se djali i madh i kësaj familje, Agroni, është thirrur disa herë nga ne për sjelljet e tia të këqia. Kohët e fundit është këshilluar rëndë për faktin se është kapur në zonën e kufirit.

Shefi më dëgjonte me vemendje dhe këtë gjë e kuptova akoma më mirë kur ra zilja e telefonit dhe ai nuk e ngriti fare dorezën.

- Ashtu është, si thua ti, - tha ai i qetë. - Po këto janë vetëm dyshime. Rëndësi ka, ç'thonë provat materiale...

Atë çast, ndjeva që në gjoks zemra më rrahu me vrull, e duke u munduar të mos e tregoj gëzimin tim të papritur, shpjegova:

- Gjatë kontrollit personal që bëmë në shtëpi, gjetëm në teshat e Agronit njolla boje të bardhë, krejtësisht të ngjashme me bojën e bardhë të barkut të varkës.

Eprori im më vështroi në sy, me një mënyrë të tillë, sa unë aty për aty e kuptova se isha nxituar.

- Me gjithë atë, - tha ai, - e kemi të vështirë akoma të konkludojmë. Bëni një herë analizën kimike të bojës. Studjoni sjelljet e Agronit, pa vënë dorë mbi të. Tërthorazi mbajeni në mbikqyrje.

Dola nga zyra e shefit i menduar e i pakënaqur nga puna ime. Çështja ishte më e ndërlikuar nga sa pandehja unë.

3

Analiza na tregoi se boja e bardhë e teshave të Agronit kishte përbërje të ndryshme nga ajo e varkës. Veç kësaj, duke vazhduar hetimet në vend, doli se Agroni bojën e bardhë e kish marrë në magazinën e ndërmarrjes ku punonte dhe me të kish lyer një dollap të shtëpisë. Këto fakte të papritura, nuk di sepse më tingëlluan si një tallje për besimin naiv që kisha patur se vetëm me nuhatjen e Jankës mund të ishte zgjidhur enigma.

Kështu çështja hyri prapë në errësirë. Shokët e punës më kritikuan në mbledhje për veprime të nxituara e të pasakta. Pas kësaj, pata një bisedë të gjatë me shefin. Tani çdo gjë duhej filluar nga e para. Të dhënat nga jashtë mungonin krejtësisht. Kishim në dispozicion vetëm një varkë e një lopatë lëmi! Nga t'ia fillonim? Grupi operativ priste udhëzimet e mia. Më në fund vendosëm të kthehemi prapë tek vendi i ngjarjes. Vajtëm dhe e kontrolluam vendin pëllëmbë për pëllëmbë në një periferi më të gjërë. Kësaj here, gjetëm një lopatë të fshehur në mes të busheve. Edhe kjo, nuk ish lopatë varke, po lopatë furre. Për një çast na xixëlloi një shkëndi shprese, kur diktua në dorezën e saj diçka të shënuar me laps plumbi, po këtë nuk arritëm ta shquanim pasi lagështira e kishte prishur. Lopata në vendin ku u gjet, rrëfente tërthorazi se tentatorët e kishin marrë me vehte deri në një farë vendi dhe pastaj, për të mos rënë në sy, e kishin fshehur. Por vetëm kaq. Cilët ishin këta dhe ç'kishin ndër mend të bënin, mbetej gjithnjë një pyetje që kërkonte përgjigje të saktë.

Përsëri kishim përpara varkën po tani, jo me një, po me dy lopata. Sa mund të na flisnin këto me gjuhën e tyre të heshtur, kjo ishte pyetja që ngrihesh para nesh. Në mungesë të burimeve të tjera, ne duhej t'i bënim ato të tregonin, të flisnin. Po para se t'ia arrinim kësaj, shkëmbyem mendime me disa peshkatarë, duke shpresuar se ndonjë fjalë e tyre do të na ndihmonte, por në të vërtetë, ata pohuan po ato gjëra të njohura. Thanë se varka sapo është ndërtuar dhe se një varkë të tillë nuk ua kish zënë syri.

Pasi u mendova gjatë i bëra vetes këtë pyetje: Ç'dija unë për ndërtimin e varkave? Asgjë. Atëherë u ngrita dhe shkova tek ata që ndërtojnë varka; pashë, pyeta, dëgjova dhe që atje më lindi ideja e zberthimit të varkës.

Shokët e mi të punës e pëlqyen mendimin tim. E zbërthyem copë-copë, duke ndarë mënjanë dërrasat nga pjesët e tjera. Tek bënim këtë, vura re se në mes të dërrasave nuk ishin vënë fiqe liri, siç vepronin ndërtuesit e varkave që pashë në mëngjes, po copa të gjata leckash. Në fillim na u duk sikur nuk gjetëm asnjë gjurmë, po kur pamë që mbetëm pa gjë, atëhere e drejtuam vemendjen tek lecat. Ç'ishin këto lecka? A mund t'i ndihmonin qëllimit tonë? Puna e parë që bëmë, i mblodhëm tok, i lamë e i pastruam dhe u munduam të shohim në se kanë ndonjë lidhje në mes tyre. Për çudinë tonë, kur i bashkuam njëra me tjetrën, u sajua papritur një këmishë gruaje. Këmisha, në pjesën e përparme ishte qëndisur me motive popullore që neve aty për aty na ngjanin të njohura. Po prapë, na u duk shpejt për t'u gëzuar. Leckat i qepëm njëra me tjetrën dhe me këmishë në dorë hyra në zyrën e shefit.

Ai hapi sytë pak i habitur.

- Ç'është kjo këmishë?

- E gjetëm në mes të dërrasave të varkës - i shpjegova, duke vështruar ngultas këmishën.

- Gjynah që e paskan prishur këtë këmishë të bukur! - tha shefi me një ton që unë s'e kuptova aty për aty, sepse për mua, bukuria qëndronte gjetkë. Gjetkë qëndronte edhe për shefin tim. Po ai e tha këtë fjalë dhe pastaj pyeti, duke parë nga dritarja:

- Ç'mendon të bësh?

Unë e kisha menduar mirë përgjigjen:

- Them të gjejmë se në ç'zonë të krahinës sonë veshin këmisha me këto lloj qëndizmash. Kjo do të na ndihmojë për lokalizimin e hetimeve...

Shefi më dëgjonte me vemendje.

- Mirë e keni menduar si fillim, - tha në fund ai; - po ti e di, se ky aksion s'ka si kryhet me sukses, po që se s'kërkoni ndihmën e njerëzve. Vetëm ju, s'e bëni dot. Shkoni, takohuni me ta...

4

Të nesërmen vajta në një fshat buzë liqenit, duke menduar, nga sa e njihja unë etnografinë e krahinës, se këmisha

me qëndizma të tilla mbajnë vetëm asaj ane. Dhe këtë gjë, më mirë se gratë s'kishte kush të ma sqaronte. Hyra në një bisedë me disa gra dhe pastaj u tregova këmishën.

- S'është nga anët tona - thanë ato në një zë. - Ne nuk qëndisim nga këto lule.

- Këto qëndizma, mor bir - shtoi një plakë - i bëjnë në fshatrat matanë kufirit...

Mua m'u duk sikur ma muarën këmishën nga duart e ma hodhën në tokë, si një plaçkë pa vlerë, m'u duk sikur u kthyem prapë atje ku ishim. Po besimin nuk e kishim humbur. Pa këtë besim nuk bën dot në detyrën tonë. Duhet të dilnim me doemos nga ai rreth, ku kishim hyrë. Puna jonë i shëmbëllen asaj që thonte një natyralist i famshëm: më jepni një kockë, të ju jap skeletin. Kështu dhe ne, kishim përpara varkën bashkë me dy lopatat dhe me to duhej të punonim.

- Nuk jemi fare pa mbështetje - na tha shefi në një mbledhje - Varka nuk ka rënë nga hëna!

Vërtet, nuk kishte rënë nga hëna, ish ndërtuar në tokë, në rrethin tonë, ndofta, në qytetin tonë. Ky ishte mendimi që më shqetësoi për disa ditë me radhë. Mora dërrasat e varkës dhe i pastrova nga boja e lëndët e huaja. Dërrasat m'u dukën se ishin bërë nga një lloj druri, po se nga çfarë druri, këtë e kisha zor ta përcaktoja. Zor e patën edhe shokët e mi ta thonin. Këtë mund ta përcaktonin sharraxhinjtë e Pyllit të Plisës.

- Këto?! - tha një nga punëtorët, i habitur që nuk e dija - Bredh, është, more shok, bredh i bardhë...

Unë tunda kokën, duke mos ia vënë veshin habitës së tij.

- Bredhi i bardhë nuk rritet në pyllin tonë, - tha përgjegjësi, - rritet në vende të larta malore.

- Ke shkuar ndonjëherë në fshatrat e M.? - pyeti një druvar plak. - Atje do ta gjesh bredhin e bardhë. Në tjetër vend s'e gjen!

Mua atë çast m'u ngroh zemra.

- Tani, po, - tha shefi, kur i raportova për bisedën që bëra me sharraxhinjtë, - mund të them se e kemi futur çështjen në rrugë...

Dhe që atë natë u nisa për në fshatrat e zonës së bredhit të bardhë. Kisha në dorë një çelës që do më ndihmonte. Harrova të them se sharraxhinjtë më thanë gjithashtu se dërrasat qenë prerë me sharrë dore dhe se nga forma, nuk i përmbaheshin standardit shtetëror. Kjo më bëri të mendoj se kish shumë të ngjarë që druri i dërrasave të varkës të ishte prerë në pyll me leje. Prandaj, puna e parë që bëra, shtiva në dorë listën e emrave të atyre që kishin marrë leje për të prerë dru në pyllin e bredhit të bardhë. Lista ishte e gjatë, po unë s'hoqa zor t'i identifikoja njerëzit. Për këtë, më erdhën në ndihmë shokët e fshatit, të cilët më dhanë të gjitha sqarimet. Kur arrita tek numuri tridhjetë e pesë i listës dhe dëgjova mendimet e shokëve për një bashkëfshatarin e tyre, thashë të qëndroja aty. Ky ishte kulaku Sadik V. Po kur vazhduam më poshtë, më tërhoqi vemendjen edhe emri i Todi K., i cili kish disa vjet që kishte dalë nga burgu i akuzuar si agjent i të huajve. Duke biseduar me fshatarët mora vesh se Todi nuk kish hyrë në kooperativë dhe se jetonte vetëm me punën e së shoqes. Ai vetë rrinte në shtëpi, duke u marrë me punë të vogla; nuk shoqërohej me askënd. Fshati e njihte si njeri dinak e tinzar. Bile ai kishte hapur fjalë se do të shpërngulej që aty dhe do të zinte punë në qytet. Thonte se e kishin inat në fshat dhe nuk ia donin të mirën.

Të gjitha këto flisnin në favor të dyshimeve të mia, po në të vërtetë, nuk kisha asnjë argument konkret lidhur me çështjen për të cilën kisha ardhur. Puna duhej hetuar më afër. Mendova njëherë se mos i gjenim ndonjë dërrasë në shtëpi, shoqe të atyre, me të cilat ai mund të kish ndërtuar varkën, po një gjë e tillë ishte gati e pamundur, sepse Todi qëndronte gjithë kohën i mbyllur brenda në shtëpi. Ne dinim me siguri se ai kish prerë dërrasa në pyllin e bredhit të bardhë. Këtë e tregonte qartë leja që kishte marrë zyrtarisht. Nga hetimet që bëra doli se ai e kishte marrë lejen për të meremetuar shtëpinë, po këtë punë nuk e kishte filluar, pasi nuk i kishin ardhur akoma ustallarët.

5

E lashë njëherë mënjanë çështjen e dërrasave dhe u mora me lopatat. Ku mund të ishin punuar ato? Fshatarët më thanë se lopata të tilla i bënte vetëm një mjeshtër plak nga fshati P. Mora lopatat dhe vajta në mbrëmje te plaku. Ia tregova dhe ai, sapo i pa, e njohu njerën prej tyre.

- Këtë e kam bërë me dorën time - tha plaku. - Vetëm tri lopata furre kam punuar kështu. Kjo është lopata e

Sadik V. E sheh shenjën që është prishur? Ka qenë emri i tij. Sadiku është familje e madhe dhe përdor furrë në shtëpi.

Mjeshtri plak e kuptoi se diçka e rëndësishme luante në këtë mes dhe priste fjalën time.

- A nuk çon djalin njëherë t'ia kërkojë lopatën Sadikut?
- i thashë.

- Posi, që tashti.

Kur u kthye djali nga shtëpia e Sadikut, tha:

- Lopatën xha Sadiku nuk e kish në shtëpi. Ia kish marrë hua Todi K. dhe s'ia kish kthyer.

Rrethi tani sapo vinte e po ngushtohej. Djali i mjeshtrit shkoi pastaj në shtëpinë e Todi K. dhe i kërkoj lopatën e xha Sadikut. Todi i kish thënë i nervozuar:

- Ikë, more djalë se e ke gabim! Ç'më duhet mua lopata e furrës!

Unë u bëra i shtëpisë në fshat. Njerëzit e thjeshtë kanë nuhatje të çuditshme. Ata vinin e më jepnin të dhëna të ndryshme. Një fshatar, erdhi e më tha se në gardhin që rrethonte shtëpinë e Todit kishte parë gjurmë boje të bardhë. Dhe me të vërtetë, unë i pashë vetë me sytë e mi njollat e bardha të bojës. Një tjetër, më tregoi me hollësi se para disa ditësh i kish zënë syri, duke u kthyer për në shtëpi, Todin të lagur në gjysmën e trupit, sadoqë atë ditë nuk kishte rënë shi. Interesant se si syrit të popullit nuk i shpëton asgjë; ai i mban në mbikqyrje të vazhdueshme të gjithë ata që kanë shpërdoruar njëherë ose duan të shpërdorjnë besimin e tij.

Tani çdo gjë u bë e qartë. Shkuam në shtëpinë e Todit K. dhe trokitëm në portë. Trokitëm disa herë, po të zotët e shtëpisë për një kohë nuk u ndjenë të gjallë. Vetëm kur trokitëm fort e thirrëm, atëhere doli e shoqja.

- Todin doni? - pyeti ajo duke u munduar të na vononte.

- Todin duam, po hapu - i tha njeri nga fshatarët dhe desh të futet brenda, po gruaja dinake i doli përpara.

- Ai po hidhet nga muri, prapa shtëpisë...

- Mos u mërzit se ka kush e pret dhe andej - tha Ganiu, një nga shokët tanë, dhe hyri në koridor. Gruaja u mundua prapë të luajë rolin e saj, po më kot. Todin e kapëm në dhomën e vogël, tek po digjte dokumentat e fundit. Dhe bashkë me këtë kapëm edhe agjentin e huaj, i cili me ndihmën e Tudit - po përgatitej të kthehej në strofken e vet matanë kufirit.

6

Kur i raportova shefit, ai u ngrit në këmbë dhe më rroku në qafë. Ne qëndronim përballë njeri tjetrit me sytë që na ndrisnin nga një gëzim i përmbajtur.

- Ju lumtë! - tha ai dhe si heshti një hop, shtoi:
- Ju lumtë të gjithëve, i lumtë atij punëtorit, u lumtë sharraxhinjëve, grave, fshatarëve dhe, tok me ta edhe ty që e udhëhoqe këtë aksion të vështirë.

Kjo është detyra jonë, që duket sikur kryhet nga një rreth i mbyllur njerëzish, po që në të vërtetë është vepër e të gjithëve, e vetë popullit.



DORASHKAT

Në bulevard binte borë. Veriu frynte duke mbushur rrugën me fërshëllima që treteshin diku nëpër lagje, ndesheshin me shtyllat e neonit dhe njerëzit. Drita e neonit përzihej me bardhësinë e dëborës dhe me fërflizën që formonte re dëbore. Në mes kësaj bardhësie, në të dalë të qytetit, vazhdonin rrugën duke ndihmuar njeri tjetrin një burrë dhe një grua.

- Më duket arritëm, Besnik! - foli gruaja me zë të lartë dhe shikoi nga i shoqi, që ish zbardhur prej dëborës në vetulla e në kokore. Ai ktheu sytë, i buzëqeshi dhe vazhdoi rrugën. Ajo i shtrëngoi krahun.

- Ky drejtë veri s'po m'len me pa larg. Po qe ku a parki, - foli ai me nëndialektin e vet.

Gruaja tundi kokën, e shikoi dhe qeshi. Ata s'folën më, veç hynë në kabinën e portierit të parkut automobilistik, një plakush babaxhan që rrinte pranë stufës dhe lexonte "Zërin e Popullit". Sa hynë njerëzit, plaku luajti nga karriga dhe u liroi vend të ngroheshin, në vend që t'i pyeste menjëherë si bënte shpesh.

- Eni bre njerëz të per... Ç'u solli tash në mbramje vonë?!

- Nji hall, babë! Nesër pa tjetër do të nisemi për në zonën e tërmetit. A thue ka ndonji makinë?

- A veç ju jeni? Për kaq gja mos u shqetësoni. - Ai zgjati kokën te dritarja dhe i thirri me sa zë kish një djaloshi veshur me peliçe.

- Kush niset nesër për te tërmeti... te tërmeti!?

Djaloshi çau mes fërflizës dhe zëri i tij erdhi si jehonë deri tek plaku, duke e mposhtur atë kor fërshëllimash të veriut:

- Kollona e Bardhok Komuniiistit...

Plaku u zbraps nga dritarja, fytyra i qeshi nga kënaqësia.

- Ju thashë! Nesër do t'u niska Bardhok Komunisti. Ka

dy ditë që po bahet gadi. Shkoni, takohuni me të në klubin e shoferëve.

- Si i thonë? - pyeti Besniku kureshtar.

- Bardhok Komunisti. Po s'i pat premtue kujt, ju merr patjetër.

- Luigjinë, rri këtu, - i tha Besniku së shoqes dhe doli nga kabina.

Në klub nja tre veta me mushama e kasketa rrinin pranë dritares, bisedonin e qeshnin me romuzet e njeri tjetrit.

- Më falni, a asht këtu Bardhok...

- Cili Bardhok? - pyeti njeri, një djalosh simpatik duke ngritur kasketën dhe duke shikuarnë sy Besnikun.

Besniku u skuq dhe po mendohej si t'i përgjigjej; se ish i sigurtë që Bardhoku do të kish mbiemër tjetër, kurse ai për fat s'e dinte. Ndoshta shoferët do të qeshnin me të, se ata bëjnë shaka me këdo. Po s'kish ç'bënte, puna nuk priste:

- Bardhok Komunisti, bre burrë!

Të tre shoferët ia krisën gazit. Dy të tjerët, që ishin "rini", u binin shpatullave atij babaxhani që e kish pyetur Besnikun.

- Unë jam, bre shok. Çfarë halli ke?

- Nesër duhet të jem tej Qafës tok me gruen. Mora vesh se po shkoni. A po na mirrni në maqinën tuej?

- Nesër shkojnë shtatëmbëdhjetë maqina. - Në orën katër të mëngjesit, te portieri. Maqina ime do të të marrë ty e familjen tënde.

Besniku u përshëndet dhe dolli.

Të nesërmen maqina e Bardhokut kaloi me ulurimë mes përmes qytetit, ngarkuar me lëndë ndërtimi për zonën e tërmetit. Në kabinë ishin katër vetë: Bardhoku, Besniku me të shoqen dhe një mësuese e re që vinte nga Jugu. Ata heshtnin, kurse motori buçiste, dhe nën këtë buçimë nuk dëgjohej zëri i sufërinës malore. Maqina hyri në një grykë. Bardhoku shikonte përpara. Edhe Luigjina, e shoqja e Besnikut,

shikonte përpara. Mësuesja nga Jugu kish ulur sytë dhe mendohej. "Në kabinë s'bën ftohët", mendonte edhe shoferi.

Përpara i doli një e përpjetë me kthesa. Ai e përqëndroi gjithë vemendjen tek marshet dhe tek timoni. Mendohej ta merrte me mend se ku e kish grumbulluar më shumë era dëborën. "Jam në krye të kollonës... Kushedi sa fëmijë pa strehë do të gëzohen kur të shikojnë këto pllaka eterniti... Kollona është prapa, unë duhet ta kaloj patjetër këtë drejt malore". Kështu mendonte ai duke shtrënguar timonin dhe duke ndjerë me vemendje çdo zhurmë të motorit.

- A ju qëllon të udhëtoni shpesh në dëborë, shoku shofer?
- pyeti mësuesja.

Bardhoku ngriti kasketën dhe shtërngoi timonin duke i dhënë gaz motorit. Kish mbaruar ngjitja.

- Shoqja mësuese, kam dhjetë vjet që udhëtoj në dëborë. Po mos u tremb! Nuk rrëshqet maqina ime... Nga je, shoqja mësuese? - Bardhoku fliste qartë dhe ngandonjëherë ngatërronte dialektet.

- Nga Vlora.

- Nga Vlora?

Luigjina ktheu kokën dhe e shikoi me vemendje. Mësuesja ish trup pakët, e shëndetshme. Dy sy të zgjuar e të zez shikonin gjakftohët. Palltua e saj ishte e re.

- Jeni vullnetare? - pyeti Bardhoku që, si duket, i pëlqente biseda.

Mësuesja buzëqeshi dhe pohoi me kokë. Kurse Luigjina, kthyer nga ajo, vazhdonte ta kundrojë, dhe sytë e tyre depërtonin tek njera tjetra. Ato ndjeheshin si dy shoqe të vjetra.

- Për sa kohë? - pyeti Bardhoku duke shikuar gjithnjë përpara.

- Ne dolëm për një deri në tre vjet. Por po qe nevoja, edhe më tepër... - foli mësuesja e re me krenari. Asaj i dukej se fliste në emër të atyre qindra vullnetareve që kishin dalë verën e kaluar nga qytetet e Jugut për në shkollat e malësive të Veriut. Këtë e dinte Luigjina, se i kishte

edhe ajo dy në fshatin e saj tej Qafës. E dinte edhe Besniku që ishte propagandist me rininë e kooperativës e i lidhte të gjitha detyrat me inisiativat e reja. E dinte edhe Bardhoku që i kishte sjellë me maqinën e tij, në fillim të shtatorit, ato me bagazhet e tyre të thjeshta.

- Kurse unë përgjithmonë - i tha Luigjina.

- Pse? - pyeti mësuesja.

- Jam martuar tej Qafës. Atje jetoj tok me burrin, në kooperativën malore...

- Nga jeni? e pyeti Bardhoku.

- Nga Tirana.

- Nga Tirana në malësinë tej Qafës?! - u çudit mësuesja e re.

- Posi. Ja im shoq.

Mësuesja e re shikoi Besnikun, kurse ky i hodhi një shikim të ftohët.

Shikimi i mësueses së re dukej sikur thonte: "Ky do të jetë trim i madh..." Sipas saj trimat vlerësohen nga fjalët e paka dhe nga shikimi i tyre i veçantë.

- Ç'punon? - pyeti Bardhoku duke kthyer kokën pak nga Besniku e duke mos ia hequr sytë rrugës së mbushur me dëborë që zbriste në një luginë.

- Në kooperativë. Baj çdo punë. Edhe në dimën kemi boll punë...

Bardhoku siguroi marshet dhe u kthye për një çast e e shikoi në ninëz të syrit, sikur desh ta kuptojë më mirë. Pastaj i foli Luigjinës:

- Bash mirë ia ke ba, motër! Edhe unë malsor jam. Këndej. Po u martova në qytet dhe mbeta aty. Një vëlla e kam tornitor, kurse gruan tezgjahiste në kombinat. Më tërhoqi ajo, por ndonji ditë tash po e hedh mbi karroceri tok me carrokët... - Ai qeshi. - Forca "shpirte"!! - i thirri maqinës duke hapur derën dhe duke e mbyllur me forcë. Parafytyrimi i vocrrakëve të vet iu lidh me fëmijët e zonës së tërmetit. Ndërroi marshet se po ecte drejt luginës, ku rruga ishte çarë nga traktori.

- Pse të thonë Bardhok "Komunisti"? - e pyeti Besniku.

Mësuesja dhe Luigjina kthyen sytë. Ndodh shpesh që njerëzit rrinë për një kohë tok, mendojnë secili më vehte për të njëjtin problem, por s'e hapin dot bisedën për atë që i shqetëson. Bardhoku hapi kapakun e sirtarit të sendeve dhe nxori dorashkat e tia të leshta.

- Mësuese, merri e mbaji pak se po mërdhet;... kurse unë i përdor veç kur ndalem...

Mësuesja u skuq.

- ... E që pyete ti, vëlla... si ta thonë emrin, Besnik?.. E gëzofsh! Komuniste unë kam veç zemrës dhe emrin. Zaten s'e pat keq ai që ma vuri këtë emër. Atje në zonën e tërmetit, or ti bablok, unë shoh vullnetarë nga gjithë Shqipëria. Të tërë durojnë tufanin dhe ndërtojnë shtëpi të reja për të pastrehët e mbetur trokë. Q'atje, unë them, se gjithë ai popull është komunist. Mandej të shifje rininë në Pecaj të Shkurtes, të linte mendja! Çuditej malësori kur shihte si këndonin cucat e Jugut duke punuar e duke mundur të ftohtit e asaj ane!...: Unë shkoj gjithkund me këtë "nusen" time. E çfarë s'shohin sytë tanë nëpër atdhe, or vëlla! Duhet të rrimë një natë të tërë të kallëzoj e s'mbaroj kurrë...

Bardhoku fliste për veten e për maqinën sikur ajo të ishte e gjallë, shoqja e tij besnike. Si kuptohej, ai e donte maqinën, ashtu si duan prindët fëmijët e tyre ose diçka tjetër, me të cilën lidhemi shpirtërisht.

- Pra, dimrin e kaluar kish rënë borë e madhe. Unë po kthehesha prej Veriut ku kisha çuar miell. Po kthehesha në qytet i lodhur, i këputur. Ishte pasdreke vonë. Kjo "shpirtja" ecte si era dhe as ankohej fare. Erë nuk frynte fort, por ishte të ftohët kjamet. Duke iu ulur asaj grykës që ju thashë, shoh në mes të rrugës një njeri të shtrirë, një strajcë e, pak më tutje, një shkop. E ndal maqinën. Ulem. Një plak! E marr me mundim e e fus në kabinë. Ish i ngrohët e i shkrifët. Sakaq nis e i bëj masazhe të shpejta. Kish ngrirë plakushi i ngratë prej të ftohtit e mezi i ndihej zemra. Ndeza motorin mirë dhe mendova ta çoj në spital. Shikova orën. Duhej edhe mjaft kohë të arrija në qytet, kurse plaku po më mbaronte. Vazhdova ta fërkoj në zemër e në damarë të qafës. Kur m'i çeli sytë plakushi!! I ndrinin sytë babushit. S'e keni idenë sa u gëzova! Sikur të më ishte ngjallur plaku im! Fillova të qesh e të kënaqem me të nga gëzimi që ndjeja. Pastaj ai nisi edhe të flasë e erdhi mirë

në vete. Kalova kështu mjaft kohë me të e gruaja më priste atë natë se i kisha thënë që do të kthehesha. Pastaj u nisëm. Plaku e kishte shtëpinë pranë kodrës matanë. E lashë maqinën ndezur në rrugë dhe e përcolla bablokun deri në shtëpi. E çfarë s'bëri që të më mbante për darkë. Unë s'ndenja. Dësh të më ipte lekë. Më zemëroi e u grinda me të sa desh ika pa u takuar fare, ndonëse më kish rrethuar gjithë familja e farefisi i tij. Nxori e më dha do fiq të thatë. I pranova me qejf e nisa të ha më këmbë. Atij iu bë qejfi aq shumë sa s'dinte si të ma mbushte mendjen që t'i qëndroja në shtëpi. Dikur ika. Pas nja dhjetë ditësh kthehem në park. Rregulloj maqinën dhe shkoj në klub. Aty ishin jo më pak se nja tridhjetë a dyzet shokë të mi. Sa më panë, ia krisën gazit. Unë s'kuptova gjë. Në mes atij gazi më dhanë dorashkat e leshta që i pata harruar në shtëpinë e bablokut e më kallëzuan se paskësh ardhur plaku të më kërkojë. Mirëpo ne jemi dy Bardhokë në park. E, a do ti? I paskësh dalë shoku im. Plaku ish zemëruar e paskësh thënë:

- Jo, or ti! Due at tjetrin, komunistin! Bardhok komunistin!..

- S'kemi Bardhok komunisti... - ishin përgjegjur njerëzishëm shokët e mi.

- Llagapin s'ia di, or ti. Por q'aj komunist â, q'at due unë...

Plakut i kish mbetur peng që s'më kish gjetur e kish shkuar tek drejtori. Shokët më detyruan t'i shkoja në shtëpi plakut mirënjohës e zemërbardhë. Tani shpesh më vjen edhe në shtëpinë time. Po nuk rrin. Ikën sa më takon. Kurse emri më mbeti. E të gjithë më thërrasin Bardhok "Komunisti". Të them të drejtën, mua më pëlqen kjo, se më dallon në krejt parkun me gisht, por nganjëherë më bën të skuqem, se s'jam gjithnjë i pari i kollonës si sot. Tani ia kam nisur edhe unë me këtë "nusen" time të jem përherë në të parët kur ka vështirësi. S'do të vdes pa u bërë komunist përnjëmend...

Heshtja u ndeh në kabinë. Si duke Bardhoku kish rrëfyer gjithshka. Besniku me të shoqen dhe mësuesja nga Vlora mendonin për shoferin. Shoferi dukej sikur nuk mendonte asgjë veç dëborës së rrugës. Por nuk qe kështu. Ai e theu heshtjen i pari:

- Shoqja mësuese, mos u mërzit. Edhe pak je në shkollë. Po ju krajla, si u martuat? Pa na kallëzoni njëherë, se

s'kemi si e kalojmë kohën. Hajt, pra. Kush po ia nis? Ti bablok apo "emancipimi"? - e hodhi fjalën ai tek Luigjina që shikonte të shoqin me vemendje.

- "Emancipimi", "emancipimi" - foli Besniku duke qeshur dhe iu drejtua së shoqes. - Tregoje, pse jo!

Luigjina tregoi si e pat njohur Besnikun në zborin ushtarak. Dhe ishin martuar të dy në fshat.

"Ja një grua e bukur, me sy të pastër", mendoi shoferi. - Dashuria e vërtetë nuk pyet shumë për qytet e fshat. Duket.. Kjo është e gëzuar.

Në kabinë bënte ngrohët. Edhe mësuesja e re vullnetare nga Vlora mendonte për këtë çift të ri. Tani nuk mendonte më për shoferin që njerëzit e thërrisnin "Bardhok Komunisti". "Këta edhe në Mars t'i çosh, përsëri do të dashurohen, do të ngrejne diku një kooperativë malore dhe do të jenë përsëri të gëzuar e do të flasin me krenari për dashurinë e tyre".

"Kjo është dashuri e re, më parë s'ka ndodhur kështu", vijonte të mendojë Bardhoku, ndërsa shikonte me vemendje kthesat e vogla të rrugës së bardhë që fshihej pas kodrës me pisha të rënduara nga dëbora. Fillin ia preu mësuesja:


- Ja fshati im! Unë po zbres, - tha ajo. La dorashkat e Bardhokut mbi motor, mori valixhen e vogël, u përshëndet dhe zbriti. I dha dorën shoferit dhe u nis për në fshat e pas pak humbi në mes pishave mbi rrugë.

Kur maqina u nis, mësuesja e re nga Jugu u duk edhe një herë majë kodrës së zbardhur nga dëbora. Përshëndeste me dorë. Bardhoku i ra borisë në shenjë përshëndetjeje, kurse Besniku e shikonte me miratim nga dritarja e kabinës.

Maqina dolli në Qafë dhe natyra u duk tej e tej me tërë madhështinë e saj pa fund. Aty zbritën burri dhe gruaja. U përshëndetën si miq me shofer Bardhokun dhe filluan të çanin dëborën duke u mbajtur me njeri tjetrin. Bardhoku i vështronte nga kabina. "Ja dashuria e vërtetë, po ngjitet në kooperativën malore" mendoi ai, dhe qeshi me mendimin e tij, se iu duk shumë i goditur. Pastaj ai ndjeu një farë keqardhjeje kur pa kabinën bosh dhe dorashkat që lëviznin mbi mbulesën e motorit.

"Pse dreqin s'ia dhashë mësueses së re dorashkat... Ajo s'kish dhe bën të ftohët" - mendoi ai.

- Pa hajt, "nuse, hajt shpirte, në zonën e tërmetit, se i kemi njerëzit jashtë! - foli ai me zë të lartë, sikur po i fliste diçkaje të gjallë, dhe i dha maqinës gaz sa gjëmoi në mes të rrugës së bardhë që zbriste poshtë Qafës me tërë ato kthesa gjarpërushe. Të ftohtit e dhjetorit të vitit 1967 përplasej mbi xhamat e kabinës dhe zbrapsej me gjithë ulërimën e tij që mbytej e mundej nga ulërima e maqinës së Bardhok "komunistit".



Capital at the portico of the St. Mary Monastery in Apollonia (XIV century). Photo by R. Vesel



Bas-relief in the St. Nicolas Church in the village of Mesopotari in the district of Saranda.



A typical house in the Palorto city quarter of Gjirokastra.



A typical house in Gjirokastra.

ERA E QERSHORIT...

Ajo ecte me hap të lehtë dhe vështronte përpara, vetëm përpara. Shikimin e mbante të ngulur në një pikë të vetme, tutje në mes të ullishtës.

Dielli, që depërtonte në mes të degëve të pemëve, ndriçonte trungjet e rrëzuara, gjethet, barin e shkelur. Ishte muaji qershor atëhere dhe, në një muaj të tillë, ndër ato anë gjithçka qesh, gjithçka të bën për vete dhe të frymëzon.

Por ajo ecte, ashtu lehtë-lehtë dhe vështrimin e mbante gjithmonë të ngulur tutje, në mes të ullishtës. Qëllonte shpesh, që ajo pengohej, apo binte pa kuptuar në ndonjë gropë të hapur nga predhat dhe gërshetat i binin përpara. Atëhere asaj i dukej sikur edhe ato i pengonin frymëmarrjen; ndaj, ashtu, instinktivisht, i hidhte pas shpinës. Trupin e kish të drejtë e të gjatë si një fidan i njomë i rritur në shpatin e një mali. Por fytyra e saj kish një pamje të ngrirë. Që poshtë syve të zez i qenë formuar ca rrathë mavi. Kur zemra ruan brenda saj një gjë të llahtarshme, ajo sikur e pasqyron atë edhe në fytyrë.

Galat uleshin diku. Pastaj sapo e ndjenin që ajo afrohej përplasnin krahët e tyre të zez, krroknin dhe fluturonin një copë herë për t'u ulur sërish.

"Ja një i vrarë, kush do të jetë ky?" - mendoi ajo.

Nga veshja, ajo e kuptonte që ish nga ato anë, ndofta nga fshati i saj, ndofta nga ndonjë fshat tjetër. Sidoqoftë, ai dukej që ish shqiptar, sepse pranë tij ndodhej festja e skuqur nga gjaku.

U ul, e preku të vrarin me dorë si të donte të sigurohej që nuk jetonte më. Ia kryqëzoi duart sipas zakonit dhe festen ia vendosi nën kokë. Pastaj, si afroi ca degë dhe e mbuloi të vrarin, vazhdoi rrugën, gjithmonë dalëngadalë, sikur të kujdesej se mos u prishte gjumin të rënëve.

Sherishtë quhej ai vend. Që andej mund ta shikoje Vlorën si në pëllëmbë të dorës. Aty ishte mbledhur çeta, aty trimat kishin bërë luftën me të huajt, aty kishin treguar ata burrërinë e tyre dhe aty kishin spërkatur me gjak atë lëndinë të bukur e të pashkelur më parë.

Dhe kishin rënë ata që të gjithë. Po të kishin dashur mund të ishin tërhequr. Ndër ato anë ka gryka e shpella ku mund të fshihet dhe një ushtri e tërë e jo një çetë e vogël me disa trima. Por ata nuk u tërhoqën. Ata i dollën armikut përpara, të gjithë i treguan pushtuesit të huaj gjokset e tyre të mbushura me urrejtje dhe të gjithë mbetën aty.

Këto mendonte vajza njëzet e dy vjeçare, që ecte lehtë-lehtë në mes të të rënëve, ku duhej të ndodhej edhe vëllai i saj i vetëm. Këto mendonte ndaj i dukej sikur nuk ecte, por sikur shkiste mbi lëndinë. Dhe përsëri përpara saj një tjetër i vrarë ndodhej i shtrirë ndën një pemë të rrëzuar; përsëri lëndina që spërkatur me gjak dhe festja e bardhë e të vrarit që skuqur e bërë si mjedrat që ndodhen tek-tuk nëpër lëndinë. Shumë trima ishin vrarë, shumë feste ishin gjakosur dhe, tek i shihte, i dukej sikur mjedrat ishin shtrirë përtokë nga një furtunë e madhe në lëndinën e Sherishtës, në atë lëndinë, ku ajo kish ardhur sa e sa herë me bagëti. Po, lëndina gjithmonë kish qenë vendi i saj më i bukur, më i preferuar. Dhe tani rrezet e diellit, që përkëdhelnin mjedrat i dukej sikur puthnin të vrarët në ballë, në sy, në buzë, në gjoksin e tyre të gjakosur. Ajo ulej pranë çdo të rëni dhe ia kryqëzonte duart, i mbërthente xhamadanin, i ngrinte palat e mëngëve e ia rregullonte festen e gjakosur ndënë kokë. E i dukej sikur nuk kishte patur një vëlla, por shumë vëllezër.

Por, çfarë ishte ajo gjë që zbardhte e skuqte në të njëjtën kohë? Me se loste era ashtu? Ç'ishin ato fletë që çpaloseshin dhe u ngjanin karafilave të kuq?!

U afrua ngadalë. Ajo ishte fletorja e të vëllait. Ajo vërtet nuk dinte të lexonte, por e njohu fletoren, njohu faqet e saja të spërkatura me gjak, shkrimin e të vëllait. I erdhi të ulërinte e të shkulte flokët me të dy duart e të çirrte fytyrën. Por e mbajti vehten. Kujet nuk i përkisnin atij, nuk i shkonin vëllait të saj. Po të qante, atij do t'i vinte turp nga shokët, do t'i dukej sikur ajo e qante nga që ish më i riu, ndërsa të tjerët ishin të mëdhenj. Po të qante, atij do t'i dukej sikur kish vdekur; por ai s'kish vdekur. Ai kish rënë mbi lëndinë ashtu siç ranë edhe shokët që ishin prindërit e tij. Ndaj, ajo nuk donte të qante, vetëm një klithmë lëshoi:

- Vëllai i motrës, shpirti i motrës, zemra e motrës!

Ajo e shtrëngoi fletoren pranë gjoksit të saj, që i ngrihej e i ulej papushim. E shtrëngonte dhe i dukej sikur

e lexonte atë. Vërtet, ajo nuk dinte të lexonte me sy, por dinte të ndjente, dinte të lexonte me zemër.

Pak më tutje ajo pa edhe trupin e gjymtuar të tij, që kish rënë në një gropë. Tani nuk ulëriti më, iu duk sikur e kapërceu një pjesë të dhëmbjes. Kështu është: në prag të fatkeqësisë njeriu ndjen shumë dhëmbje, pastaj sikur mësohet me të, me lotët, dhe nuk qan më. Dhe tani, asaj sikur po i qartësohej kujtesa...

... Kur frynin erërat nga gjiu i Vlorës, në dimër ato bënin që të ngriheshin dallgët e detit disa pash lart. Atëhere uji shkumbëzohej dhe e gjithë hapësira e tij nxinte e zbardhte në të njëjtën kohë. Ndërsa erërat e beharit ishin të ngrohta, ato bënin që të tundeshin lulet e pemëve të fushës, pastaj ndalonin në majat e maleve. Rrugës sikur e humbisnin atë ngrohtësinë e tyre. Ndaj, ato erëra të ngrohta për fusharakët, ndër male shndërroheshin në një fllad të freskët. E ky fllad, kjo freski, sikur i çlodhte njerëzit që rrinin atje, sikur i përtërinte të moshuarit dhe sikur bënte që të hedhin shtat të vegjëlit. Ndofta kjo është edhe arsyeja që ndër male pemët janë më të larta dhe njerëzit më të shëndetshëm.

Por, ato ditë qershori, erërat që vinin nga gryka e Vlorës sikur nuk ishin të freskëta. Pemët sikur tundeshin me hijeshi. Edhe bagëtitë, që mezi i prisnin këto erëra për t'u ngjitur në mal dhe për të kullotur në lëndinat e bukura e të pafund, sikur nuk përtypnin me qejf barin e njomë e të porsambirë. Culja e barinjve nuk po dëgjohej të binte më, ndërsa këmborët nuk nxirnin më atë tingull të ëmbël që bën të hidhen përpjetë nga gëzimi qingjat e kecat, e bariu t'ia thotë me gaz atij fyelli të drunjtë, që nxjerr melodi me dy zëra.

Në ato ditë Shqipërisë po i kanosej një rrezik i madh. Të huajt po përgatiteshin të shkelnin vendin tonë, të plaçkitnin e të digjnin kasollet tona, të shkonin në thikë çdo gjë, të shkretinin fushat dhe t'ia rrëmbenin krenarinë maleve tona.

Dhe, në atë qershor të trashjes së barit për bagëtitë dhe të çeljes së luleve, u ngritën njerëzit dhe iu qepën maleve. Fyelli i barinjve, përzier me këmborët e bagëtisë, kumboi me forcë si një kushtim. Pastaj u dëgjua krizma e pushkëve, nisën përpjekje të përgjakshme në Gjorm, në Kotë e kudo. Tri herë u hodhën pushtuesit në det. Tri herë u

zbrapën nga një popull pothuajse i paarmatosur, por i vendosur.

Ja, këto kalonte nëpër mend ajo dhe kujtesa e saj ngadalë po i qartësohej përherë e më shumë...

Një natë më parë edhe ajo kish dëgjuar të shtëna pushkësh. Më pas krismat ishin shtuar dhe ajo kish ndjerë se në Sherishtë po bëhej një luftë e vërtetë. Ajo e dinte se aty, bashkë me çetën, ishte edhe i vëllai; e dinte që ai i urrente pushtuesit, ndaj edhe kish dalë malit. E krenohesh ajo që nga familja e saj edhe ai luftonte kundër armiqve.

Gjëmimet vazhduan deri në agim. Çeta ishte e vogël, ndaj, sa më shumë zgjatnin gjëmimet, aq më shumë gëzohej ajo. Kjo do të thonte se italianëve u kishte hasur sharra në gozhdë. Pastaj agimi e çori napën e zezë të natës, dhe kur erdhën orët e para të mëngjesit e krismat kishin pushuar, ajo dëgjoi të lehurat e qenit. Më pas, një zë i mbytur, si një rënkim erdhi nga jashtë. Ajo kish dalë dhe kish parë në oborr një fshatar që vinte nga çeta. Ai kish ardhur duke u zvaritur, i plagosur në të dy këmbët. Ajo e kish futur menjëherë brenda dhe kish filluar t'ia lidhë me kujdes plagët. E ai i kish rrëfyer për të vëllanë, Yzeirin.

- Mos qaj bijë - i kish thënë Taushi, para se të vdiste në duart e saja - Yzeiri na nderoi të gjithëve. Komandanti i dha urdhër të largohej se ish i ri dhe s'duhej të vritej. Por ai, e kuptonte se aty e kish vendin. Dhe mirë bëri që s'u largua. Vetëm më vjen keq për shënimet që kish shkruar... Dhe, më duket se ra i fundit, bashkë me komandantin. Ndaj, besoj se i ka shkruar të gjitha... Ai ish pranë komandantit.. herë luftonte e herë shkruante çfarë i thonte ai. Po, po. I ka shkruar të tëra. Bile, ai numëronte breshkaxhinjtë kur binin. Deri në treqind numërova dhe unë. Pastaj..., pastaj kisha punë me një grup armiqsh dhe harrova fare të numëroj. Por, Yzeiri patjetër që i ka shkruar sa janë vrarë...

Kështu ai i tregoi asaj se si i përzunë italianët nga Gjormi, nga Kota dhe, më në fund, se si ata grumbulluan të gjitha forcat dhe u gozhduan në Sherishtë...

Vëllai, kish rënë pranë Selam Musait. Ajo i mori të dy trupat e i vendosi pranë njeri tjetrit në dy gropa që ishin të hapura nga predhat e gjyleve. Qëndroi pranë tyre duke i vrejtur me dhëmbje, me dhëmbje e krenari. E i bëhej sikur dëgjonte fjalët e atij luftëtari që i kish ardhur në shtëpi para pak orësh, sikur dëgjonte krismat e luftës së atij

grupi trimash:

- O burra, trima t'u biem armiqve! - përhapej në atë lëndinë zëri i Selam Musajt. - T'u tregojmë atyre se si u shkelka ky vend.

I dukej sikur lëndina, pemët, e gjithcka oshëtinte nga përleshjet, ndërsa në mes të krismave, dëgjonte përsëri zërin e Selam Musait që i thonte Yzeirit:

- Shkruaj, biro. Shkruaj! Pesë herë u zbrapën italianët. Janë vrrarë deri tani mbi treqind veta. Ndërsa ne, jemi përgjysmuar. Kemi mbetur njëzet. Por do të qëndrojmë, eh? Si thua ti?

- Patjetër, xha Selam - përgjigjej Yzeiri, duke qeshur.

Kështu kish qeshur ai edhe në luftën e Gjormit dhe të Kotës, kështu qeshte ai edhe në Sherishtë; ndaj, motra gjithmonë e përfytyronte vëllanë të qeshur.

- E Lamo, - i kish thënë Selam Musai Ismail Shamos; - qesh apo s'qesh Yzeiri me këta breshkaxhinjtë?

- Është trim ai, - ia kish kthyer ky. - Unë po bëhem pesëdhjetë vjeç dhe s'kam parë shqiptar frikacak. Kështu, pse të mos qeshë Yzeiri. Shqiptar është dhe ai.

Pastaj kishin qeshur që të gjithë. Edhe Selam Musai, edhe Taush Mehmetaj, apo Hakan Shabanaj e Xhafo Avdiu. Kishin qeshur të gjithë, ndërsa plumbat fishkëllenin dhe armët e tyre armiq rrëzonin përdhe.

Yzeiri qëllonte, shkruante dhe qeshte. Ai merrte shenjë më mirë. Plumbi nuk duhej të shkonte kot, ai duhej të godiste patjetër një armik, pa tjetër. Dhe për këtë ai ish i sigurtë. E kish mësuar të qëllonte vetë Selam Musai. Pastaj shtrëngonte pushkën pas gjoksit dhe me laps shënonte ç'i thonte komandanti:

- Islami, u vra dhe Hakani; - Ranë si trima.

- Përpara djema! - bërtiste Selam Musai.

Të gjithë hidheshin përsëri në sulm. Sërish tërhiqeshin italianët. Ushtonte Sherishta. Dikush me sëpatë rrëzonte të tjera pemë për tokë.

Prapë, sulmonte çeta e Yzeiri shkruante:

U vra dhe Xhafua.

Selam Musai hidhte vështrimin nga shokët; kishin mbetur tre gjithësejt. Mendonte komandanti e kalonte dorën në mjekër. Papritur ndjeu se dora e tij preku diçka të qullët. Ishte plagosur, tamam në nofull. Çudi! Si nuk e kishte kuptuar më parë. Do të kish ndonjë gërvishje të vogël.

- Yzeir!, - i qe kthyer djaloshit. - Më mirë tërhiqu. Ti duhet të shpëtosh patjëtër.

- Jo, nuk tërhiqem - kish kundërshtuar Yzeiri. - Unë do të qëndroj bashkë me shokët e tjerë, bashkë me ty.

Pastaj xha Selami kish vështruar Taush Memon. Sërish ata kishin qeshur. Nga grykat e pushkës kish shpërthyer flaka. Ishte si vazhdimi i një kënge që e kishin kënduar të gjithë shokët, e gjithë çeta.

Yzeiri kish shënuar në bllokun e tij:

"Kemi mbetur tre veta: xha Selami, Taushi dhe unë. Deri tani janë vrarë pesëqind e tetëdhjetë e shtatë italianë.

Pastaj ai nuk kish shkruar më.

Dhe vajza vështronte Selam Musanë e të vëllanë pranë. Tre kishin mbetur, por nuk qenë tërhequr.

- Përpara djema! - kish bërtitur komandanti si përhera, por kish mbetur vetëm.

Ai kish parë edhe një herë nga shokët që skuqnin lëndinën. I kish parë një copë herë të madhe, sikur të donte të bënte bilancin e jetës së tij dhe të shokëve të tij. Kish parë edhe Yzeirin e kish folur me zë të ulët:

- Mirë që ra këtu se sa të duronte të huajin! - Dhe i vetëm kish sulmuar.

Kur ra, nuk ndodhej më shumë se dy hapa larg Yzeirit. Ndaj u lëkund disa herë dhe gjaku i tij spërkati lëndinën e Sherishtës.

Kështu ra e gjithë çeta...

Që nga Sherishta Vlora dukej si në pëllëmbë të dorës. Vajza e mbushur me urrejtje dhe me një vështrim të qartë, shumë të qartë, rrëmbeu një jatagan dhe dolli në anë të ullishtes. Që andej ajo shikoi se si nxinin kodrat e rrugët nga njerëzit e revoltuar. Ata, si një ortek i madh, kishin rrëmbyer ç'kishin mundur dhe po drejtoheshin nga deti. Edhe, ajo zbriti poshtë në drejtim të tyre, për t'u bashkuar me ta e etur për t'u ndeshur sa më parë me armiqtë.

Ishte qershor i vitit 1920. Që nga ajo kohë kanë kaluar shumë vite, por ata nuk janë harruar. Do të dilte, do të dilte patjetër dikush dhe do t'i binte fyellit me zë të dyfishtë në shenjë nderimi e respekti. I gjithë populli u këndoi atyre:

Në luftën e njëzetë
Një djalë nga katundi Velçë
Në moshën tetëmbëdhjetë
Dolli vullnetar në çetë.
Në çetë e në komisionë,
Në Beun kur u mbëlodhë
I thanë: "O djalë, na folë!"
Yzeir Skëndo Habili
Dolli e foli si bilbili:
"Sonte do vemi në Vlorë
Me flamur të kuq në dorë".
Atë natë Vlorës vanë
Se bënë luftë e u vranë
Trimat me Selam Musanë.

.....

Dhe këngët shkuan lëndinë më lëndinë, kodër më kodër, mal më mal; u përplasën në dallgët e detit... Këto këngë erdhën deri në ditët tona e do të shtektojnë në gjithë kohërat e mëvonshme...

MACJA ME VESHË TË PRERË

Motori i autobusit qe ndezur. E tërë karrocERIA dridhej si të kish mornica në trup. Pasagjeri i fundit që hypi ishte një plakë, e cila mbante në dorë një shportë, grykën e së cilës e kish mbuluar me një pëlhurë të qepur rreth e rrotull kanistrës. Plaka zuri vend aty nga mesi, kurse kaçilen e lëshoi pranë këmbëvet. Përpara kishte një grua të thyer, dhe prapa një burrë të moshuar. Ndofta, për induksion, edhe këta të dy ndoqën shembëllën e saj, sepse pakot e tyre i zbritën përposh sediles. Atë çast, dera u mbyll dhe maqina u nis.

Aty nga radhët e prapësme, biseda e dy të rinjve kish marrë zjarr. I pari, një djalë me cullufe të verdha, i thonte të dytit që i kish vetullat si të lyera me katran:

- Ty s'të mbushet koka dhe shkoi e vajti, more Neptun! Unë ve bast me çfarë të duash se jaguari, ashtu edhe leopardi, janë pantera. Leopardi është forma afrikane, dhe jaguari trajta amerikane. Sa për tigrin, që zë epiqendrën e debatit tonë, edhe ky është i familjes së macevet. Ai sulmon në mënyrë të veçantë njeriun; është i gjatë dy metra, peshon dy quintalë dhe rron njëzet e pesë vjet. Në shumë vise të Indisë, ku e quajnë hamës njerëzish, tigri bën kërkinë. Akshamit, po të gjeti në pyjet moçalore, e ka të siguruar iftarin.

Djaloshi me vetullat si të lyera me katran, ia priti menjëherë:

- Ahere, sipas teje, more Selo, tigri mbaka ramazan!

- Ahu! Po t'i marrësh fjalët kallëp, kot që po e bëjmë këtë bisedë. Unë të them se tigri të kollofit pa një pa dy.

- Po atë Indira Gandin e ha po ta gjejë në pyjet moçalore?

- Ama llaf që thua edhe ti! Mendon se tigri bën dallime? Le t'i lemë këto. Ia ke parë qimen që ka? Një të verdhë në ngjyrën e portokallit, i bardhemë në bark, dhe me vija të zeza si të zebrës. Të shikoj nga sytë dinakë që kërkon të thuash me vete: "Ky dashka të vrasë të trasha!" Mirëpo, s'është ashtu si të shkon në mend. Unë dua vetëm ta ve në dukje se tigri, pa e hequr asllanin nga defteri, është më i fuqishmi i mishngrënësvet.

Aty për aty, nga goja e të rinjve të tjerë, gjëmoi kënga e hekurudhës Rogozhinë-Fier. Tingujt e saj të mprehtë u dukën sikur e çpuan bisedën tejpertej, dhe kjo, si të ishte ndonjë laraskë e goditur në fluturim, ra përdhe pa shpirt. Djali me cullufe të verdha, dhe ai tjetri që i kish vetullat si të lyera me katran, hynë me një frymë në korin e përgjithshëm. Kur melodia mori fund, duart e të rinjvet u përpoqën me aq tërsëllëm, sa që u duk sikur po kalonte ndonjë ciklon tropikal.

- Ua! Shikoni një tigër të vogël! - thirri papritur Selua me atë zërin e tij të hollë, i cili shembëllente si të kish dalë nga thellësia e ndonjë trumbete.

- Ua! Qenka me të vërtet një tigër i vogël! - ia bëri një oficer që zuri ta ndillte.

- Po pse ja paskan prerë veshët? - pyeti një çupë e zhdërvjellët që s'e lëshonte nga sytë.

- Na... pis... pis! - u dëgjua një kor aty nga fundi - ndërsa të tjerët ia bënë: "Mac... mac...!"

Në çast, plaka hodhi shikimin në shportë, dhe ngriti zërin sakaq:

- Korba unë! Më paska dalë macja! Ah, këta ditëshkurtër e trembën! Mos e ngisni, more djaj, se do të ma friksoni!

Fatorinua ndërhyri me një zë të rëndë:

- Mojt nënë! Po ti s'e di që është e ndaluar të futësh kafshë në autobus?

Plaka, që desh ta zbrazte inatin mbi të, ia ktheu flakë për flakë:

- E çfarë kafshe kam futur, more shok? Po të ish ndonjë gamile, e kuptoj, po unë kam marrë vetëm një mace. Ç't'i bëj sime bijë? M'i hëngri veshët! Më në fund ia dhashë fjalën se, kur të vete në Tiranë, do t'i sjell një mace nga Korça.

Fatorinua ndërhyri sërish:

- Po pse, mojt nënë, u shojtën macet e Tiranës që t'i sjellësh një nga Korça?

Plaka ia preu:

- Ti s'i ke bërë ditët të më apësh mend mua! Pastaj, kjo mace që shpie unë, s'është kobashe. Ç'dashke zotërote? Të marrë ndonjë nga ato që t'ia rrëmbejë felën nga tenxherja?

Siç e pa që s'ia dilte dot me të, fatorinua mbeti në vendin e vet, ku ndezi një cigare me filtër, e cila po ia mbulonte zemërimin me një tym të kaltër. Nga pasqyra kënddrejtë, që rrinte e pjerrët dhe si e varur mbi kokën e tij, shoferi, një Goliath me faqe të fryra, mudohej ta shtinte në kanalën e saj pasagjeren me katër këmbë.

Djaloshi me cullufe të verdha e kish ndezur sërish bisedën rreth familjes së macevet.

Aty për aty, u ngrit një zë që vinte si i çjerrë. Të gjithë kthyen kokën, dhe dëgjuan një grua që thërriste:

- M'i rrëmbeu kofshët e pulës nga pakoja! E shpëlaftë mortja nga na mbiu kjo mace kobashe këtu?

E, duke iu kthyer plakës me inat, shtoi:

- Ma bëre këtë zarar që s'më del nga mendja! Tashi, ç't'i shpie sime mbesë në hekurudhë? Katëkun?

Plaka, që e kish përgjegjen në majë të gjuhës, i tha me një gjakftohtësi të papritur:

- Edhe atë shumë e ka.

Pastaj, duke ndjellur macen, ia bëri:

- Tanci! Më dëgjon? Haji që të dyja se kundërmojnë erë gjalpo!

Djaloshi me cullufe të verdha ndërhyri duke iu drejtuar gruas së thyer:

- Plaka flet me vend. Më pyet mua që isha në hekurudhë gjatë dymujorit prill-maj. Atje, sa për të ngrënë, s'ke ç'i thua! Më vraftë buka në të gënjej!

Gruaja e thyer iu përgjigj duke e shikuar shtrembët:

- Ti mos na shit mend! Se ç'bëj unë, është punë për mua!

- Ma rrëmbeu ngastrën e byrekut nga pakoja! S'kam parë

mace më të ndyrë se kjo që na mbiu këtu! - thirri një burrë i moshuar.

E, siç iu drejtua plakës, foli me gjak të prishur:

- E shikon? Edhe mua ma bëri zarar! Zgjodhi copën më të madhe që ishte sa gjysma e tepsisë! Më thuaj, të kam rixha, ç't'i shpie unë tashti tim nip në hekurudhë? Thembrat?

Dukej se plaka i kish të gjitha përgjegjet në majë të gjuhës, sepse ia ktheu sakaq me po atë gjakftohtësi të papritur:

- Edhe ato shumë i ka.

Djali me vetulla si të lyera me katran, priste që Selua t'i përsëriste burrit të moshuar se gastronomia në hekurudhë qëndron në një shkallë më të lartë nga ajo e shtëpisë: mirëpo, ai dëgjoi djaloshin me cullufe të verdha që tha:

- More! Ç'po bëni kështu? Kjo, një goxha pulë të pjekur, dhe ti një tepsi me byrek! Ju paskeni marrë me vete një restaurant të tërë!

Autobusi kish arritur në Elbasan. Plaka zbriti e fundit. Tancin e kish gjetur mbi sedilen e prapësme, ku po bëntë një sy gjumë. E mori lehtë-lehtë, e futi në shportën e çpuar, ia qepi grykën sërish, dhe humbi midis kallaballëkut që nxitonte të zinte radhë në biletarinë e trenit, ku macja me veshë të prerë ëndëronte të gjente kofsha pule dhe ngastra byreku në një sasi më të madhe.

M J E S H T R I

Megjithëse jam nxënës, në verë im atë e ka zakon të më vejë në punë. Natyrisht, ai nuk gjen punë të papërshtatshme për mua, por sidoqoftë kërkon punë fizike, ku krahu dhe këmba të vihen në lëvizje. Sipas tij kështu fillon çlodhja. Se po të rrish, thotë ai, nëntë muaj mbërthyer në bango dhe të punosh me kokë, nuk lëviz gjaku dhe lëngu që thithin rrënjët gjatë një viti po s'u shpërnda edhe në degët ato mpihen, vshken dhe thahen.

Edhe unë vetë e kam qejf punën e krahut.

Këtë vit im atë më çoi të punoj pranë një mjeshtri të gurit. Quhet Koço. Është një burrë i shkurtër, i vogël, i kërrusur pak në shpatullat dhe, megjithëse është shtatëdhjetë vjeç, të duket se nuk i ka rënë as një fije nga flokët, të cilët i shkëlqejnë si fije argjendi. Ai zakonisht i qeth flokët shkurt dhe mund t'ia vesh re që nga rrënjët se nuk ka asnjë fije të zezë. Bile, unë e kam vënë re mirë, kur është i kërrusur me daltë në dorë dhe kur mbi flokë i bie drita duket sikur përnjëherësh koka i mbulohet me kristale vezullonjës. Sytë i ka larushë dhe të mëdhenj sa të duket sikur kapakët mezi do t'ia mbyllin. Flet me një zë të trashë dhe godit me çekan mbi daltë pjerrët duke ngritur më tepër se sa duhet buzën e poshtme. Megjithëse ka moshën e pensionit, ai nuk ndahet nga dalta. Nga duart e tij dalin gjithnjë punë të përsosura.

Mjeshterin e kishin thirrur në Komitetin e Partisë dhe kishin kërkuar prej tij të gdhendte një obelisk të lartë prej guri për nder të të rënëve në luftën Nacional-Çlirimtare. Detyrën e re mjeshtri e kish pritur me një kënaqësi të veçantë vetëm se kish kërkuar një ndihmës dhe ja, rasti e solli, që unë t'i vij në ndihmë. Unë kujtoja se e kish kërkuar këtë ndihmë, vetëm që të kish një njeri ta urdhëronte andej këtej, t'i mbushte ujë apo t'i mprehte daltat. E vërteta s'ish kështu. Sapo u paraqita në mëngjes në punë, pashë që mjeshtri ish përgatitur si për ekskursion. Kish marrë çantën e shpinës, kish veshur këpucë të lehta dhe më tha:

- Nisemi!

- Ku do të shkojmë? - e pyeta unë.

- Hajde djalë, më tha, pa të tregoj unë. Merr me vehte atë levën e gjatë prej hekuri.

Në dorë ai mbante një çekan si të gjeologëve.

U nisëm nëpër male. Mjeshtri Koço që e dinte vendin me pëllëmbë dhe cilësinë e gurëve përçark, i kish braktisur mademet e vjetra dhe kërkonte një madem të ri prej guri të kuq për obeliskun. Ne kalonim përrenjëve, rrëzave, atje ku erozioni kish vepruar më shumë. Mjeshtri ndalej mbi pllakat prej guri, i godiste me çekiç, i thyente dhe shikonte cilësinë, pastaj i hidhte poshtë si sende pa vlerë dhe ecte më tutje. Herë herë nxirte ndonjë psherëtimë të lehtë dhe me këtë donte të tregonte se ish e vështirë të zbuloje një madem të ri prej guri. Si bënte ai ashtu, fillova të bëj edhe unë. Godisja me levën prej hekuri pllakat prej guri, atje ku më hante mendja se mund të kish ndonjë gjë, po mjeshtri kthente kokën dhe më jepte të kuptoja se syrit të tij nuk do t'i shpëtonte po të kish gjë dhe se mundimi im ishte fare i kotë.

Po ngjiteshim mbi Malin e Kuq. Në mesditë, mjeshtri e pa me vend të ulëshim pranë një gurre nën hijen e pishave. Ujërat shkisinin tatëpjetë duke shushuritur dhe duke dhënë reflekse të bardha të ndritshme. Lëmashku ish rritur anës gurëve që kishin marrë ngjyrë të gjelbër. Aty këtu dukeshin hala pishash ngjyrë kafe që i kish marrë rrëkeja dhe i kish mbledhur tufë pranë ndonjë guri. Mjeshtri nxori kapelën e vjetër me strehë të thyer, fshiu ballin e djersitur dhe më tha:

- Ja, nga ky ujë duhet të pimë me filxhan kafeje.

Përpëliti nja dy herë sytë dhe duke nxjerrë një oh të gjatë, u ul nën hije. Aty qëndruam nja dy orë dhe biseda jonë vërtitej rreth gurit. Mjeshtri ish njeri i shetititur dhe nga sa kish parë, i qe rrënjosur në kokë se guri nuk vdes kurrë. Pikërisht kjo ishte arsyeja që kur e pyeta unë se përmendorja mund të ngrihej edhe me beton dhe të vishej me pllaka mermeri, ai u përgjigj:

- Jo, guri është më shekullor dhe vepra e atyre për të cilët ngrihet është shekullore dhe duhet të rrojë për jetë.

Kërkuam dhjetë ditë me radhë mbi Malin e Kuq, duke u vërtitur rrëkeve, gropave e përrenjëve gjersa mjeshtrit Koço iu mbush mendja se ku mund të nxirej nga dheu obelisku.

Këto dhjetë ditë qershori mjeshtri, me çekani e tij dhe unë me levën prej hekuri, kërkuam me këmbëngulje, lëvizëm shkëmbinj dhe i rrëzuan në humnerë, vrejtëm shtresat e gurit dhe damarët e dheut, ujërat e nëndheshme dhe lëvizjet e tyre. Isha dërmuar fare, po mjeshtri nuk dinte të ndalej; kurioz dhe me vendosmëri ecte përpara ngadalë, por i sigurtë se instinkti kurrë nuk do ta gabonte. Ai më dukej se me një vështrim ish në gjendje të depërtonte nga sipërfaqja gjer në thellësi të tokës, atje ku lëvrijnë rrënjët dhe hapen degët e mademeve të gurit. - Këtu, tha, dhe sikur të kish përcaktuar kordinatat e sakta ku do të binte një predhë artilerie, përsëriti:

- Këtu do të fillojmë, - tha, duke zgjatur poshtë, me energji, gishtin tregonjës. Dhe aty filluam. Toka e shkrifët, e lagur, rrëshqiste nga lopata ime. Mjeshtri ndiqte damarin e gurit që shkonte në thellësi të tokës. Për dy ditë e zbuluam gati të gjithë atë masiv prej pesë metrash. Pastaj filluam me pyka hekuri dhe vare për ta shkëputur tërësisht nga mali. Leva e hekurt në duart e mia përkulej nën peshën time. Mjeshtri vendoste pykën dhe qëllonte me varenë e madhe. Qëllonte me kujdesin më të madh dhe, në të njëjtën kohë, vrente plasaritjen e lehtë të gurit. Kjo ish një punë e vështirë. Njëzet ditë gërmo, qëllo me vare, pastaj përdor levën prej hekuri... Duart na u gjakosën, lëkura na u hoq në gjunjë, po mjeshtri shtatëdhjetëvjeçar nuk ndahej. Ai e dinte më mirë nga unë parimin e llozeve të Arkimit. Guri u shkëput dhe, kur filloi të rrëshqiste mbi rulin e fortë prej druri që kishim vendosur përpara ndërsa ne me levat e gjata e shtynim nga pas, ai u shtri mbi obeliskun dhe më urdhëroi që të marr varenë dhe të qëlloj gurin nga fundi. Ai vendosi veshin ashtu siç e vendos mjeku në shpinën e të sëmurit dhe përgjonte të goditurat e mia. Pastaj më urdhëroi të qëlloj nga ana tjetër, herë me varenë e madhe, herë me varenë e vogël. Kur unë e pyeta mjeshttrin se ç'po bënte ashtu, ai m'u përgjigj:

- Përgjoj se mos ky gur ka damare dhe plasaritje të brendshme. Dhe po të jetë kështu do ta braktisim dhe do të kërkojmë një tjetër. Ky s'duhet të ketë asnjë të çarë, asnjë, - përsëriste ai. - Tani duhet transportuar.

Mjeshtri e vendosi mbi trarë, pastaj vuri ganxha e trarë të tjerë tërthori, nën të vendosi disa rula të mëdhenj rrotash të lidhur mirë dhe, më në fund erdhën traktorët për ta tërhequr.

Kur mbas tri ditësh guri erdhi në parkun e qytetit, përreth u mblodhën shumë njerëz. Mjeshtri dukej i gëzuar po nuk e tregonte tërë gëzimin. Mjeshtri Koço i vinte rrotull gurit, zbërthente ndonjë ganxhe duke e goditur me çekan dhe i përgjigjej me buzëqeshje, herë njerit, herë tjetrit.

Që të nesërmen filloi të gdhendte. Koka e tij vezullonte atje midis trëndafilave të kuq. Kurrë nuk mbetej vetëm. Gjithnjë do të gjendej një njeri që do të vinte ta sodiste e t'i bënte muhabet. Kjo e mërziste tepër, kaq sa shpesh hidhte xhaketën pas krahut dhe shkante në klub gjoja sikur do të pinte kafe.

Dalngadalë njerëzit e kuptuan këtë dëshirë të mjeshtrit dhe nuk i afroheshin, por e vrenin nga larg atje midis luleve dhe trëndafilave të parkut, ku s'pushonte së gdhenduri obeliskun.

Dhe kur erdhi ajo ditë që u mblodh populli dhe sekretari i partisë zbuloi përmendoren, të gjithë e mbajtën një çast frymën, duke vrejtur obeliskun që i përngjante një shigjete të kuqe gati për t'u nisur drejt qiellit.

Unë isha fare pranë mjeshtrit. Dukej i ngazëlluar nga që i shtrëngonin me dashamirësi duart dhe e përqaфонin. Aty dëgjova se dikush i bëri një vrejte duke i thënë se për herë të parë mjeshtrit i kish gabuar syri, se kur u bë matja e obeliskut, doli që guri ish tri centimetra më i lartë se sa ish porositur.

Mjeshtri, duke buzëqeshur u përgjigj:

- Jam i vetëdijshtëm për ato tri centimetrat: dhe e vështroi në sy.

Dhe kjo besoj se është tepër e qartë.

LEGJENDA E NJË FISI

Tregojnë legjendat, rrëfen historia dhe gojë pas goje e brez pas brezi gjyshërit ua lanë si trashëgim nipërve dhe stërnipërve të tyre, se në mjergullën e dendur të shekujve lindi dhe u mëkëmb një fis.

Qysh në ditët e para të jetës së tij i paskan thënë:

- Ti linde për të vuajtur, se je i vogël.

Dhe ky, i mitur siç ish, na paskësh vënë buzën në gaz dhe na qenkësh përgjigjur:

- Linda që të jetoj dhe jo që të vdes.

Kjo përgjigje na e paska fryrë me maraz perëndinë e kohës, Hronosin, i cili shfreu me këto fjalë:

- Ti na qenke sa i vogël aq dhe kokëfortë. Rrota e kohës do të të shtrydhë si një kokërr rrushi.

Dhe në këto e sipër, thotë legjenda, na i ktheu krahët perëndisë së plotfuqishme të kohës dhe, pa e ngjatjetuar nisi të ecë me këmbët e veta nëpër rrugët e kryqëzuara të shekujve. Dy rrugë i mbetën: ajo e vdekjes dhe ajo e jetës. Zgjodhi të dytën. Dhe që nga ajo kohë i tërë fisi mori një formë tjetër dhe u ndërrua në Feniks 1). Dhuna, gënjeshtër dhe padrejtësia iu vunë pas.

Kështu nis rruga e Golgothajt 2), një rrugë që nuk ish e shtruar me trëndafilë; gjëmba, driza dhe errësi e mbulonin pjesën më të madhe të saj. Po për atë që ecën drejt jetës, shpejt ose vonë, errësira kthehet në dritë.

Ky na kish edhe disa parime të thjeshta, të pashkruara, që i pat mësuar në librin e madh të jetës. Një nga këto thënie, që rridhte nga burimet e kulluara të urtësisë popullore, është edhe kjo:

- Atij që nuk të do, po t'i japësh majzën e thoit, të rrëmben gishtin, në i dhënç gishtin, të merr dorën, po i dhe dorën, të merr trupin, dhe po të mori trupin, të mori edhe shpirtin.

Dhe shigjeta lloj-lloj ngjyrash filluan të fishkëllojnë mbi kryet e tij. Hronosi po hakmerrej. Feniksi nisi ta

rrudhë pakëz ballin e ndritur, u vrenjt, u bë më i vrazhdë, buzëqeshja iu venit nga fytyra.

Shigjeta iu ngulën në sy, por syri i lëshoi flakë, në atë flakë shigjetat u tretën dhe syri u zbukurua më shumë.

Shigjeta i çpuan gjoksin, por gjoksi i llamburiti si trëndafili i përgjakur, kur e puthin rrezet e para të diellit.

Shigjeta iu qepën ballit, dhe ballit i ra një nur ylberi.

Shigjeta i çanë trupin, i hapën plagë sa një gojë, por plagët ia bënë edhe më të hieshëm atë trup.

Në ndeshje e sipër, kur rrukullisej si një shkëmb i përflakur nga majat e idealit dhe flakëronte tatpëjetë si vetëtima gati për t'u thërmuar, shpesh armiku thirri: "Fitore!" - Por ja, papritmas, krenar e i padhënë, ai çante përsëri lart, i priste shigjetat me gjoks dhe kundërsulmonte.

Në pamundësi që t'i shembnin zemrën, ata qëllonin trupin. Kur e sodisnin këtë David 3) ballë për ballë me Goliadhin, yjtë sikur e dëndësonin xixëllimin e tyre, hëna sikur e ngadalësonte udhëtimin e saj vetmitar, flladi i mëngjesit sikur vraponte ta puthte me afshin e tij që t'ia ledhatonte cazë plagët. Nga poshtë rrëketë e rrëmbyera, me oshëtimën e tyre, sikur e ftonin që t'ia freskonin krahët e përgjakur me shkumën e tyre të ergjëntë.

Dhe yjtë e hëna, dhe flladi e rrëketë e pyesnin me dhëmbje e admirim:

- Prej ç'fisi je?

- Si të thonë?

- Ku banon?

- Si s'të mposhtin plagët?

- Ç'moshë ke?

- Jam arbër. Luftoj për të jetuar. Jam me të drejtën.

- Eshtë shumë i lashtë dhe gjithmonë i ri - u përgjigj me zërin kumbonjës një shqiponjë që çante qiejt aty pranë. Dhe duke përplasur rëndë-rëndë krahët e saj që vezullonin nënë

rrezet e diellit, shqiponja shtoi: - E ka zakon të përgjigjet shkurt. Është shumë i lashtë.

Rrënjët i ka të thella, në palcën e rrembave të tokës amtare që e ka ushqyer. Degët e tia janë malet e patundshme që stolisin si kurora të pavdekshme atdheun, ku u lind e u rrit.

Mbi çdo gur të këtyre maleve ku lindi e u rrit është skalitur çdo faqe e historisë së tij, faqe e skuqur nga gjaku dhe e ndritur nga lavdia. Çdo shkëmb ka edhe legjendën e vet. Gumëzhima e atyre përrenjve atje poshtë që shkasin rrëmbyer tatëpjetë, është jehona e sokëllimës së astritëve kur ndesheshin gryka-grykës me të padrejtën. Buçima e lumenjve, buzë atyre luginave që gjelbërojnë atje thellë, është sinfonia e pambaruar, që shkon brez pas brezi e u thotë atyre që vinë se fuqia nuk matet me numrin e banorëve, por me zemrën.

Kur shigjetat i çanin gjoksin, kish që pyesnin:

- Çfarë fshihet vallë brenda atij gjoksi? Do të ketë futur ndonjë hajmali në zemër!

Të liqtë i thoshin:

- Ti qenke i egër!

Dhe ky përgjigjej:

- Pse jam me të drejtën, qenkam i egër?

Dhe shpifja e ndiqte këmba-këmbës. I thoshin:

- Ti s'ke gjuhën tënde, s'ke historinë tënde, s'ke traditat e tua, prandaj s'ke pse jeton.

Dhe ky ua kthente:

- Unë kam gjuhën time, historinë time, traditat e mia, po aq të lashta sa tuajat.

Ata harronin se ky quhej Feniks.

Dyndje të njëpasnjëshme, sulme, rrethime, shkatërrime, djegie e cfilitën, e leqendisën, e tretën, por ai rilindej nga hiri i gërmadhëve. Herë me bukë, herë pa bukë, herë zbathur, herë mbathur, herë me shokë, herë vetëm ai e çau rrugën e mundimeve përmes reve të dëndura shigjetash,

faqebardhë e ballëndritur. Kish me vete të drejtën dhe gjithë të mirët, të thjeshtët, zemërbardhët. Dhe të mirët janë më të shumtë nga të liqtë. Kështu erdhi një ditë që edhe koha ish me të dhe punonte për të. Dhe Hronosi kur pa se i pabinduri kurrë s'iu dorëzua vdekjes, hoqi dorë nga ndjekja. Dhe buzëqeshja nisi të spikatë në fytyrën e tij.

Këto e shumë të tjera i tregon legjenda. Këto e shumë të tjera i shkruan edhe historia. Por e liga nuk u zhduk nga kjo botë.

Dhe kur rastis që ndonjë i vetëquajtur Hronos, nga ata modernët anakronikë që ngatërron kohët, përziën vendet, që s'dallon dot të drejtën nga gënjeshtria, shqiponjat nga bretkosat, i lëshon Feniksit breshër rrufesh me barut të lagur, Feniksi ia kthen, sipas zakonit, me këto fjalë:

- Jam me të drejtën!

.....

1) Shpend mitologjik që besohej se s'kish mortje, pasi sa herë merrte zjarr e digjej rilindte nga hiri i vet. Mortja e kishte halë në sy, se nuk e mposhte dot.

2) Golgotha: Fjalë me origjinë fetare që ka hyrë në letërsi dhe tregon rrugën e mundimeve të një njeriu ose të një populli.

3) Davidi dhe Goliadhi janë personazhe biblike: i pari përfaqëson të voglin i cili, duke pasur të drejtën me vete i bën ballë të madhit (Goliadhit) dhe e mposht atë kur sulmohet prej tij.

TREGIM PËR LEZEN DHE PËR HILËN

Hila e kuptoi që kamioni s'do të shqitej më nga ajo rruginë pylli; të gjitha përpjekjet ishin të kota. Në jetën e tij kurrë s'kish fjetur në mes të pyllit, në një lartësi të tillë, në një largësi kaq të madhe. Nxori sedilet, i vendosi në rrypin e tokës, ku akoma zbardhte një fasho drite dhe u shtri më kurriz.

Po i binte inati. Për herë të parë ndjeu cicërimin e zogjve. Një grifshë çau drejt makinës, por kur pa masën e panjohur të hekurt, ndërroi drejtim e zbriti poshtë në tatëpjetën e pyllit.

Që kur mbaroi kursin, para shtatë muajsh, kjo ishte nata e parë që nuk kthehej në shtëpi, pa e ditur e shoqja. Ajo do të priste deri në dhjetë, shumë shumë deri më njëmbëdhjetë dhe pastaj do të shkonte të pyeste në apartamentin e Zaçes: "Mos e ke parë gjë Hilën, se nuk më është kthyer?" "Kur dola unë nga sektori, ai mori përpjetën e sektorit. Do t'i këtë rënë ndonjë gomë, mos ki merak". Por nusja e tij nuk do ta besonte. Ajo do të ulte kokën e dëshpëruar dhe do të matej të largoj. Nusja e Zaçes, si më e madhe, do të mundhej ta fuste brenda e ta qetësonte: "Pa më pyet mua, sa net kam gdhirë pa gjumë për Zaçen? Por ja ku e kam Zaçen, si pëllumb. S'i gjen gjë këta, jo-o". Hilës i vinte keq që e shoqja ish e detyruar të rrinte gjithë ditën vetëm në dhomë. Ajo ish nuse e re, nuk ish futur në punë dhe në qytet vetëm me Zaçen dhe gruan e tij njihej. Ai nuk e kish futur në punë sepse vend në rrobaqepësi nuk kish, por në gatra. "Nuk kam shtatë gra unë, që ta lëshoj rrugëve", - kishte thënë.

Hilës i vinte mirë të përfytyronte ditën e nesërme, kur do të kthehej në shtëpi, që të shihte fytyrën e pagjumë, të trembur e njëkohësisht të gëzuar të nuses së tij. Burri në raste të tilla e kupton sa shumë e do gruaja, sa besnike e ka dhe deri në ç'masë e ndjen ajo mungesën e tij. Hila ish i kënaqur nga nusja, sepse ajo ish vërtet e turpshme, e sjellshme dhe e bindur. Në muhabetet me shoferat, ai kish dëgjuar shumë historira grash, dhe në këto muhabetë mbizotëronin historitë komike. Sa herë që dëgjonte muhabetë të tilla, Hilës i bëhej automatikisht kjo pyetje: "Po ajo imja? Çdo të bënte ajo vallë po të ish në vendin e filanes?". Ndoshta ishin këto pyetje që e bënë të mos ngulte këmbë për t'i gjetur së shpejtë punë.

Hila ndezi cigaren e fundit. "Do të fle këtu, jashtë, mbi sedile. Duhet të merrem me diçka sa të vijë koha e gjumit. Të ishte si më parë, do të zgjatesha e do ta këpusja atë degë aty e do ta bëja një furkë deri në mesnatë. Nesër do t'ia çoja nuses sime furkën e ajo do të gëzohej. Kurse tani, po t'ia çoj, ajo do të hapë sytë e ndoshta do të ma marrë për ters, se do të mendojë sikur unë dua që ajo të tjerrë lesh, që të kalojë kohën e që të mos mërzitet".

Hila u ngrit, nxori biçakun dhe e preu degën. Automatikisht filluan t'i punojnë duart mbi lëkurën e njomë të degës. Por edhe gdhendja e drurit e mërziti. Ai e hodhi degën e zbriti poshtë, në tatëpjetën e pyllit. Këmbët i fundoseshin në sustën e butë të gjetheve. Sa më thellë futej aq më shumë humbiste drita. Filloi ta ndjejë veten të vetmuar. I vinte çudi me këtë ndjenjë të re, që po provonte në mes atyre mijëra trupave të heshtur të moshave të ndryshme që qëndronin para tij gatitu. Ai ish rritur në mes pyjeve, kish kullotur dhinë, kish shkuar qindra herë për dru e për shkarpa deri sa e morën ushtar. Si shpjegohej që tani e ndjente veten krejt ndryshe në pyll? Kaq shumë kish ndryshuar gjatë këtyre dy vjetëve? Kaq shumë ish futur në trupin e tij bota e makinës, bisedat dhe shoqëria e shoferave, prania e gatrave, sharrave? Ai ndjeu se këmbët e tia filluan të ngjitin përpjetën që e çonte te makina. Kjo ishte si një shkëputje e vullnetshme, nga gjithë e djeshmja e tij. As ai s'e kuptoi përse nuk po i vinte mirë nga kjo largesë dhe ftohtësi që po ndjente për pyllin, drurët, gjethet e rëna e të parëna. Edhe kur vinte në shtëpinë e tij në katund, malli për dy pleqtë e tij, për fshehtësirat dhe kujtimet që i dinte vetëm ai, i shkrihej brenda dy orëve dhe ai provonte, në gjithë trupin e tij, dëshirën të kthehej në park, pranë makinës në sharra, pranë shokëve dhe zhurmave të hekurave që presin drurët. Të njëjtën ndjenjë provonte pas dy javësh për prindërit, për katundin dhe për shtëpinë e tij prej guri. Kur e mendonte këtë gjë të fshehtë të shpirtit të tij, ai trishtohej e mbyllej e nuk kish qejf të fliste as me shokët, as me nusen e tij. Vetëm ecja e makinës ia shuante këtë gjendje të pakuptueshme e të padëshiruar. Ai ish shofer i ri dhe lëvizja e makinës nëpër rrugët e pyjeve, ndjenja e zotërimit dhe e pushtetit mbi atë masë hekuri vetëlëvizëse, ishte një farë dehjeje, që s'krahasehej me asgjë.

Dikush i binte borisë atje, mbi rruginë. Boria binte me sinjale të prera e me këmbëngulje. Ajo ishte një bori e huaj dhe Hila e kuptoi se sonte s'kish për të fjetur mbi

sedile, në mes të pyllit, por në krevat, pranë nuses së tij. Atij sepse iu kujtua një krahasim i një shoferi që thonte se gratë janë të pakuptueshme e të thella si pylli. Nusja e tij nuk ishte ashtu. Ajo kish diçka nga pylli, por anën e mirë të tij, freskinë, shëndetin dhe heshtjen.

- O Hilë, mo-o-o-re-ee!

Hila ndaloi hapat. Ky ishte një zë i njohur, të cilin ai kish një vit që e dëgjonte pothuaj çdo ditë. Tanimë këtë zë e njihnin të gjithë punëtorët, sharraxhinjtë dhe administratorët e atij qyteti të vogël. Disa njerëz e dëgjonin me kujdes që të kuptonin se cilat fjalë, cilët tinguj, bile edhe cilat pauza të atij zëri, kishin kuptim të dyshimtë dhe të pazakonshëm. Hila kish dëgjuar disa dhjetra biseda, që komentonin nuancat e atij zëri. Logjika përfundimtare e të gjitha bisedave që bëheshin ishte: "Duket ajo, që nga zëri. Nuk e sheh si flet?"

Kjo ishte Lezja.

Hila ndaloi.

- O Hi-i-i-i-lë!

Të ecje deri lart në rruginë, do të thonte të mbeteshe vetëm për vetëm me një vajzë, në mes të pyllit. Për burrin, kjo do të thotë shumë. Ai ngeli një hop i pavendosur dhe pastaj tha me vete se nuk do të ishte burrërore për të, që të rrinte qoftë edhe pesë minuta i fshehur pas trungjeve të pishave.

Hila shtyu veten lart dhe, kur u ngjit në rruginë, pa Lezen që ishte futur në makinën e tij, afër diferencialit.

Ajo nuk e vuri re, kur Hila doli nga pylli. Hila shikoi në kabinën e makinës së saj. Ajo nuk kish në makinë asnjë pasagjer. Domethënë se ata ishin krejt vetëm. Mbrëmja që po binte, dukej sikur kish kapur vetëm majat e pishave. "A e ka menduar vallë se, të bëhet gruaja shoferë, do t'i rastisë qindra herë të ndodhet vetëm për vetëm me dhjetra shoferë, pasagjerë apo malësorë?". Kur mendoi kështu, ai ndjeu për Lezen atë inat dhe përbuzje, që kish ndjerë sa herë për të, aty, majë karrocërisë së Mësimores, kur Lezja rrinte e menduar dhe e heshtur me rregulloren e qarkullimit. në dorë, që e lexonte ose bënte sikur e lexonte, që të mos jepte përshtypjen se dëgjonte muhabetet nganjëherë me nëntekste.

Lezja doli nga barku i makinës së tij dhe kur pa Hilën, tha duke bërë një lëvizje profesionale me dorë, si shoferat e vjetër:

- Të la në baltë, Hilë? Kamjoja?

- Diferenciali.

- Ke kavo?

Hilës as që i pat shkuar në mend se ajo mund ta shfaqte aq natyrshëm mendimin që ta rimorkionte. I tha që kavo kish, me një ton indiferent dhe shkoi e ul në buzë të rrugës, sikur atij aq i bënte që kish ngelur në mes të rrugës e se atë natë do të flinte aty, në mes të pyllit. Në mendje i vinte herë pas here mendimi i errët se ai ish në fund të botës, larg gjithë njerëzve, vetëm për vetëm me një femër, që, dreqi ta hajë, s'ish e keqe dhe akoma më interesante e bënte guximi i saj i marrë, për t'u bërë shoferë, për t'u futur pyjeve e për t'u ndodhur ballë për ballë me burrat. Ju kujtua nusja e tij dhe tha me vete se, sikur ajo ndonjëherë të rastiste të ngelej kështu si Lezja, me një shofer në mes të pyllit, ai s'do të kish kurrë besim tek ajo, atij do t'i ish thyer çdo gjë brenda shpirtit të tij edhe sikur gjithë bota të mundahej t'ia mbushte mendjen se nusja e tij kish shpëtuar paq.

Hila ndjeu pas kurrizit lëvizjen e Lezes, që hipi në karrocerinë e makinës së tij. Pas pak, kavoja filloi të fërkohej pas trarëve.

- Lere kavon aty ku është!

- Të të rimorkjoj.

- Nuk ka nevojë.

Lezja heshti. Ajo ngeli një hop mbi gomë, zbriti pastaj poshtë dhe iu afrua kurrizit të Hilës.

- Të ardhka turp, o Hilë?

Në zërin e saj ai dallooi më shumë një keqardhje se sa një qortim. Asaj sikur i vinte keq që ish vajzë e që për këtë arsye po ndodhte kjo mosmarrëveshje.

- Jo, o Leze. Po shko ti, shko! Se ra nata, dhe do të të bjerë të kthehesh në këmbë e në mesnatë në katundin tënd.

- Lezja banonte në fshat, një orë larg qytetit të tyre.

- Mos e ki hallin tim ti.

- As ti mos e ki hallin tim. Unë jam burrë dhe, si malësor, kam qejf të flej në mes të bjeshkëve. Kalo ti, hajt mirupjekshim!

- S'kam për të luajtur vendit prej këtu, or Hilë!

Ai ktheu kokën dhe e pa në sy i habitur, sikur të gjente në sytë e saj një përgjigje tjetër të atij mendimi të keq, që i pat ardhur në kokë pak më parë.

- Me gjithë mend e ke?

- Unë e kam provuar, o Hilë, se kur më shkrep në kokë për një gjë s'ka njeri që më thyen e ma kthen mendjen.

Një tjetër mund t'ia keqkuptonte këto fjalë. Por ai e dinte se përse e kish fjalën ajo. Hila kurrë s'e kish kuptuar plotësisht atë vajzë, që me një këmbëngulje të paparë e të padëgjuar për ato anë, kish rezistuar deri në fund dhe ia kish arritur qëllimit për t'u bërë shofere. Ç'është e vërteta, për Lezen, flisnin shumë. Por askush nuk thonte ndonjë gjë konkrete, gjithsekush u jepte fjalëve këtë kuptim: "S'ka mundësi që ajo, me atë zanat, t'u rezistojë burrave dhe sidomos shoferave. Të bën vetë puna, që të rrëzohesh nga rruga". Dhe të gjithëve, për çudi, kjo logjikë u dukej e pakundërsh-tueshme. Por Hila e dinte mirë se, gjatë gjithë kohës që kishin qenë bashkë në kurs, ajo ish treguar tepër e kujdes-shme, i kish eliminuar me zgjuarësi të gjitha provokimet, pa lënë të ofendohej as edhe një kursant, kështu që të gjithë ishin thyer, dhe, nga provokatorë, pa e kuptuar as vetë, ata ishin bërë mbrojtësit e saj, në gjithë qytetin dhe në gjithë krahinën e tyre. Hilës iu kujtuan ditët kur shkonin për të bërë prova instruksioni jashtë qytetit. Lezja as nuk hante, as nuk pinte. Kursantët i thonin që të hante, por ajo s'futej restoranteve. Rrinte vetëm në Mësimore dhe s'pranonte as kur e kërcënonte instruktori. Në fillim ata kishin kujtuar se mos ajo ish e sëmurë. Por kur ra poshtë edhe ky parashikim, të gjithë menduan se Lezja ish koprrace dhe i mblidhte paret ose për të bërë pajë (ndoshta kështu mund t'ia prishte mendjen ndonjë burri) ose i mblidhte t'ia dërgonte të jatit. Një kursant, bile, tha se ajo ia kish prishur mendjen të jatit vetëm me pare, duke i dërguar pothuaj gjithë rrogën, dhe i kish premtuar, sipas tij, se duke u bërë shofere, ajo do ta

mbante në pëllëmbë të dorës. Por edhe këto parashikime dolën bosh. Kur vazhdonin provat aty rrotull qytetit apo bënin teori në klasë, Lezja shkante bashkë me ta në restorant, hante njëlloj sa ata dhe jo vetëm që nuk kursente, por i harxhonte parat, duke qerasur ndonjë shok, që i kish prishur lekët pa ardhur mirë dita e rrogës. Sa iknin jashtë qytetit të tyre për disa ditë, Lezja priste të ngrënët, rrinte përseri në kabinë, vetëm, me rregulloren e qarkullimit në dorë dhe s'ish e mundur që t'ia mbushje mendjen të hante bukë. Faktin që ajo nuk ish dorështrënguar e hidhte poshtë edhe sporteli i hoteleve, kur Lezja paguante të dy krevetet e dhomës.

Ajo i njihte të gjithë kursantët nga zëri, dhe kur i trokisnin në derë, për ta thirrur, ajo e hapte derën, por kish pasur edhe raste kur ajo kish dyshuar dhe u kish thënë të panjohurve që imitonin zërin e ndonjë kursanti të dilnin njëherë nga dritarja, që t'i shihte në ishin vërtet ata, e pastaj të hapte derën. Njëherë dy kursantë iu zemëruan për këtë mosbesim, ajo u kërkoi të falur pothuaj me lot në sy duke thënë se kish pasur raste kur njerëz të panjohur, që kujtonin se ajo ishte "nga ato", vinin natën në derën e dhomës së hotelit. Një nga instruktorët, një njeri humorprishur që më vonë e çuan në park se nuk i pëlqente puna me kursantët, nuk e donte Lezen. Nuk dihet për ç'arësye, po një ditë ai tha se molla e sherrit ish "ajo Lezja, si në filmin "Helena e Trojës", por ai s'kish ç'ti bënte, se "urdhëri kish ardhur nga lart", dmth nga vetë sekretari i parë.

Hila kish qenë shumë herë i pranishëm, kur dëgjonte në rrugë, në kafene, apo në restorant, njerëz që e ngacmonin e e tallnin këtë instruktor, gjë që, më parë s'e kishin bërë sepse instruktori ish burrë namusli dhe hijerëndë. "A po ia mëson pak rrotën Lezes, o Hivzi?". "Kemi dëgjuar sikur ke kërkuar që vitin tjetër të hapësh një kurs vetëm me vajza, se t'u ëmbëlsua nga Lezja". Një mbrëmje, kur Hila ish ulur vetëm për vetëm me instruktorin në një pijetore, ai i ish hapur dhe i kish thënë se që kur kish filluar këtë drej kurs, atij i kish rënë zjarri në shtëpi. E shoqja nuk donte të besonte që nuk e kish futur ai në kurs Lezen. Kur ai i kish thënë se nuk e donte Lezen, ajo ia kish marrë për të kundërtën. Kur ai i thonte se, kur e merrte Lezen në kabinë mbante edhe një kursant tjetër aty që të mos dyshonin, ajo e merrte sikur ai i linte të gjithë kursantët në klasë dhe vetëm për vetëm me Lezen bënte udhëtime nëpër bjeshkë, gjoja t'i mësonte makinën. Gruas së instruktorit s'kish njeri që t'ia mbushte mendjen se Lezja nuk ish bërë si e çmendur pas të shoqit të saj.

"O ditëzi, por ajo ka hallin e patentës, por prapë tek unë do të kthehesh, mos u zër besë bukurosheve, që të përdridhen rrugëve..."

Lezja qëndronte përbri tij, e heshtur, sikur kish vendosur që edhe ajo ta kalonte natën aty.

Hila ktheu kokën nga ajo dhe bëri sikur u çudit:

- Akoma s'paske ikur, Leze?

Lezja nuk i uli sytë, Hilës i erdhi inat që u detyrua të largojë e të hedhë sytë në fund të pyllit.

- Përse nuk pranon të të rimorkjoj unë, Hilë?

- Ty do të jap llogari?

- Përse nxehesh?

- Nuk nxehem! Nuk kam pse të nxehem, dreqi ta hajë.

Lezja u çua në këmbë, ndenji një hop ashtu duke e parë Hilën nga lart dhe pastaj u largua drejt makinës së saj. Hila nuk e ktheu kokën. Ai dëgjoi motorinon e kamionit të Lezes dhe pas pak zërin monoton të motorit. Lezja i dha dy tri herë gaz fort, pastaj u dëgjua një e krisur e lehtë e marshit, gjë që tregonte se Lezja ish nxehur. Punë e madhe, tha Hila, me vete. Kamioni i Lezes kaloi shumë pranë tij, se rrugina ish e ngushtë dhe ai ish ulur buzë saj. Ai priti që Lezja, që tani po i kalonte pothuaj mbi kokë, t'i thonte diçka, ose ta ofendonte. Por ajo nuk i foli. E ndjeu përsëri vështrimin e saj mbi kokë.

Kamioni i Lezes ndaloi dhjetë hapa më tutje. Hila e pa me bisht të syrit. Kamioni tani po ecte prapa. Lezja kish dalë nga kabina me një rën këmbë jashtë, në këmbëmbajtëse. Hila nuk e kuptoi në fillim këtë lëvizje të saj të çrregullt. Por nga zhurma e motorit dhe e gomave ai e kuptoi që Lezja po e çonte kamionin drejt kamionit të tij. Përsëri Lezja i kaloi mbi kokë dhe kanata e derës së hapur për pak e goditi, por Lezja e tërhoqi pak derën nga vetja. Hila nuk dinte ç'të bënte. Ai e kuptoi se nuk ish i zoti të çohet, të kundërshtonte e t'i thonte Lezes të shikonte më mirë punën e saj. Dielli kish perënduar, por nata akoma s'kish ardhur plotësisht. Hila pa me bisht të syrit Lezen, që nxori kavon dhe që po ua vinte të dy kamionave

Pastaj ajo nxori sedilen e saj dhe u ul buzë rrugës, pak më larg tij. Hila e kuptoi që ai tani ish futur në një pozitë tepër të vështirë, prej së cilës nuk dinte si të dilte. Preferoi të heshte e të bënte sikur s'kish vënë re gjë. Ajo qëndronte e zyrtë, në gjunjë dhe me vështrimin e ngulur në thellësinë tatëpjetë pyllit. Kjo gjë e çarmatosi. Sikur ajo të kish marrë një pamje ngadhënjyese apo të ish ngrefosur, ai do të kish gjetur shkak për ta hequr qafe. Si do të ish sjellë nusja ime po të kish qenë në vend të Lezes? Ajo as do të guxonte t'i hidhte sytë një burri, por do t'ia kish krisur vrapit tatëpjetë. Ky mendim, që gjithmonë e kish kënaqur, kësaj here kushedi pse iu duk i rëndomtë.

Më në fund ajo tha, me një zë të butë, të qetë dhe të menduar.

- Para tre vjetëve, këtej unë dilja e kullosja dhinë. Katundi im është katër orë që këtej, në këto bjeshkë, por unë i sillja dhinë deri këtu, se bari, ti e di, këtej është më i mirë. Por njerëzit, që s'më kuptojnë dot, më janë zemëruar e s'më shohin dot me sy, meqë unë s'ndenja me dhinë, por zbrita në qytet dhe mësova makinën... Sikur të kisha ngelur me dhinë, askush s'do të më mbante mëri, dhe baba, tani do të më kish çuar te burri, që ma kish gjetur që në djep... Edhe ti Hilë, po të kishe ndenjur me dhinë, s'do të bije në këtë hall, si sonde, por do të ishe i qetë, do t'ia këpusje gjumit deri nesër në mëngjes, kur të vinin makinat e tjera...

Lezja priti pak. Hila nuk tha gjë. Ajo vazhdoi, me atë zërin e saj karakteristik, që po i rritej e po i forcohej nga brenda.

- Nganjëherë më duket sikur vërtet kam sjellë telashe. Ka një vit e gjysmë që ca njerëz merren me mua. Vërtet, ç'taksirat kanë ata që shqetësohen kaq shumë për mua? Kështu mendoj nganjëherë e, të them të drejtën, më bëhet që ta hedh timonin e të kthehem në katund. Por kur i them vetes: Leze, ç'të keqe u bën atyre njerëzve, që ti je shofere? Ç'të keqe ka që ti, me ngulmë, kërkon të bësh një profesion që deri më sot, në rrethin tonë, s'e ka bërë asnjë grua? Besoj se ti e ke marrë vesh atë ngjarjen e ditës së parë, kur mora makinën e dola nga parku. Më rrethuan makinën... Nuk e di si e mbajta të qarët. Sikur të kisha qarë aty, s'do të kisha guxim të dilja më të nesërmen në qytet. Do ta kisha dorëzuar makinën, që atë ditë. Por, nejse. Më thuaj pra ç'kisha bërë unë dhe përse silleshin ata ashtu me mua? Ja, tani edhe ti, që sadopak më njeh, po ashtu po vepron... Të kish qenë ndonjë shofer tjetër, burrë veç, ti s'do ta zgjasje as edhe një

minutë, por do të kishe vënë vetë kavon... Përse edhe ti sillesh kaq keq?

- Nuk sillem keq, - mezi tha Hila. - Unë kurrë s'jam sjellë keq me ty, ti e di.

Atij i erdhi inat nga vetja, që foli me një ton, sikur të donte të shfajësohej. Ai vuri re se në thellësinë e pyllit po fillonin të humbisnin një nga një siluetat e drurëve. Siluetat e largëta pothuaj se nuk dukeshin më. Dalëngadalë nata po priste, si një sharraxhi i gjithfuqishëm, të gjitha trungjet e drurëve. Pas pak, pyllë do të humbiste krejt dhe aty do të ngelshin vetëm ata të dy.

- Ke frikë mos e marrin vesh në qytet e të tallin: "Hilën e nxori nga balta Lezja", "Hilën e tërhoqi për hunde një grua".

Hila kapi një degë të thatë dhe e këputi më dysh.

- Jo, Leze, - tha me një zë të thyer.

- Ashtu qoftë - tha Lezja.

- Sidoqoftë, ti nisu!

- Jo, Hilë. Do të vish dhe ti.

Të dy kamionët qëndronin të lidhur me kavo në atë mugëtirë pylli dhe Hila e kuptoi se kamioni i Lezes do ta tërhiqte vërtet për hunde kamionin e tij deri në qytet. Kur të zbriste në qytet, nesër të gjithë do ta merrnin vesh se Lezja kishte rimorkiuar Hilën dhe këtë do ta përsërisnin aq me qejf, sikur kjo të kish qenë ngjarja më e rëndësishme dhe më e çuditshme e gjithë vitit.

- Ç'na polli - tha Hila, duke u çuar. Në ato çaste, kushedi përse, iu kujtua përsëri fytyra e bardhë e nuses së tij, që ndoshta, tani po rrinte në dritare dhe po shihte njerëzit që kalonin në rrugicë.

NE KISHIM NJË RRUGË...

Jam zooteknik me profesion. Punoj në fshat, në një kooperativë bujqësore, i kredhur gjithë ditën pas kopeve me dele, gjithë ditën duke zgjedhur ushqim për derrat apo gëzhuça për shpendët. Rrallëherë dukem në qytet dhe kur vij në qytet ndjej një gëzim që ndofta është shumë i ndryshëm nga gëzimi që kanë disa të tjerë që vetë janë në fshat kurse mendjen s'e kanë fare aty... Unë shkoj dyqaneve të qytetit dhe shoh njerëzit tek blejnë mish, flasin për cilësinë e tij, kërkojnë këtë apo atë copë, pastaj marrin atë që u pëlqen, ua mbështjellin në letër dhe nisen të kënaqur për në shtëpi. Unë i vrej me vemendje këta qytetarë, por ata nuk e shohin nënqeshjen time të gëzuar. Më tutje nënat blejnë qumësht në shishe të mëdha; këto shishe të bardha i ngrejné drejt diellit sikur duan të shohin sa i bardhë është qumështi. Po kështu më ndodh kur shkoj te dyqani i vezëve, te magazia e sallameve, te frigoriferët e bulmetit. Njerëzit blejnë ato prodhime për të cilat unë punoj. Kënaqem kur kënaqen qytetarët, gëzohem kur gëzohen ata dhe këto ndjenja të mia që mund të duken çikërrime, këto ma mbushin zemrën plot me gëzim.

Kam lexuar (dhe jo vetëm një herë) ndonjë shkrim letrar ku ndokush na ka hedhur, neve zooteknikëve ndonjë romuz. Por kjo s'ka shumë rëndësi, s'na mërzi ne.

Një ditë, tashti vonë, duke qenë i kredhur në punët e mia, më thërret kryetari i kooperativës:

- Shoku zooteknik, a je gati?
- Si urdhëron, shoku kryetar!

Kishim plan të merrnim disa desh race në fermën e Goranxisë. Kuptohet që kjo bëhet për të ngritur më lart racën e deleve, për më shumë qumësht, për më shumë lesh, për më shumë mish. Pra për ushqim dhe gëzim për të gjithë. Dhe u nisa me kamionin tonë drejt jugut, nëpër gryka malesh t'ashpër, nëpër Kolonjë e nëpër kangjelat e Barmashit, nëpër Borovë e nëpër grykën e Shalësit apo të Gërmenjit. Të gjitha vende që tashmë kanë hyrë në historinë e revolucionit tonë. Pra ik e ik tatëpjetë dhe sa shkon poshtë, vendi më i butë, bimësia më e thellë e me doemos mendja ime punon: "Ja për këto pllaja me bar të dendur të lëshoj kopetë e deleve, në ato çaire me ujëra shumë të lëshoj lopët, ndër këto livadhe të lëshoj mëzat dhe pelat". Ujërat e Vjosës më mahnitën me kthjelltësinë e

tyre; kujtoj Naimin që ka bredhur këtyre anëve, sjell ndërmend vargjet e tij, po përsëri mendja ime ngulmon te puna e përditshme: "Ja buzë kësaj Vjose, të kem e të lëshoj kopenë për bar të njomë e për ujë të kulluar".

Arritëm në Goranxi. Takime me shokë të shkollës, përqafile e biseda të mallshme; pastaj fletëdalje e fletëhyrje, urdhër xhirimi dhe firma njera pas tjetrës. Mora në dorëzim deshtë e racës, me shoferin i ngarkuam në kamion, mbërthyem disa direktë e dërrasa dhe hajde... Udhë e mbarë dhe mirupafshim.

- Shoku shofer, shkelja sa më fort se gjëja e gjallë po ngeli poshtë e lartë rrugëve, humbet vetijat e saja...

Shoferi s'para merr vesh gjuhën time teknike, por rëndësinë e kupton, dhe ia shkel si e do puna. Ik e ik, gjithnjë lart e më lart dhe unë bëj ç'bëj ngrihem më këmbë, nxjerr gjysmën e trupit nga kabina e u hedh një sy deshve:

"Rrini urtë! Kur të mbërrijmë aty afër Maliqit do t'ua ngjesh grazhdin me jonxhë, me bërsi panxhari të ngrohta si bukëvale, bërsi të nxehta sapo dalë nga kombinati... o burra shofer!

Dhe vrapimi ynë do të shkonte për bukuri, kur mu në mes të rrugës, papritur dhe pakujtuar... grang... diç u thye nën karroceri. Unë vështrova nga shoferi, ky u mvrejt, frenoi dhe lëshoi një të sharë. Dolëm në rrugë. Ai u fut nënë makinë, u zhgrrye disa herë nën të, pastaj doli këtej, pikë e vrer.

- Ç'është?

- U thye ingranazhi i...

- Po tashti?

- S'kemi pjesë këmbimi.

Mbetëm duarkryq në pikë të hallit. Kalon një kamion. E ndalojmë. I qajmë hallin shoferit, na dëgjon, por në fund mbledh buzët dhe betohet:

- Për ideal s'kam, e kisha një ingranazh para dy ditëve por...

Dhe fillon e tregon se si e kush e ku e përse. Dhe kjo histori vijon edhe me tre shoferë të tjerë. Pastaj rruga pritet. Askush nuk po dëgjohet e as po duket më. Afrohet nata dhe shqetësimi im sa vete shtohet. "Do të shpie në kooperativë dhjetë desh të uritur, të ngordhur, dhjetë desh që duhet të hynin menjëherë në veprim... po përse ta zgjat me fjalë për të cilat ju do të vini buzën në gaz në kohën që unë isha pikë e vrer?"

Renda në një lëndinë më tutje pas një mezhde mblodha tufa me bar dhe i shpura te deshtë. Pastaj rrëmbeva katrovën e makinës, renda gjer te përroi, e mbusha me ujë, e shpura. Deshtë iu sulën, por u kthyen prapa si të fyer. U vinte era benzinë. Renda e mblodha bar tjetër, e krodha n'ujë, dhe ashtu bar e ujë e çova përsëri. Më s'më zinte vendi. Po afrohej nata dhe si dukeshin punët do ta kalonim atje pra-ndaj... o burra për bar e për fletë të njoma. Isha tutje rrugës kur vura re shoferin tim që po më bënte shenja. Ngrita kryet mirë dhe vura vesh: një uturimë motori po dëgjohej përsëri. Pas pak u duk një kamion frigorifer dhe një shpresë e re. Isha duke mbledhur bar kur të dy shoferët po bisedonin. Makina e posa ardhur ishte e madhe, ne na duhej ingranazhi i një makine më të vogël. Për një çast vura re se ata të dy flisnin për mua, sepse vështronin këtej dhe lëviznin duart drejt meje. Kur u ktheva në rrugë, të dy shoferët ishin futur nën kamionin tonë dhe dëgjoja zërat. "Pa dale! Pa dale! Ku e kam dëgjuar këtë zë? Ku?" Rraha mendjen një grimë. "Po. Tashti e njoha këtë zë." Ju mund të thoni: "Ku mbahet mend një zë që e ke dëgjuar këtu e pesëmbëdhjetë vjet më parë dhe vetëm një herë?" E drejtë. Ashtu është. Por mos të harrojmë: Më ishte ngulur në mendje sepse ai zë dikur më pat thënë gjithë urrejtje dhe inat: "Ik tutje, more palaço!"

Pra një njeri që dikur më pat fyer aq rëndë, tashti po më ndihmon. Si t'i thuash kësaj? Ndofta ai s'më njohu nga larg, ndofta ai po na mbaron punë tashti e pastaj... kur të më njohë mua, do të rrëmbejë çekanimin e madh dhe do ta bëjë çika çika ingranazhin e kamios...

Pra, pesëmbëdhjetë vjet më parë:

"Isha student, djalë plot shëndet, plot muskuj të fortë dhe të ngjeshur. Këto nuk i them kot: isha mundës dhe mundës jo i zakonshëm. Një mundës që ma lakmonin shoqërinë gjithë shokët dhe shoqet e klasës, sa që në ditët e ndeshjeve vinin tufa tufa në palestër dhe më jepnin zemër e më brohorisnin. Atë vit kishim kampionat kombëtar në kryeqytet.

Bëra ushtrimet e nevojshme, treneri më jepte udhëzime, më tregonte histori nga të tiat. Dhe kur u nisëm, m'u qepën pas të gjithë shokët dhe shoqet e klasës. Për këto të fundit u gëzova më shumë sepse midis tyre... e nejtë, ju e kuptoni. Bisedime të zjarra, përgatitje t'ethëshme, këshilla, masazhe, stërvitje. Dolëm në tapetin e madh. Më treguan kundërshtarin tim. Më shkuan djersë të ftohta. E pashë mirë e mirë, fërkova zverkun, gurmazin, krova kokën. Kundërshtari im ishte gjithë poza e krenari. Dhe kishte të drejtë mbase, ai ishte kampion i vendit dhe as që desh t'ia dijë nga një mundës fare i panjohur dhe pa eksperiencë. Dhe të jua them që tashti mos të ju shkojë mendja se e munda me...

Për kundërshtarin tim, si mësova, ishte një ditë vendimtare. Me fitoren e sotme ai bëhej mjeshtër sporti e ku ta di unë se çfarë. Por s'kish kohë për të menduar më, se ra gongu dhe më thërritën në tapet.

Dola. Arbitri diç më kontrollloi nën sqetull, gongu ra edhe një herë, filloi ndeshja. Pa e bërë të gjatë kundërshtari më kapi dhe më rrëzoi poshtë, njerën shpatull ma nguli në tapet, unë shtërngova muskujt, por kalova n'urë, sikurse thuhet në gjuhën e mundjes. Kundërshtarit tim në këtë rast iu shënua gjysmë pike në fitim, kurse unë munda t'i shqitem nga duart. Djersët po më vinin çurkë dhe po matesha ta përfshij kundërshtarin. Kisha një dëshirë të pamatur, ta kap një herë ashtu si duhej, pa e merrte vesh ai... dhe në kohën që desha ta kap unë, ai me një lëvizje mashtrimi dhe... më kapi përsëri. Dhe përsëri unë kalova n'urë, dhe përsëri edhe gjysmë pike tjetër në fitim të kundërshtarit. Shokët dhe shoqet e mia thërrisnin e bënin poterë, më jepnin zemër dhe më nxitnin, por të them të drejtën vetëm për një çast i dëgjova ato britma. Edhe një lëvizje tjetër mashtrimi desh të më bënte kundërshtari, por unë s'e hëngra më, nuk di se si ngjau ashtu dhe vij e e përfshij krahaqafë. Po e përfshiva aq mirë... Ai u drodh një çast dhe reagoi fort. Unë ia shtërngova kokën dhe zverkun si në mengjene, ai desh të kalonte n'urë, por unë s'kisha ndërmend të kënaqem me gjysmë pike. Jo, jo. Unë tashti isha për fitore. Dhe fare papritur ai më flet ngadalë:

- Mos më merr më qafë!

- Luftë sportive, ia ktheva unë.

- Ty s'të njeh njeri, mos...

E shtërngova edhe një herë dhe bëra ta ngjesh përtokë,

por ai përsëri u mbajt, përsëri m'u lut:

- Mos, e dëgjon? Ajo që thërret është e fejuara ime...

- Po imja!?

Atëhere e vura re që u egërsua dhe u dha krahëve dhe trupit aq fort sa edhe mua m'u drodhën gjunjët dhe shtërngova dhëmbët që mos më shpëtonte nga duart. Menjëherë u hodha në kundërsulm dhe e përplasa poshtë dhe ia ngjeshja shpatullat për tokë!

Në sallë dhe në galeri plasi një gurgule e fortë, e pasuar nga disa thirrje gëzimi dhe hareje. Shpatullat e kampionit ishin për tokë dhe çfryrjet e gjoksit tim sikur më ndihmonin që ta ngjishja edhe më fort. Kisha fituar ndeshjen. U gëzova me zemër, por s'buzzëqeshja dot. U ndamë, dhe u ngritëm më këmbë. Isha aq i lodhur sa fytyra s'po më merrte dot një pamje gëzimi. Sipas rregullit iu afrova kundërshtarit tim dhe i zgjata dorën. Por ai ma shtyu:

- Ik tutje, palaço!

U ndamë dhe nuk u takuam më. Unë shkova jashtë shtetit, mbarova studimet, u ktheva, hyra në punë me kafshët, me delet, me ushqimin e tyre, me kopetë, gjersa u nisa për Goranxi nga ku po kthehem me ingranazhin e thyer...

Por... tashti dëgjoj zëra të gëzuara nën kamion dhe midis dy zërave edhe ai i... Po, po! Ai është me siguri, dhe të dy shoferët dalin këtej, ngrihen më këmbë, janë të lodhur, të nxirë nga vajrat, por të gëzuar. Por... shih kur të ndodhë e keqja, shih kur të më njohë, shih kur të rrëmbejë çekanin e madh dhe..

- Gati shoku Sedat! Çdo gjë në rregull!

Dhe më afrohet kundërshtari i dikurshëm, kundërshtari im në mundje. Kanë kaluar kaq vjet dhe ai punon si shofer. Më vështroi me sytë e tij të kthjellët, të qeshur dhe të përzemërt. Unë bëhem gati ta përqafoj, por ai më ndalon duke më treguar me shenjë se është gjithë zhul e graso. Por unë s'u përmbajta.

- Dale, - më tha, ndërsa unë e shtërngoja ndër krahë, - dale, unë duhet më parë të të kërkoj të falur, ti ke pasur të drejtë, unë të kam fyer.

- Të shkuara, të harruara, po si kështu?

Ai ktheu sytë nga lumi i Vjosës dhe me tregonjësin shënonte rrjedhën e madhe:

- Ujë të rrjedh e nuk rri në vend, kështu edhe unë... Të kam parë edhe herë të tjera, po s'kam guxuar të afrohem; ti punon dhe mbush me mish makinën time frigorifer.

- Po tashti pse guxove?

- Tashti është ndryshe, diçka bëra për të larë fajin, për ty...

- Jo, jo, ti bëre shumë për punën tonë të përbashkët, kjo ka rëndësi më shumë.

- Po, ashtu është. Ti përgatit qumësht, mish, vezë; unë ua shpërndaj njerëzve. A nisemi tashti?

- Si të duash.

- Nisemi se po bëhet vonë dhe çmallemi rrugës, se një rrugë kemi.

Dhe u nisëm.

NËN ÇATIN' E RE, NË DIBËR

Ata rrinin sipër krevateve dhe shikonin shiun e vrullshëm që përplasej në xham. Rruga e ngushtë ishte e shkretë. Më të rrallë kalonte ndonjë student me vrap. Në konviktin përballë po nxitonte një vajzë me çadër. Ai, që rrinte pranë dritares, qeshi. Vajza, nga nxitimi, kaloi mbi një gropë me ujë të turbullt. Pastaj dhe ajo hyri në konvikt dhe jashtë dëgjohej vetëm shiu që binte me rrëmbim.

- Ti, kur e njohe kaq shpejt sa vendose të martohesh me të? - iu drejtua ai që rrinte pranë dritares, shokut.

Tjetri u kthye në kurriz, ndezi një cigare, vështroi një copë herë flakën e shkrepes, pastaj e hodhi në dyshtenë plot bishtra. Dhoma mbushej kështu gjithmonë kur ata diskutonin për ndonjë gjë dhe kur koha nuk ishte e mirë.

- Ç'shi! - tha dhe u kthye përsëri në kurriz.

Atij i pëlqente të pinte cigare kur jashtë binte shi dhe të mendonte. Era frynte me ndërprerje. Kur heshtëte, dukej sikur mbushej me frymë, si një zhytës para se të kridhet në ujë.

Mimozat u thanë nga ngricat. Dhe ajo i do shumë mimozat, mendoi.

- Vetëm shiko se mos pendohesh më vonë - tha ai që rrinte pranë dritares.

Tjetri qeshi. Gjakftohtësia e tij dukej se e nevrrikoste shokun. Ai kishte pamjen e një njeriu të vendosur, që për të ka marrë fund çdo gjë. Dhe në qoftë se e dëgjonte shokun, e dëgjonte për respekt.

- Dashuria do kohë dhe kushte për ta provuar. Dhe ne kemi nevojë për një dashuri të fortë. Më kupton, të fortë!

Tjetri thithi cigaren.

- Ne kushedi ku do të emërohemi. A është e përgatitur për t'i përballuar vështirësitë?

- Ti nuk e njeh, prandaj flet kështu.

- E di. Por edhe ti nuk ke shumë kohë me të.

- Për mua mjaftoi koha e shkurtër që ndenjëm në...

- Ndërsa unë kam idenë sikur ty të vjen keq ta mbarosh fakultetin, pa zënë ndonjë dashnore.

Tjetri u kthye në bark dhe qeshi.

- Ç'flet budallallëqe dhe ti, Isa!

Isai heshti.

- Më jep një cigare - tha.

Tjetri ia hodhi së bashku me shkrepsen.

- Unë e kam kërkuar dashurinë gjithmonë. Dhe ajo që kudo, në këngët, në bangat e gjata të auditorit, në erën që ngre flokët e gjelbër të shelgjevet lotues.

- Leri këto romantizma - e ndërpreu shoku me nervozizëm.

- Unë e di se dhe ty të josh romantika, - dhe kur pa se tjetri u mat të fliste, vazhdoi shpejt e shpejt. - E di, e di se do të thuash, jo. Isa, dashuria ime nuk u ndikua nga librat që kemi lexuar, ajo u ndikua nga diçka tjetër, më e fortë, më e rëndësishme. Unë nuk di të ketë dashuri pa romantikë.

- Për mua ajo filloi më vonë.

Dhe hodhi cigaren, e cila, si lëshoi tym për një copë herë, u fik në dysheme. U hap një derë, e cila u mbyll me zhurmë. Dikush ndiqte shokun. Pastaj s'u dëgjua asgjë përveç zhurmës monotone të shiut që vazhdonte të binte pa ndërprerje.

- Kur u nisëm si vullnetarë për në fshatrat e dëmtuar nga tërmeti, ajo m'u afrua e më tha:

"Unë nuk kam qenë në Veri dhe nuk e përfytyroj dot si është. I ashpër, me borë apo jo?"

Këto fjalë më lanë përshtypjen se ajo është ndonjë vajzë e përkëdhelur që del për herë të parë nga shtëpia. Se si vështronte nga dritarja e autobusit. Kishte në sytë e saj një kuriozitet sa naiv aq dhe të këndshëm për ta soditur. Shpesh më binte me bërryl dhe thërriste me zë të lartë, kur

na dilte përpara ndonjë pamje interesante. Unë i përgjigjesha shkurt. Më vinte çudi: ne njiheshim vetëm si studentë të të njëjtit fakultet, kurse atë ditë udhëtonim bashkë. Ajo që një vajzë e gjallë dhe unë e kam të vështirë të hap bisedë, sidomos kur udhëtoj. Isa, sa herë që të më shohësh në autobus, thuaj "Ja, një romantik!"

Deri në Peshkopi arritëm të heshtur. Rrallë shkëmbyem ndonjë fjalë. Dhe ajo, si e pa që unë e nxirja fjalën me zor, e mbylli gojën. Bora binte vazhdimisht. Të nesërmen na shpunë në fshatin e dëmtuar. Ajo, që ditët e para, filloi të punonte me vrull krah meje. Ashtu me peliçe dhe me pantallona, gjendej kudo. Në atë trup të vogël, fshihej një energji, që të bënte për vehte. Natën kur rrinim pranë zjarrit, ajo e gjallëronte atmosferën tonë vullnetare me të qeshurën e saj me zë të lartë. Ajo shoqërohej shpejt e shpejt me këdo. Ndërsa unë e ndjenja vehten ngushtë, se më dukej sikur me të nuk mund të bëje dot ndonjë bisedë serioze. Që më parë mendoja ndonjë shaka, e cila s'më dilte kurrë e goditur, megjithëse ajo qeshte.

Pastaj erdhi nata e fundit në fshat. Çatia e fundit. Flokët e fundit të borës mbi shpatullat tona, mbi kujtimet tona, mbi zjarrin tonë. Era të priste. Malet përçark kishin një hije të rëndë. Nga larg dëgjohej zhurma e një traktori, që tërhiqte makinat me trarë, tulla. Ustallarët punonin me zell dhe ne nxitonim t'ua plotësonim vetëtimthi kërkesat. Ajo, si përhera punonte e qeshur, sa nuk e kuptoja dot burimin e asaj buzëqeshje. Dhe mblidhja supet i çuditur. Ti e di ç'punë u bë. Po ne kishim kohë të mendonim edhe për gjëra të tjera. Aty nga mesi i natës, vura re se asaj i merreshin këmbët. Shtëpia që në të mbaruar e sipër. Kisha dëshirë që ajo të mbahej deri sa të zbrisnin ustallarët dhe ne të këndonim nën çatinë e re. Por ajo që lodhur shumë dhe këmbët i ishin ngrirë. Dhe ra në borë mu para meje. E ngrita dhe e shpura pranë zjarrit. Qemë vetëm. Ia hoqa çizmet. Ajo donte të ngrihej, por nuk e lashë.

I vjen turp të rrijë me një djalë, në një dhomë, mendova në fillim.

"Ngrohu, pastaj dil e puno" i thashë.

"Sa i çuditshëm që je!" tha.

"Përse?" e pyeta i habitur.

"Ti gjithmonë je i ashpër".

Dhe zgjati duart nga flaka.

"Kështu e kam natyrën" thashë kot.

Ajo qeshi. Mua vajzat që qeshin shumë, nuk më kanë pëlqyer. Kurse sonte, kur jashtë binte borë, desha që ajo të qeshte, vetëm të qeshte. Isha gati ta shkrija qeshjen e saj si një flok bore.

"Ti edhe në fakultet rri serioz".

"Po ty, a të pëlqejnë seriozët?" e pyeta dhe sepse e prita me shqetësim përgjegjen.

Ajo u mendua.

"Deri diku".

Mora një shkop dhe trazova prushin. Unë kapa vështtrimin e saj dinak që buzëqeshte. Në dhomë hyri një murator i vjetër.

"Ç'pate, moj burrëreshë?".

"Asgjë, xha Arif. Vetëm se u lodha pak si shumë sonte. Dhe ngriva. Jam e dobët".

"Na, pi pak konjak!".

Ajo mori shishen dhe piu një gllënkë.

"Ngrohu dhe shko e fli. Shiko, se mos dalësh të punosh" tha ustaj dhe doli. Në hapësirën që u krijua, kur ai hapi derën, hyri era me borë. E pyeta:

"Të pëlqen bora?".

Sytë e saj sikur u mbuluan nga mjergulla e kujtimeve. Ajo vështroi siluetat e bardha të maleve. Një pemë e vetmuar nxinte në oborr. Shpesh nga dritarja dukeshin vullnetarët që kalonin shpejt. Deri tek ne arrinin shpesh-herë fjalë të shkëputura. Flaka herë rritej, herë zvogëlohej në vatër.

"Unë kam lindur me borën dhe jam rritur me të. Bora më kujton fëmijninë. Dhe fëmijnia nuk harrohet".

"Ndërsa unë kam parë borë në Tiranë".

"Bora e Tiranës është si një çast fëmijnie, por jo si fëmijnia".

Hodha disa dru. Ata muarën flakë me zor nga që qenë të lagura. Në dhomë nisën të hyjnë vullnetarë. Thoshin ndonjë fjalë dhe iknin. Era kishte pushuar dhe bora binte tani më me ngadalë. Ne heshtnim të dy dhe vështronim duart të zgjatura nga zjarri.

"Pasnesër do të ikim..." tha.

"Po, i thashë, do të ikim".

"Të vjen keq?".

"Gjithmonë më vjen keq kur largohem nga ndonjë vend ku kam kujtime".

"Edhe mua" tha.

U dëgjua buria e një "Zisi". Do të niseshim me të.

Ne gjithmonë hipnim mbi trarët e shtëpisë së re dhe shikonim tutje, ku dy drita, si dy krahë gjigandë hapnin borën e dendur. Ato afroheshin dhe neve na dukej sikur mbi karroceri mbanin tërë Atdheun. E çuditshme, por edhe ty, edhe bangat e gjata të auditorit, edhe zilen e shumëpritur, na sillnin ato dy drita. Dhe të tëra rrinin mbi materialet dhe thërrisnin të gëzuara:

"E çamë përsëri rrugën!".

Optimizmi i shoferave të përfshinte dhe ne me kënaqësi zhyteshim në botën e shakave të tyre.

"Këta, shoferat janë tipa interesantë" tha.

"Janë njerëz të thjeshtë dhe të regjur".

"Edhe im atë që shofer. Mua më duket se vetëm prindërit shofera dinë të përkëdhelin më me dhëmshuri se kushdo".

"Nga që janë larg fëmijëve" thashë.

"Nuk e di. Largësia ose i afron ose i ndan njerëzit".

"Varet nga lidhja që kanë midis tyre. Po dashuria e vërtetë nuk njih ndonjë kusht, që e forcon apo e dobëson. Ajo mbetet një ndjenjë e fuqishme".

Ajo vuri buzën në gaz.

"Përse qesh?" e pyeta.

"Kot. Dy njerëz në mes të borës dhe furtunës bisedojnë për dashurinë, si në një lokal rreth gotave me konjak".

"Mua s'më ka pëlqyer ndonjëherë të bisedoj për dashurinë rreth gotave me konjak".

Ajo uli kokën dhe luajti një dru në vatër. Flaka u përhap dhe unë pashë pasqyrimin e saj në sytë e kaltër.

"Ndërsa unë piva sot për herë të parë" tha.

"Çfarë?" pyeta i habitur.

"Konjak" tha.

"Dhe po bisedon për dashurinë".

"Për dashurinë e njerëzve të thjeshtë. Më vjen çudi ngandonjëherë me këtë ndjenjë që lind kudo dhe të hedh kudo. Dhe ne këtu dashuria na solli, dashuria për njerëzit tanë të malësive. Ndofta do të më pëlqente, që dikur, në ndonjë lokal, të bisedonim për kohën që kaluam këtu në mes të borës".

"Dhe të kthenim ndonjë gotë".

"E pse jo, për njerëzit që njohëm dhe do të njohim, për punën e tyre dhe për ne. Ti do të thuash, a e mban mend atë ditë kur... Dhe unë do ta pres fjalën përgjysmë. Po kur bëme tërë atë rrugë më këmbë dhe ti... O, unë u lodha duke çarë borën. Pastaj erdhi xha Arifi. Më duket se harruam diçka. Hë, po! Sapo mbaruam së mbuluar çatinë ia nisi bora. Ne hymë në shtëpinë e re, nën çatinë e re. Dhe sa kënaqësi është të rrish nën çatinë që sapo e ngrite. Ti the se e ndjen vehten si në shtëpinë tënde. Dhe unë të thashë... Ndofta atëhere do ta kem harruar çfarë të kam thënë. Kështu do të ndodhë".

"Që do të harrojmë gjithçka".

